



Vath Koreshi

**ULKU dhe UILLI**

*roman*


Onufri

85H-31  
K 91

# Vath Koreshi

## Ulku dhe Uilli

roman



Onufri

## PËRMBAJTJA

<b>HYMJE .....</b>	<b>9</b>
<b>LIBRI I PARË .....</b>	<b>11</b>
<b>LIBRI I DYTË .....</b>	<b>32</b>
<b>LIBRI I TRETË .....</b>	<b>54</b>
<b>LIBRI I KATËRT .....</b>	<b>74</b>
<b>LIBRI I PESTË .....</b>	<b>98</b>
<b>LIBRI I GJASHTË .....</b>	<b>117</b>

## HYMJE

*Këtë që kam nis me shkrue, o ju që u bekoftë Zoti, ma ka thanë një nga Apripa e Epërme, një vendas nga ajo krahinë matanë malit të Karmeljesë, të cillën na e ka nda nga familja e kërshtenë me të gjashtë copë katundet që ka, Bojrogu me gardhin e faltoreve të veta. Atje po i thoshnin ujkut ulk dhe yllit uill. Asht m'u ngjeth kjo çka kam dëgjue në një kuvend që u ba në manastirin e Shëndërtarit e që unë deri më sot s'kam mund me e hedh në letër. Ka qenë koha kur ipeshkui ynë bani një plan për me i vu ledh gjendjes së mjerueshme të besimit dhe hymjes në votrat tona të egërsimit të jetës e të zakonevet të mbrapshta. Si vizitoi kishat e ipeshkuive sufragane të jurisdikcionit të tij, lanë pas doresh prej shumë kohësh, ai mblođhi kuvendin kishtar në manastirin e Shëndërtarit në Mat (apud manasterium S. Trinitatis de Emathia), ku përvëç një shumicë klerikësh, morën pjesë paria e vendit dhe një mori e panumërt populli (...ac presentibus nobilitus et plebis innumeris). Në atë sinodë asht folë për rregullat, ose "Costitutiones", që përbaheshin në aktet e atij kuvendi e që në pjesën ma të madhe silleshin rrëth sakamenteve. Aty flitej pikë së pari për pastrimin e petkut*

*tē priftit, pēr ruajtjen e sakramenit dhe pēr vojimin e fundit,  
duke mbajtun bagmin tē paprishun. Tuj e ndalue hymjen  
nē kishē t'atyne qē nuk ishin rrēfye qysh prej një viti,  
rregullohej rrēfimi bashkē me formulēn e absolucionit. Nuk  
u jepej absolucioni burrave qē thyenin kunorën ose mbanin  
konkubina, martesat e dyta, "secunde nuptie", u ndaluen...  
Tuj marr shkas nga gjithē çka po thuhej nē atē kuven, mē  
asht afrue i s'Apripës sē Epérme, një marrok e zhalakan ma  
mirë me thanë, por fort i qutë e fjalëmatun. Ai ma tregoi  
këtë histori, që qe ku po mundohem me e vu nē rend edhe pēr  
ju, o tē mirtë e Zotit, tuj ju lut qē t'm'i falni lajthitjet e  
mendjes seme prej plaku. Paçi bekimin e Tynëzot!*

*Lazēr Pali nē famulli tē Mērturit,  
16 kallnuer 1462.*

# LIBRI I PARË

## KAPITULLI I PARË

Po e nis, o tē uruom, me nji famullitar qē e qujshin munshinjur Agushtini. Ky mrrolak e rrezikzi u ba shkas tē dilnin nē shesh ca gjana tē fshehta e ca paudhni qē, pēr besē tē Zotit, nuk janē fort tē kollajshme me u shkrue. Ka ndodhē nji ngatrressē, nji grua e ka ngattrue munshinjur Agushtinin dhe e ka marrē pēr tē vëllanē e tij, munshinjur Bdekun. Puna asht ndērlikē e gjithshkafja asht ba lamsh. Ajo, o tē mirē e o tē dashun, ka kujtue se po i rrēfchēj Bdekut nē kishē, por ka qenē atje Agushtini nē vend tē tij e kështu ai ka mësue nga goja e saj ca gjana qē s'kishte dashē me ia zanē veshi.

## KAPITULLI I DYTË

Munshinjur Agushtini me munshinjur Bdekun ngjanin si dy pika uji me njeni tjetrin. Ishin tē dy

famullitarē, tē dy vēllazēn dhe tē dy shērbenin nē dy famullitē e asaj krahine. Kēshtu, o tē mirē, zuni fill ajo qerthullane dhe kēshtu munshinjur Agushtini u gjend nē ca befasi qē nuk i merrte dot me mend. Ka qenē njē ditē kur atij i ishte dashtē tē merrte rrugēn e malit pērpjetē e tē ngjitej nēpēr ca ferrecka dhe nēpēr ca mēzhdaikta pēr tē dalē tek kisha e Shndusē. Qēllimi ka qenē t'i thoshte tē vēllait, famullitar Bdekut, domethēnē munshinjur Bdekut, siç u thoshin meshtarēve nē ato anē, se data atē ditē nuk ishte 24 qershori, siç e dinin ata sipas njē kalendari qē ruhej qē nga koha e famullitar Aurrelit, por 29. Ia kishte thēnē kētē famullitari i Ureshēs, qē kthehej nga ipeshkvia dhe munshinjur Agushtini qe trandur! Qysh ishte 29, kur ata e dinin 24?! Shurbesat dhe festat fetare qenē bērē çorap. Po vinte dita e t'Lumnuemes dhe ai bashkē me munshinjur Bdekun duhej tē rregullonin shumē gjana.

## KAPITULLI I TRETË

Është nisē munshinjur Agushtini atē ditē, o ju qē u bekoftē Zoti, po kur ka dalē nē krye tē shtegut tē kishēs, ka parē atje, nēn hijen e ilqeve, atē grua ngucakeqe, e cila rrinte nē kēmbē dhe shikonte nga ai. E quanin Luçie. Munshinjur Agushtini ndjeu zemrēn qē i rrahu dhe deshi ta yshtē tundimin qē pati. As dyzetē vjeçë, e kolme dhe e bëshme, ajo tē dehte si me aromē dalldisëse. Munshinjur Agushtini ndérroi rrugë dhe mori pēr nga muret e kishēs. Me demek se donte tē ecte nēn hijen e tyre, por nē tē

vërtetë deshi t'i ruhej asaj sē hazdisure qē dukej si e lajthitur atē ditē. E paburrrē, pēr tē thonin e ç'nuk thonin, ndonëse munshinjur Agushtini nuk u besonte tē gjithave. Kur vinte nē kishē, i qe dukur e urtē dhe e ndrojtur, sidoqē e bukur dhe me një shikim qē tē trazonte. Por atē ditē sikur i kishte plasur cipa. Sapo munshinjuri hyri nē shtegun e oborrit, Luçja vuri duart nē bel dhe, me një zë tejet shpotitës, i thirri:

- Rrens!

Munshinjuri kishte ngrirë. Një gazadritë tē mrrolur qē kishte parë nē sytë e saj e kishte habitur. Nuk i besohej, o paçi dritën e Zotit, qē një grua ta shihte ashtu! E kishte kërrusur shpinën dhe kishte bërë më tej, por Luçja nuk i ishte ndarë. I kishte thirrur përsëri "Rrens!" dhe këtë rradhë nē mënyrë edhe më shpotitëse.

Atëherë munshinjur Agushtinit i kishte vetuar si rrufeja diçka nëpër mend! Ai tha se ajo grua nuk i drejtohej atij me atë fjalë, por Bdekut. Ishte mëse i sigurtë tani se e kishte gjetur qē ajo e ngatërronte. Shumëkush i ngatërronin ata. O Perëndi, kishte thënë me vete munshinjur Agushtini, ajo më ngatërron me Bdekun!

## KAPITULLI I KATËRT

S'mbahet mend se si kishin rrjedhur ngjarjet më pastaj. Ajo kishte hyrë nē kishë prapa tij mospërfillëse e zemërake, pastaj kishte shkuar tek një bankinë e kishte nisur tē lutej, pastaj e kishte lënë lutjen dhe, e skuqur dhe e ndezur flakë, i kishte thirrur përsëri

**“Rrens!”. Pastaj kishte nisur tē qajē, duke e sharē e duke e mallkuar, pastaj i kishte thēnē se donte tē rrēfehej.**

- Dua tē rrēfehem, o shpirt i zi si djalli,- i kishte thēnē.

Munshinjur Agushtini kishte shkuar nē rrēfimore dhe ajo i ishte rrēfyer atij nē vend tē Bdekut. Mē dēgjon o Bdek, o mēkatar? - i kishte thēnē.- Dua tē rrēfehem tek ty. E kam menduar prej kohēsh, por sot dēshirēn e kam tē madhe. Pērse nuk mē erdhe mbrēmē? Nuk kam qenē kurrē kaq e poshtēuar, doja tē mē ngushēlloje, por ti je mérzitur me mua. Mē le gjithē natēn duke pritur, gjithē natēn me sytē nga rruga, po ti kushedi se tek cila ke qenē. Ndoshta tek Rexhina, ndoshta ke qenē edhe tek Domenika. I poshtēr dhe zemērzi si djalli! Mos m'i vēr re lotēt, nuk ndjej asnje keqardhje nē shpirt pēr ty, ndjej veç urrejtje! Ah, veç urrejtje, urrejtje... Por ja, po mē dridhet buza. Jam e dobēt, mallkoj veten tani qē tē mallkova ty, sepse ta dish, s'ka grua tē tē dojē kaq sa tē dua unē. Asnjē grua tjetēr s'mund tē tē dojē kaq marrēzisht. Pres me ditē e pres me net qē tē jemi bashkē nē njē shtrat dhe kur mē vjen, kur fus kokēn nē gjoksin tēnd dhe kur mē tleh me atē era myshk qē mban, atēherē bēhem si e marrē nga lumturia. Nuk e di ç'magji mē ke bērē me sytē dhe me zērin tēnd, nuk e di pērse mē drithērohet trupi kur mendoj pēr ty. Eja sonte, do tē vdes po nuk erdhe, si qiri do tē tretem...

## KAPITULLI I PESTË

I kishte ikur fiqiri dhe e kishte pushtuar tmerri nga kēto fjalē munshinjur Agushtinin e ngratē!

Kur kishte ikur Luçija, ai kishte ndjerē se i villej. Kishte dalē prapa kishēs dhe atje kishte nxjerrē vrer jeshil. Pastaj kishte hedhur vēshtrimin rreth e rreth. Zot, si ishte bērē ai vend! Njerēzit ishin prishur. I shētiti sytē nēpēr kurrizet e maleve tē zhveshur, nēpēr grykat e thella qē çanin shkēmbenjtē dhe tha se po shkatērrohej e po prishej gjithċka. Jetojmē nē kohē tē errēta, tha, gjersa njē munshinjur si imvella Bdeku merret me fajni tē tilla! Zot, si nuk e ka frikēn e ndēshkimit?! Si mund tē jetē njeri yti njē horr e njē pusht si ai?!

## KAPITULLI I GJASHTË

Bdekun e kishte gjetur nē shtēpi. Ai kishte ardhē aty qē nē atē kohē qē munshinjur Agushtini pat marrē rrugēn pēr t'u ngjitur tek famullia nē mal. Qe e hēnē (sipas kalendarit tē tyre, sigurisht) dhe tē hēnave ata mblidheshin me njēri tjetrin. Munshinjur Bdeku vinte nga famullia e Shndreut, kurse munshinjur Agushtini nga e Shndout. Puqeshin nē shtēpinē e vjetēr tē atēnisē qē ishte nē zgripin e njē shkēmbi dhe buzē njē pērroi tē rrēmbyeshēm. Munshinjur Agushtini e gjeti munshinjur Bdekun tē shtruuar rehat nē çardak dhe ishte aq indiferent sa nuk shfaqi asnjē interes qē ai po i shkonte vrultazi. Zonja Hura po milte dhitē dhe dukej kurri i saj tek dera e vathēs.

- Satana! - i shfryu munshinjur Agushtini

munshinjur Bdekut me tē dalē nē çardak.- Judē e Luçiferr! - e mallkoi me dufin e atij qē ziente nga inati.

Por tjetri s'e prishi terezinē. Ktheu kokēn nga ai dhe nisi ta hetojē mē njē vēshtrim tē pjerrēt.

- Po mē thua Satana e Luçiferr, munshinjur Agushtin?! - i tha.- Po mē shtyn qē tē zemērohemī dhe tē zihemi vēlla me vēlla? Mē thuaj, ç'tē paska pickuar qē mē vjen si njē kērriç gomari dhe turfullon kēshtu?

Munshinjur Agushtini mbeti i shashtisur nga kjo gjakstohtēsi dhe pēr herē tē parē nē jetēn e tij nuk e mbajti veten. Si i zuri nē gojē emrin e Luçijes, iu gērhush dhe ia flakēriu me njē shpullē nē faqe, pikērisht nē atē pjesē ku dukej njē pjesē e bardhē mishi e zbuluar nga qimet. Pastaj e hoqi dorēn pas dhe e mblodhi sikur i dhembī. Kishte ndodhur njē gjē e madhe midis tyre, s'mbahej mend qē kur s'ishin qēlluar ashtu. Munshinjur Bdeku nxori shaminē dhe fshiu faqet, pastaj hundēt dhe e futi pērsēri shaminē nē xhep.

- S'ka dyshim qē je kērriç, Agushtin,- foli me njē fije zēri.- Kētē qē mē bēre s'e lan dot. E di, diç paske mēsuar pēr Luçijen me atē mēndjen tēnde prej shushku. Pēr vete kujton se je njē shenjt, por po ta them se s'ndryshon fare nga njē copē fekaleje. Ti ke pēr tē ngordhur si qen me atē mendjen tēnde prej hajvani. Si s'tē vjen turp qē e lēshon atē dorē? Po ti e di qē s'ta kthej, se tē merresh me njē prift si tu, ēshtē njēsoj sikur tē ndotēsh duart me tē pēgēra.


Munshinjur Bdeku e fshiu edhe njēherē vendin e

pēllēmbēs me shaminē e pastēr dhe e shikoi se mos i kishte dalē gjak.

- E pashē Luçijen qē zbriti nga kisha, i tha.- Dhe sikur e di qē ti e ke detyruar tē tē rrēfehet. Ajo t'i ka thēnē tē gjitha, kēshtu qē ty tē ēshtē ndezur zjarri i pushtit. E di se ç'shenjt je, e ke treguar qē atēherē kur doje tē pērdhunoje ato vajzat e vogla, kēshtu qē Luçija tē ka trazuar si mashkull. Çfarē i bëre, i the ta shtrije tek muzhdakrat prapa kishēs dhe ajo nuk deshi? E fērkove ndonjē cikē dhe ajo t'i ndezi sytē me ndonjē dackē?

Munshinjur Agushtini dridhej dhe e pat humbur mendjen. Kishte flutruar s'dihet se ku dhe i kishte ikur drita e syrit. Bērrylat i kishte mbēshtetur nē parvazin e çardakut dhe shikonte nga brigjet e gurta tē pērroit qē dergjeshin nē diell. Shtrati i tij me zaje tē bardhē frugullohej, ndërsa vija e ujit qe shterur krejt. Munshinjur Agushtini sikur e kishte harruar Bdekun, sikur kishte harruar se çfarē ndodhi njē çast mē parē. Tani pēr tē s'kishte mē asnjē farē kuptimi tē ishje qēnie e kēsaj bote. Tē dukej sikur rrekej tē gjente nēpēr pafundēsinē e qiellit diçka qē ta risillte nē jetēn e tij tē pērkorur e tē pērkushtuar.

Kjo e bëri munshinjur Bdekun t'i endej nēpēr buzē njē nēnqeshje tallëse. Tha me mend qē ta çmendte me kērcimin e tij dhe u ngrit e doli nē mesin e çardakut. Hapi kēmbēn anash dhe bëri njē rrrotullim. Pastaj i valēzoi duart nē ajēr dhe bëri rrrotullin nga ana tjetēr. Çipat e sarafanit i hapeshin e i frushullonin. Pastaj bëri ca hedhje pērpjetē e ca valēzime shpatullah, duke i shoqēruar lēvizjet me kēngēzim



nēpēr hundē. Munshinjur Agushtini u pērmend dhe tha:

- Ia ke shitur shpirtin djallit, munshinjur Bdek!

## KAPITULLI I SHTATË

Kështu kishte ndodhur qē midis tyre nisi një sherr si pēr tē ngrënë kokë. Munshinjur Agushtini nuk i kishte llogaritur pasojat qē do tē vinin nga ajo ngjarje. Luçija, qē tashti e kishte marrë vesh gjithë ngatërrresën qē nxorri atë sekret, i shkoi nē famulli. I kërkoi munshinjur Agushtinit tē bisedonin dhe ai mezi e kapērceu zemérimin qē kishte. Idridhej një tik nervor nē faqe dhe mezi e mbante veten. Por nuk kishte si ia refuzonte kërkесën pēr tē folur asaj mëkatareje. E veshur dhe e ujdisur sa tē merrte mendtë, ajo dukej sikur kishte ardhur enkas pēr ta turbulluar. Kishte hedhur mbi leshrat e zeza një lahuri tē bardhë, jelekun, ku i dukej një pjesë e kurmit, e kishte me gjymryshe, kurse fundi ishte i zbukuruar me gajtanë tē shndritshëm. U ul nē shkëmbin e drunjtë pērballë tij dhe munshinjur Agushtini ndjeu se i erdhi deri tek hunda aroma trallisëse e trupit tē saj. Një erë gruaje qē tē vështronë me ca sy tē zinj, lëngëzuar nga një masë e panjohur materieje qē tē joshte pēr mëkat.

- Munshinjur, - i tha Luçija me një zë tingëllues. - Ti je mëkatari dhe jo munshinjur Bdeku. Bdeku më është zemëruar dhe më ka braktisur siku r tē ishte faji im qē t'u rrëfeva ty. Ai një shkak donte dhe shkakun ja ku e gjeti.

Ajo grua e mallkoi gjysēm dite nē qelēn e tij dhe ai nuk mundi t'i kthejē njē fjalē. Ishte shkatērruar gjithçka mesa dukej nē shpirtin e atyre njerēzve. I kishte zaptuar Satanai pérderisa viniñ dhe e akuzonin nē emēr tē shthurjes dhe tē tundimeve mēkatore tē kēsaj bote. Nuk ishin ata mēkatarət qē zhgērryhesin nē fēlligēshtitē e jetē, por ai qē qe pērpjekur qē shpirrat e tyre t'i ndriçonte drita e Zotit!

- Munshinjur,- i thirri Luçija si pēr ta pērmendur kur qe lodhur e qe mērzitur sē mallkuari.- Bdeku ka njē djersē tē rēndē, kurse kētu tek ti mban erē gjymrysh. Kur t'u rrēfeva atē ditē, nuk tē thashē se kemi ardhur kētu edhe herē tē tjera, kur nuk ke qēnē ti. Bdeku vinte nga ana e pyllit, kurse unē, si sigurohesha qē ti ikje, ngjitesha dhe rrinim kētu nē qelēn tēnde. Kemi bērē dashuri sa jemi ngopur, munshinjur, dhe nami ka qenē yti. Na kanē parē kur kemi hyrē e kemi dalē dhe njerēzit kanē thēnē se nuk əshtē Bdeku qē vjen me mua, por ti. Pērse mē rri buzēvarur si njē cjap taní, dēgjon?

Luçija kukurisi dhe sytē i shkēlqyen e i drituan. Ajo e kishte zēnē gojēn me dorē dhe flakērinte nga gazi pērmas njē bukurie qē i vetētinte si zhiva. Munshinjur Agushtini nuk merrte frymē. Ishte si i çartur nga zbulimi qē i bēri ajo! Domethēnē, njerēzit thoshnin se ishte ai qē shkontakte me tē dhe jo Bdeku! Le tē thonin, pati njē marrēzi ta pranojē kētē gjē. Ai pērgjigjej para Zötit dhe jo para njerēzve.

- Shko,- i tha Luçijes me njē zē tē pērbajtur.- Shko dhe t'i faltē gjynahet Zoti!

- Munshinjur,- ia ktheu Luçia pērmas vetētitjes sē

fytyrës së saj të bukur, - mos më pérze se të shoh në sy që e ke futur shpirtin në mëkat. Tì mezi pérmbahesh, eja!

Atëherë munshinjur Agushtinit i ngjau sikur dikush i hodhi në kokë një qypore me ujë të ftohtë. Nuk e pati pér gjë të ngrihej e të ikte si i paedukatë. As i tha se biseda midis tyre kishte mbaruar, as e bekoi me ndonjë fjalë të ëmbël, por i ktheu kurrizin dhe shkoi drejt derës së kthinës së tij. Nuk pat ndodhur asnjëherë që ta shfaqte kaq hapur para besimtarëve brutalitetin e vet. Ai kishte qenë gjithmonë pér ta një njeri fjalëmbël dhe durimtar. Por kjo e paudhë ishte ndryshe, ajo të fuste në ngasje dhe munshinjur Agushtini qe tmerruar nga mendimi i mëkatit.

## KAPITULLI I TETË

Bëri tri ditë jetën e eremitit në qelën e tij dhe doli që andej vetëm atëherë kur mendoi se e kishte pastruar shpirtin me lutje ndaj Zotit. Atë ditë që ai mori të zbresë pér në shtëpinë e atënisë, kishte rënë shi dhe ajri qe shplarë. Munshinjur Agushtini qe lutur që të mos e tundonin ngasjet e kësaj bote, por nga kjo gjë vuri re se nuk kishte shpëtuar dot. Ja, si doli tek udha e qiparisëve, ndjeu se si i gëzohej zemra pér ditën e freskët dhe pér ajrin e kthjellët. Tek Kepi i Andrrës mbajti këmbët dhe shikoi shtëpitë e katundit aty poshtë që ngjanin si një kopsht i mbjellur me kërpudha. Me mure guri dhe me çati me plloça të hirta, ato mezi i dalloje në atë pérhimëri të peisazhit shkëmb e gur. Zot, si e ke bërë jetën në një shkreti të

tillē, tha me vete munshinjur Agushtini. Domethēnē, nē tre katundet qē kapte famullia e tij dhe nē tre tē tjerēt qē kapte famullia e tē vällait, munshinjur Bdekut. Katēr pllaja tē gurta qē zbrisnin nga katēr faqe malesh tē larta e tē zhveshura. Tē ngjante se mē tej maleve nuk kishte mē jetē, por humnera plot mistere. E bēnin edhe mē tē tejme jetēn e matanēmaleve ca re tē bardha qē lundronin plogēsht nē njē qiell tē rimitē.

Munshinjur Agushtinit i pēlqeū t'i shikonte shtēpitē e katundit aty poshtē. Sikur s'i kishte parē kurrē, ja ashtu iu trand zemra dhe i rrahu nēpēr gjoks. Pa disa tē kreut qē vinin nguc e nguc me njéra tjetrēn, pastaj i kapērceu sytē matanē cifundeve tē mullirit dhe pa shtēpinē e Luçijes. Mbi kulmin e saj lēshoheshin degēt e njē arre. Po habitej se si nuk po i mrrolej syri, kur kujtonte paudhēsitē e asaj gruaje qē banonte aty. Tha me vete se ishte edhe ai i dobēt e mēkatar si gjithē tē tjerēt. Kjo e pikēlloj munshinjur Agushtinin, i cili u kērrus dhe ndoqi rrugēn qē kishte marrē, domethēnē njē dredhore qē zbriste pērmes gjineshtrave.

Nuk po i ndahej mendimi se feja nē ato anē nuk e kishte mē pushtetin e parē mbi njerēzit. Feja qe shthurur, tha me dēshpērim. Kjo krahinē, qē kur qenē shfaqur taboret e Bojrogut, mbeti ngushtē. Rruga e Vjetēr, qē dredhonte nēpēr gryka pēr nē ipeshkvi, nuk punonte mē. Po bēheshin shtatēdhjetē vjet qē krahina qe ndryrē nē njē vetmi rrēnuese. Gjatē atyre shtatēdhjetē vjetēve famullitē e kishin humbur rēndēsinē e parē.

Po, po, ishte i dëshpëruar, tha me vete munshinjur Agushtini, por këtë dëshpërim e kishte të fshehur me shumë kujdes. Ishte i dëshpëruar, sa s'ka, përsëriti. Nuk kishte qenë e dobishme për asgjë gjithë ajo përkorja dhe përkushtimi i tij. Sikur qe zgjuar dhe pat vënë re se asnje gjurmë nuk kishte lënë puna që kishte bërë. Njerëzit vazhdonin të mos vinin në kishë dhe më në fund, ja edhe Luçija. Më kot e kishte ruajtur atë pastërti kur njerëzit thonin se ai shkonte me Luçjen. Dhe jo vetëm me Luçjen. Bdeku mund të kishte ngjitur në qelën e tij edhe gra të tjera, për shembull Rexhinën dhe Domenikën. A nuk ia kishte përmendur Luçija emrat e tyre? Kështu që dilte se ai shkonte edhe me to.

Iu qesh. Një gaz i largët, i hidhur. Kishte dalë tek guri i Shugjanit, mu mbi çatitë e shtëpive të para. Mbajti këmbët. Si do të zbriste? Sikur ishte lakuriq dhe ndruhej të dilte në sy të njerëzve. Tani s'ishte më munshinjur Agushtini, por një mëkatar me shpirtin plot flligështi. Bdek, nuk e dija se mendja jote punonte kaq poshtërsisht, tha me vete.

## KAPITULLI I NËNTË

Ngurroi një copë herë atje tek guri i Shugjanit, pastaj mori përposh dhe zbriti për në shtëpinë e atënisë, këtë rradhë nga ana e kopshtit të lakrave. Bdekun, si edhe herët e tjera, e gjeti në çardak të mbështetur në ijë dhe me sytë nga gryka e përroit. Nuk iu durua dhe, pa mbërritur mirë, iu lëshua me ç't'i vinte në gojë, por zemërimit të tij përsa pat

ngjarē, Bdeku i pērgjigjej me njē moskokēçarje qē tē ngjethte.

- Mos kij dert, Agushtin! - i tha Bdeku.- Ti duhet tē mē falenderosh qē emri im punon pēr ty. Tani ta kanē zili qē ke shaluar ato tri rrunza, sidomos Luçijen qē ēshtë si llokum.

Ishte e qartē, tē gjitha i kishte bērē tē llogaritura. Ky ishte njē Satana dhe jo njē famullitar.

- Por Zotit nuk i fshihesh dot, Judē e Luçiferr, - i shfryu me tērbim munshinjur Agushtini.- Mē ke bērē djall nē sytē e njerēzve, por djalli je ti dhe do tē pērgjigjesh nē ditēn e gjyqit tē madh.

- M'i nxehet kryet! - rrudhi fytyrēn me pērcmim munshinjur Bdeku.- Mē çave kokēn me ditēn e gjyqit, kērriç gomari!

Atēherē munshinjur Agushtinit iu çartēn tē gjitha. Kētij cinizmit tē munshinjur Bdekut iu pērgjigj me veprime qē s'ishin tē denja pēr njē njeri tē edukuar. Iu lēshua dhe e qēlloj me dacka ngaqē tani qe mēsuar ta bēnte kētē gjē. U rrähēn deri sa u bēnē fērtele. Nē fillim munshinjur Agushtini i ra me shpullē dhe desh tē tērhiqeji si edhe herēn e parē, por munshinjur Bdeku, siç ishte shtrirē, çoi shkelmin dhe i ra te kupa e gjurit. Agushtini ia ktheu me shkelm nēpēr kērcinjtē e kēmbēve, atēherē Bdeku u ngrit dhe ia ngjeshi me grushta. Agushtini rrēmbeu stagarkēn ku ndernin varjet e specave, kurse Bdeku hyri nē kqoll dhe mori njē hu. Zonja Hura u tmerrua dhe vinte vērdallē me tē thirrura dhe me tē britura qē tē zbuteshin e tē zhgreheshin, por ata qenē kērleshur dhe qenē hakērryer dhe mē nuk dinin se ku i mateshin e ku i

**binin njëri tjetrit. Kjo zgjati deri sa u shfrynë mirë e mirë, pastaj shkuan secili në dhomën e vet. Munshinjur Agushtini dridhej si i llahtarisor, kurse munshinjur Bdeku fshinte hundët dhe qeshte.**

## **KAPITULLI I DHJETË**

Ka qenë një çudi pastaj me gjithë sa ndodhën e me gjithë sa ngjanë me munshinjur Agushtinin në ditët që erdhën. Ai sikur qe ndërruar dhe nisi të shfaqë ca huqe e ca zakone që s'i kishte pasur më parë. Një ndajnatë i la pa mend munshinjur Bdeku dhe zonjën Hura kur doli në të linjta e në fanellë leshi me shatin në krah dhe shkoi e punoi në kopësht deri sa u bë ujë në djersë. Një herë tjetër ujdisi parmakët e çardakut që qenë zërthyer e lëshuar. Tani ishte e pamundur të mos e shihje këtë njeri herë duke bërë herë një gjë e herë një gjë tjetër. Diku ngulte një gozhdë e diku merrej me një alet, nuk la rrangull e vjetërsirë pa e tundur e pa e shkundur, nuk la plaçkë pa e ngritur e pa e lëvizur nga vendi. Munshinjur Bdeku e shikonte nga çardaku me një fërshëllimë të lehtë në buzë, por pa e fshehur dot çudinë që i vinte. Edhe zonja Hura e ndiqte me ca sy të shqyer që nga qoshet e që nga skutat e shtëpisë ku punonte, sidomos kur ky i sillej nëpër këmbë dhe i përzihej në punët e saj. Munshinjur Agushtini nisi të mjelë dhitë dhe të lajë graçat dhe kusitë e qumështit, duke e bërë zonjën Hura që t'i ruhej e që t'i trembej.

Por pastaj munshinjur Agushtini u mbyll. Rrinte në qelë, në kishë, dhe nuk zbriste me javë të tëra.

Ndonjē besimtar qē shkonte, e priste si i pērgjumur e si nē njē botē tjetēr. Bdeku humbte edhe ai, por jo nē qelēn e tij. Ai i hipte mushkēs dhe, si bēnte katēr pesē ditē nēpēr shtēpitē e krahinēs, kapērcente grykēn dhe hidhej matanē, nē nahitē e qytetit. Shkontakte nē Urbs, thonin, tek Bojrogu, por munshinjur Agushtini nuk e besonte qē puna tē arrinte deri aty.

## KAPITULLI I NJËMBËDHJETË

Mbas njē dimri tē gjatē qē kaloi kështu, mbas mérzisē qē pruri prishja e vëllezërve dhe mungesat e tyre tē gjata, erdhën ditēt e njē behari, qē sikur ia kishte behur tinēz dhe i kishte çelur kumbullat e egra nēpēr gardhiqe. Nē njérēn nga këto ditē, nē hajatin ende tē ftohtë tē kishës, por duke prurë aromën idhcake tē luleve tē egra qē çelnin, u shfaq Luçija qē nuk qe dukur prej shumë kohësh. Kjo grua ishte zhdukur qyshkur dhe munshinjur Agushtini sikur u zgjua i trandur kur ndjeu frushullimën e rrobave tē saj tek vinte. Pat ardhur Bdeku mbase dhe kishin lénë ndonjē takim? Bdeku po bēnte shumë kohë edhe ai qē s'qe dukur dhe mbase kishte ardhur dhe ia kishin nisur përséri me njëri tjetrin.

Po ajo iu shfaq me një fytyrë tē prishur dhe tē pikëlluar, tē thoje se nuk njihej më. I patën rënë mishrat dhe i qenë zbërthyer sytë, i qe firaksur gufimi i gjoksit dhe nēpēr trinat e duarve tē dobësuara i dukeshin damarët.

- Munshinjur,- u shkreh ajo nē ca lotë qē i

**shtrēngonin grykēn,- Jam e mjerē dhe kam nevojē pēr pērdēllim. Nē kētē botē tē mallkuar ti vetēm je i shenjtē.**

Ajo i ra nē gjunjē dhe i puthi dorēn. Fērgellonte e qante, diç donte t'i thoshte pērmes njē belbēzimi, por nuk i bēhej e nuk mundej. Munshinjur Agushtini u mundua ta qetēsojē dhe pastaj e çoi nē qelēn e tij. E uli pērballē nē njē shkēmb dhe i kērkoi qē t'i tregonte se çfarē i kishte ngjarē! E pyeti se a mos kish qenē e mbyllur qē nuk qe dukur pēr njē kohē aq tē gjatē? Jo, i tha Luçija, nuk kam qenē e mbyllur, por kam qenē nē qytet. Kam punuar dhe kam nxjerrē bukēn e gojēs sime, kishte thēnē dhe kishte heshtur, duke parē si nē zbzazēti. Nuk e paske marrē vesh munshinjur?, pyeti. Jo, ia ktheu munshinjur Agushtini, nuk e kam marrē vesh, sepse kam qenē i mbyllur edhe unē nē qelēn time dhe Zoti tē ma falē qē nuk kam pyetur pēr njerēzit.

Pastaj munshinjur Agushtini e pyeti se me çfarē ishte marrē nē qytet dhe Luçija iu pērgjegj dhe i tha me diçka qē iu pērndez nēpēr zē:

**- Me fēlligēshti!**

Ajo u egērsua vetmevete dhe, duke e parē shkitazi, pērsēriti:

**- Me fēlligēshti, munshinjur!**

Munshinjur Agushtini u pikēllua. Ai e vēshtroi me brengē dhe sytē iu pahitēn me njē perde lotēsh.

**- Po mē thua me fēlligēshti?**

**- Po, munshinjur, mē fēlligēshti,- tha Luçija.**

Nga njē baxhē zbriste nē qelē njē fashē drite qumēshtore dhe munshinjur Agushtini vēshtroi njē

hop tē gjatē andej. Qe i prekur. I shtrēngohej njē gur nē grykē dhe mezi pērcillej. Qysh kishte ndodhur qē ajo e mjerē qe prishur e qe shkatērruar ashtu? Ku kishte shkuar gjithē ajo Luçije bērē tani si tjetēr njeri?

- Mos mē prediko, tē lutem,- i tha Luçija, kur ndjeu se ai do t'i fliste.- Mos mē thuaj asgjē pēr atē qē kam dalē nga rruga e Zottit!

Asaj iu bēnē flakē faqet dhe i xixelluan sytē e zesē.

- S'ia kam rrēfyer askujt, po ty po ta them,- shfryu pērmes njē brenge dhe rrēnimi.- Kam qenē katērbēdhjetē vjeçe kur mē mori nē shtrat im ungi, Filipi. Prandaj dhe e pagoi me kokē, sepse ia patēn dyshimin tē mitē dhe e hodhēn nē lumē.

- Zot,- bēri kryqin munshinjur Agushtini, qē nuk e diti nē u trand ashtu pēr çvrgjērimin e saj, apo nga qē mēsoi se pērse e kishin mbytur Filipin.

Atij iu drodh koka. Mezi gjeti fuqi tē mbēshtillte mbas qafe jakēn e setrēs dhe i ngjau sikur e rrēnqethi tē stohtēt. Desh t'i thotē se nuk kishte ndēr mend t'i predikonte, por t'i thoshte se po mendonte pēr atē qē njeriu s'e ka tē lehtē tē shpētojē nga tundimi i mēkatit dhe se nuk kishte arritur dot ta pastronte shpirtin edhe ai ashtu siç donte Zoti.

- Po mendoja pēr gjēra tē tjera,- i tha me shpirt tē vrarē munshinjur Agushtini.- Po thoja se njē fytyrē e bukur, shpesh nuk ēshtē pasqyrē e njē shpirti tē mirē. *Saepe facia pulchra non est speculum animi boni*, pērsēriti nē latinisht.

Luçija nuk i ngriti sytē, por njē tik i rrahu nē çip tē buzēs. I linte tē kuptonte se e kishte marrē vesh se çfarē po i thoshte.

- Domethēnē, qē edhe njē shpirt i mirē,- vazhdoi munshinjur Agushtini, por aty pēr aty hoqi dorē nga spjegimet e veta. Qe mbushur me dēshpērim, prandaj dhe thirri:

- Kemi dalē nga rruga e Zottit, oh, ç'mallkim e ç'tmerr!

Njē dalldi po e hutonte dhe po e bēnte t'i buçisnin veshēt. Pastaj, si qe trembur vetmevete qē i qe turbulluar shpirti ashtu, ndjeu njē krisje qē i theri dhe i dhembī nē mes tē gjoksit. Vuri tē dy duart aty dhe rrotulloi sytē sikur shihte njē gjē tē frikshme.

Luçija u habit dhe i rrähēn qerpikēt.

- Munshinjur, mos do njē pikē ujē? Mos je gjē i sēmurē?! - u çudit dhe u llahtar is ajo.

Por ai po dridhej dhe Luçija u ngrit dhe e ndihmoi tē shkonte deri tek njē shtrat me postiqe. Aty ia zbērtheu jakēn e kēmishēs dhe nisi t'i fērkojē damarēt. Munshinjur Agushtini ia plasi tē qarit. Qau me lot tē nxehētē si tē njē fēmije dhe iu dorēzua krejt duarve tē saj qē i preknin mishin. Pastaj i kapi bērrylin dhe ajo ndjeu se ai po ia shtrēngonte.

- Munshinjur! - i thirri.- Mē lini, munshinjur, ju s'jeni mirē.

Por munshinjur Agushtinit i kishte ikur zēri dhe i qenē shurdhuar veshēt. Ai po shtrēngohej e po shtrēngohej mbas krahut tē saj, pastaj nisi tē dridhej. Atēherē Luçija briti:

- Lermē! - dhe e shtyu tutje.- Thuajmē qē s'je munshinjur Agushtini,- i ulēriu.- Thuajmē qē s'je ti!

Munshinjur Agushtini po pērmendej i trembur dhe po mundohej tē orientohej se ku ishte.

- Thuaj qē je Bdeku! - u çorr zēri i saj.- Ti nuk je munshinjur Agushtini! O Perēndi, mē thuaj qē nuk je munshinjur Agushtini! - dhe ia plasi tē qarit.

- Jam munshinjur Agushtini,- u pērvaj zēri i tij.  
- Agushtini?!

Ajo e tmerroi me zgurdullimēn e syve qē sikur donin tē dilnin nga vendi. E pa me tmerr, pastaj nisi tē hiqej praptasi drejt derēs. Gishterinjtē e duarve i qenē tendosur si kthetra, si tē donte tē mbrohej nga dikush qē e ndiqte.

Por Luçija nuk pati fuqi tē shkontakte mē tej. Iu kēputēn gjunjēt dhe ra pērdhé. E mblodhi kokēn nē mes tē krahēve dhe aty nisi tē qajē me njē vaj tē gjatē, tē heshtur dhe me shpatullat qē i dridheshin. Munshinjur Agushtini tha se, si tē qante njē copē herē, ajo do tē ngruhej e ngushēlluar dhe do tē qetēsohej, por kjo gjē nuk po ndodhте. Luçija asjepte shenjē se do t'i rreshitte ajo e qarē qē i derdhej pērdhé me fytyrē ngjitur pas plloçave tē hajatit.

## KAPITULLI I DYMBËDHJETË

Luçja kishte pasur njē sēmundje tē keqe dhe kishte ardhur tek ai pēr pērdēllim dhe jo pēr ndonjē fēlligēshti. Vdiq nē vjeshtēn qē erdhi. Ka qenē njē mugullirē e ftohtē dhe e lagēsh kur erdhēn e i thanē se ajo kishte ndērruar jetē. U ngrit e veshi zhgunin dhe gjatē gjithē asaj kohe, si dhe gjatē proçesionit pēr nē varreza, munshinjur Agushtini e ndjente zemrēn tē pikēlluar. Luçja nuk ishte mē dhe kishte ikur si gjethet e asaj vjeshte qē i shkundte era dhe i

merrte pērpara. Por fluturoftë shpirti i saj nē Parajsē dhe gjettē atje prehjen dhe qetēsinē qē i mungojnē kēsaj bote, pērsēriste herē mbas here.

## KAPITULLI I TREMBËDHJETË

Si kaluan vjeshtët me njē trishtim qē bridhte nēpēr ajér, erdhën ditët e dhjetorit me dēborērat e para. Nē njē nga kēto ditë, pērimes njē frullize sllogash qē shtronin e zbardhnin, nē qelën e tij u duk Domenika. Kjo ishte njē grua si nja tridhjetë vjeçë.

Domenika pruri fjalë tronditëse. Luçija nuk qe rrēfyer dhe kēshtu e shkreta kishte vdekur me brengë qē po i shkonte Zotit si njē fajtore e papērdëllyer. Qē ta lehtësonte shpirtin, i qe lutur Domenikës dhe i kishte thēnë qē tē vinte nē kishë dhe t'i ndizte një qiri.

- I qe mbushur sē shkretës shpirti me terr,- i kishte thēnë Domenika munshinjur Agushtinit.- Ishte e tmerruar e gjora. Njeriu bēn mēkate, por ka njē shpresë pēr pērdëllim, kur mendon se ka njē njeri ku tē shkojë e tē pastrojë shpirtin. Një njeri tē shenjtë, munshinjur, qē tē jetë ndryshe nga gjithë mēkatarët e kēsaj bote.

Ajo kishte mbērthyer nofullat pēr një hop tē gjatë, pastaj ishte ngritur. Kishte nxjerrë qē nga nēnbrezi një qiri dhe e kishte ndezur mu nē mes tē kishës.

Kjo ia kishte rēnduar shpirtin shumë munshinjur Agushtinit. Nuk e kishte ndjerë veten kurrē mē liksht.

## KAPITULLI I KATËRMBËDHJETË

Si ndenji një javë në kishë, munshinjur Agushtini tha tē dilte nëpër katunde. Zbriti në shtëpinë e atnisë, ku zonja Hura e priti me lot ngaqë ishte ligur e dobësuar, por ai s'i bëri zë, veç nxorri mushkën dhe i hipi. Mori për nga brigjet e përroit, nëpër kopshtijet e lakrave dhe nëpër pemtore. Zonjës Hura i tha zemra se ai s'do tē kthehej më. Ishte si në atë botë, i verdhë si meit dhe me sytë që i mbante përdhë.

Oh, vërtet zonja Hura kishte pasur tē drejtë! Si kaloi java dhe po mbushej e dyta, ajo më kot i kishte hedhur sytë nga Guri i Shugjanit, nga zbriste një monopat gurësh tē bardhë. Munshinjur Agushtini nuk u kthye. Zot, mos është rrëzuar gjékundi nëpër gryka?, pyeste zonja Hura dhe fshinte sytë me cepat e shamisë së kokës. Humbën tē dy. Në fillim Bdeku, pastaj, ja edhe munshinjur Agushtini.

# LIBRI I DYTË

## KAPITULLI I PARË

Kish mbimun bari e ish rritë shkorreti e i kish zaptue têrshana e egër oborret e dyert e mbylluna si tê kishës së Shndout ashtu edhe tê kishës së Shndreut. S'ishin ma munshinjur Agushtini e munshinjur Bdeku e s'shelte ma, veç në tê rrallë, kambë njeriu në Shndu e në Shndre.

- Po bahan mote që s'janë,- tha me vete zonja Domenikë dhe ndjeu një tê shtrydhtë tê zemrës kur hodhi sytë e pa rrugën shkretë që i ngjitej malit. Tuj qëndisë në shalurthin me drësas, tha me za:

- Ç'trishtim, o Zot, që ta trand zemrën!

I erdhnë në mend meshat e munshinjur Agushtinit dhe e pati për shpirë tê çojë sytë nga qielli e tê thotë me za tê priftit: *fortitudo mea, et laus mea Dominus.*<sup>1</sup>

S'ish e para herë që mugullonin nga shpirtnat e

---

1) lat: forca jonë e lavdi ynë është Zoti.

njerzēvet ca lasha t'harruem e qē nxirrnin kryet pos i  
ata çkallojtē e barit e pos i ato bifkat e reja mbi  
kalbēsinat e gjerdhnave tē vjetēr. Ca shndritje qē  
dukeshin pos i bllana dielli qē bien nga njē qiell i  
vrenjtur, ose pos i llastarēt e cermedellit qē nxjerrin  
kryet mbi gēmushat e thata kur i vesít dhe i lan shiu.  
Mund tē dēgjoje mērmērima tē tilla edhe aty ku nuk  
ta priste mendja, nēpēr humbētira dhe nēpēr harrane  
tē thella. Mund tē gjeje nē skuta tē humbura njē njeri  
qē, si i trembur dhe i shastisur nga vetrnia e tij, niste  
e thoshte ca fjalē shpesh tē pakuptimta, por qē kishin  
njē efekt tē çuditshēm shērues...

## KAPITULLI I DYTË

Ja ashtu siç po bēnte atē ditē njē ngjesharan si trung  
vgjeu, njē humbaq a mēnjanár qē tē shumtēn e kohēs  
e kalonte vetēm. Atē e quanin Vrana dhe, i vetēm  
nēn kupēn e qiellit, ia kishte nisur ca mērmērimave  
qē gjithkujt mund t'i dukeshin tē habitshme. Ai po  
thoshte me njē prirje pēr tē shikuar nga qielli se unē  
tē lutem nuk di, o Zot, edhe shurbesat nuk di t'i bēj,  
por zemra mē çon nē kishē dhe unē shkoj dhe e hap.  
Ja kēshtu po thoshte ky njeri qē nuk ishte kush tjetēr  
veçse mullixhiu i tē gjashtē katundeve dhe qē nuk  
dihej se si e kishte zērin. Ky leshakan me njē setēr  
gjithē arna, ia kishte nisur kēshtu tē kērkonte gjēra  
qē s't'i rrakte mendja nēpēr tē fshehtat e kupēs sē  
qiellit. Kishte mbaruar blojet dhe po lante kēmbēt  
buzē vijēs sē ujit. Njē karkalec i madh i qe ngjitur nē  
zverk, por ai s'e ndjente se i kishte humbur mendja

krejt. As thonjtē e kēmbēve, qē i qenē bērē si kocka breshke dhe qē po i shikonte me sy tē jeshiltē, nuk po e sillnin dot nē vete. I qe kujtar se duhej tē hapte Shndunē. Ishte dita e Pelegrinazhit dhe nē kētē ditē, nē Shndu, vinin nga e gjithē krahina, sado pak dhe sado rrallē, sakatē e çyrykē. Ata kalonin njē natē pranē Zemrēs sē tē Pērdēllyeshmit, duke iu lutur Zotit qē t'i shpētonte nga mundimet. "Ta hap se jam i kishēs, si famullitar,- tha vetē me vete Vrana.- Por tamam famullitar jo," - kundērshtoi aty pēr aty. Veç mund tē thoje pa droje se atij i kishin mbetur nē kurriz ato gjēra. S'mbaheshin mend sa vite kishin shkuar qē kur munshinjur Agushtini, hipur nē mushkē, kishte ardhē pēr herē tē fundit nē mullirin e tij. Qe ligur e qe bērē lakran, lēkura i qe trashur si eshkē, por mē e keqja qe se ai njeri dukej si i lajthitur. "Vrana,- i kishte thirrur pa zbritur nga kafsha.- po t'i lē ty çelēsat e kishēs". Ky nuk pat lēvizur nga vendi se nuk po e kuptonte se pērse munshinjur Agushtini donte t'i linte çelēsat e kishēs. "Kam me ik, s'kam me u kthye ma,- kishte vazhduar tjetri.- S'kam se kujt t'ia le tjetēr". Vranēs, qē po i bēheshin ca pērbysje tē gjēmimshme nē kokē, iu ngjall njē dyshim dhe njē frikē. "Si po m'i le, po mē bēn famullitar?!" - e kishte pyetur. "Famullitar?!". Munshinjur Agushtini kishte zgurdulluar sytē. E kish vēshtruar njē copē herē si i ikur mendsh, pastaj ia kishte plasur tē qeshurit. "Zoti s'e qas tē tē kthehem me fjalē tē ashpra,- i kishte thēnē.- por ti i ke hak. Si tē tē bēj famullitar kur je njē gērdhū e trung i palatuar? Po t'i le se s'kam kujt tjetēr, prandaj." - dhe ia kishte lēshuar tufēn e çelēsave

nē dorē. "Ke qenē njeri qē vije nē kishē dhe Zotin e ke afēr"- kishte shtuar. Vranēs s'i rreshtnin gjēmimet e habisē dhe, kur munshinjur Agushtini pat kapērcyer cifundet e mullirit dhe mushka e tij e kishte mbushur rrugēn me kērtoça bajgash, i qe lēshuar nga mbrapa dhe e kishte mbērritur pērsēri. "Munshinjur,- i kishte thēnē.- A kam me e veshē zhgunin e famullitarit? A kam me thanē lutje dhe a kam me i ba shurbesat?". Munshinjur Agushtinit i qe trishtuar syri dhe e kishte spērkatur Vranēn me njē buzēqeshje keqardhēse: "Ruaj, o tē faltē Zoti, se mos t'i merr kush gurēt e kishēs,"- i kishte thēnē.

Ja kēshtu ky Vrana qe lidhur me kishēn, por zhgunin s'e veshi se si do ta vishte dhe shurbesa nuk bēri se si do t'i bēnte! Njē herē nē vit, Ditēn e Pelegrinazhit, merrte tē pērpjetēn e malit nēpēr ferrecka dhe nēpēr muzhdakrra dhe shkonte nē Shndu, ku bēnte hazērlēqet. I hynte me kosē e me sakicē barit dhe shkorretit qē zaptonin oborrin dhe, si i pērbystę dhe si i dergje tērē ditēn e ditēs nē diell kēto njomēshchina, i merrte krahē-krahē dhe i shtronte nē kishē dhe nē oborr qē njerēzit tē kishin se ku tē mbēshtilleshin dhe tē merrnin njē sy gjumē. Vinte tek kqolli i vjetēr pēr ata qē do vinin edhe njē kusi me bollgur, e cila ziente gjithē ditēn e ditēs e varur nē kamastēr.

## KAPITULLI I TRETË

Si mbaroi sē lari kēmbēt buzē vijēs sē ujit, ky Vrana u zgjat dhe mori çorapet qē i kishte nderur nē njē

**degē drize.** I mbathi dhe i ngjeshi mirē, pastaj mbathi edhe opingat dhe i ngjeshi mirē edhe ato, duke u lidhur gjalmat fort mbas pulpave tē trasha. U ngrit sikur e hodhi pērpjetē vendi kur rrinte, kapērceu shkarranen nēpēr njē shteg me gurē tē gjelbēruar nga myshku dhe doli nē rrugē. Ishte si njē cung bungu, nyjan e shpatullgjērē, dyzet vjeç burrē, me njē teste dhēmbēsh tē fortē si çatalli. Mbērriti nēpēr vijē tē mullirit nē lagjen buzē pērroit dhe kaloi para shtēpive me harkaqare guri. Dērrasat e çardakēve qenē nxirē nga koha, kurse shtyllat mbi qemerēt ndrisnin nga vlaga e pērroit.

Teksa kalonte para shtēpisē sē Domenikēs, pa qē ajo çoi kokēn mbi parmakē. Pastaj Domenika u ngrit nē kēmbē, ndërsa mbante qēndismēn nē dorē. Ndodhete shpesh qē Domenikēn e gjente nē çardak. Ajo e shihte dhe rrinte me sytē nga ai, por kurrē nuk pat ndodhur qē t'i thotē ndonjē fjalē. Me njē lahuri me ngjyra nē kokē, ajo ngjante si njē vajzē e re. Ishte e dobēt dhe syzbērthyer, por e bukur dhe nishanane me ata sytē dhe flokēt pis tē zeza. Kur vdiq Luçija, pat qarē sa i pat rēnē tē fiktit dhe e kishin kthyer nē shtēpi nē kurriz tē njē mushke. E kishte mbajtur vetē Vrana nē shpinē tē kafshēs, se nē varrim, pērveç munshinjur Agushtinit dhe disa pleqve, nuk kishte pasur burra tē tjerē. Edhe gra nuk kishte pasur nē varrimin e asaj mēkatareje, vetēm ca plaka tē gērrollura e tē thata si bukē pistili. Kurse Frederiku, i shoqi i Domenikēs, mezi mbante veten nē kēmbē. Qe i verdhē si limoni, sepse vuante nga sēmundjet. Vrana e kishte shtrirē nē kurriz tē mushkēs atē grua qē sikur e digjte njē

zjarrmi dhe i kērcisnin kockat nga dobēsia. Nē tē hyrē tē katundit ajo qe pērmendur dhe pat zbritur nga kafsha, duke u mbajtur pas krahut tē tij. Ç'i ishte dashtē Frederiku asaj, kishte thēnē Vrana me vete. S'ishte pēr Frederikun ajo, mēkat qē e pat marrē Frederiku!

Vrana ktheu kokēn pērsēri nga çardaku. Domenika pat hepuar trupin me shikim nga ai dhe cepat e shamisē i qenē zgjidhur. Harkaqaret e gurta i rrihite uji i pērroit qē shkumēzohej.

## KAPITULLI I KATËRT

Vrana ndjeu se kishte lēshuar zemēr nē atē grua, mbasi ajo i kishte mabetur nē mend. Tek po ngjiste dredhoren qē tē çonte tek Guri i Shugjanit, i gëzohej shpirti nga lulet e verdha tē gjineshtrave. Ato e mbulonin krejt dredhoren me tufalakët e luleve tē verdha, ndërsa aty këtu, mbi gëmushat e tyre, hidhte shtat kulpra me lule bojëshpate. Tē lante veriu nē atē kurriz kodre tē mbuluar si me leshra tē gjelbëra dhe kaçurrele nga bimësia. Po tē vinte Domenika, tha, ja mes atyre gjineshtrave, mund tē rrinin e tē kënaqeshin rehat me njëri tjetrin. Ishte fare e kollajshme, nuk i shihte kurrkush. Ajo dilte nē kopshtin prapa shtëpisë dhe merrte lakoren me barëra tē larta një bojë njeriu. Dhe aty dinte ai se ku e fuste dhe se ku e fshihte.

Kapi një tufalak gjineshtrash dhe ktheu kokēn pērsēri nga shtëpia e Domenikës, por qe rrotulluar shumë e taní kishte dalë prapa saj, kështu qē

Domenika nuk dukej më. Ai e kërkoi me shikim nëpër faqen me kamare prapa asaj ngrehine guri kur, kur s'e kishte pritur e kur s'e kishte kujtuar, i kishin zënë sytë Frederikun, të shoqin e saj. Frederiku rrinte lakuriq në kopësht mbi një tezgë të pjerrët dërrase. I kishin thënë të rrinte në diell që t'i dilte mardhaja dhe ai kishte zënë një strehëz dhe rrrezitej. Të dobët dhe të vogël sa një kalama, të verdhë dhe si të pajetë, kështu e mbante mend Vrana Frederikun që kur kishte qenë fëmijë. Me t'u dhimbëtë. Kur ngjitnin dhitë në mal, qëllonte që e rrihnin dhe i ishte dashur atij disa herë që ta mbronte nga sherretët. Sepse i vinte keq për Frederikun ngaqë ishte i dobët dhe kishte frikë gjithkënd. Pastaj kishte një zë që të dridhte zemrën, lutje prej të pafajshmi e të pafuqishmi, sy si të lagur nga lot që s'i terreshin kurrë. Veç mendjes. Veç mendjen e kishte brisk.

Me Domenikën Frederiku qe afruar në ditën e një dasmeje, që u bë në Hydër të Hyllit, katundi më në skaj, një grumbull shtëpish si vezë në një çerdhe turtulli dhe nën hijen e një mali të zi e të bruzët. Në dasëm atij i kishte rënë një si sëmundje toke, qe shtrirë përdhë dhe pat nxjerrë shkumë. Si e kishin hequr mënjanë dhe si ia patën lagur tëmthat me pak ujë vedre, e kishin braktisur se po shtrohej dreka dhe kurrkush nuk donte të mbeste jashtë sofre. Vetëm Domenika. Ajo po kërcente me ca shoqe në një shesh bari, kur vuri re Frederikun që e kishin mbështetur mbas dy trenëve të thatë dhe i kishin lënë tek qafa një shami të lagur. “Ku ku, i shkreti,- qe rrudhur Domenika.- Si e kan lan me e hangër mizat?“.

Dhe kishte shkuar e i kishte ngritur kryet. E pat rrahur me shuplakë në faqe dhe ia kishte tundur kokën leshane. Pastaj, kur Frederiku pat hapur sytë dhe po e shikonte, ajo qe shtangur. Nuk kishte parë kurrë sy që i luteshin ashtu, që i shprehnin një mirënjoyje aq të thellë dhe që i thërrisin tē mos e linte dhe tē mos e braktiste, sepse ishte i sëmurë, i dobët dhe fatkeq. Çfarë syshtë mëdhenj, bojë hiri me pika të gjelbëreme dhe me një pahitje të përhershme lotësh! Domenika kishte nisur tē dridhej dhe e kishte ngritur në krahë dhe e kishte çuar nën hijen e një gorrice. Aty Frederiku i kishte thënë me një fije zëri që tē mos e lëshonte dhe Domenika pat ndjerë se diçka i qe këputur në zemër dhe se nuk do ta linte kurrë atë njeri. Dhe kështu e mori edhe përburrrë.

Vrana ndjeu se i qenë rënduar këmbët dhe duart. Kishte qenë një kohë e gjatë mesa dukej që po mendonte, prandaj dhe qe plogështuar shumë. Por, edhe kur nisi tē ecë, ajo rëndi nuk po i hiqej nga gjymtyrët. **“I shkreti Frederik!” - tha kushedi se pse** me vete.

## KAPITULLI I PESTË

Por Frederiku s'asht me i thanë i shkreti, çoi Vrana nëpër mend dhe ndjeu një si pickim brenda vetes. Frederiku asht ku e ku, kryelogu dhe saka që ndan kuvendet, shtoi me idhni dhe me kunj, duke ecur nëpër ferreckat e faqes së malit.

Nisi tē ndjehej i bezdisur. I digjej zverku nga

shkulma e diellit dhe nuk e rrakte dot me mend se qysh i naltohej e se qysh i fisnohej ai rrëgjan e ai shpotak. I njante se i tretej si matanë një honi që nuk kapërcehej dot dhe andej merrte me vete edhe Domenikën. Ecje po tē doje sa tē mundje pastaj nēpēr ato ferrecka, por tek ajo nuk mbrrije dot.

Atje n'log tē burrave ai asht ma i miri, tha pēr Frederikun si pēr inat tē vetes. Ma i mirē se gjithë ne katakanët e boroshnjakët, i futi një këllëç vetes.

E kapi një tērbim që s'ishte kurrikush. Shfryu hundët, u kollit sa tē thoje se e çau gërmazin, pastaj çoi ca tē potershme, ja ashtu me zor dhe duke u shtrënguar fort. Pastaj qeshi si një gomar, si një hajvan, siç i tha vetes. Ia shkuli me sokëllimë sa tē thoje se trembte breshkat e malit, pastaj nisi tē bërtasë. Me demek se as i nxente kryet se si ishte Frederiku e se as që pyeste fare pēr atë kérçopan që lëngonte nga sémundjet.

Por s'e rrrente dot veten. Shkaku ishte Domenika. Me fytyrë tē zbehtë si hojet e mjaltit, me sy tē zjarrtë që i digjeshin, ajo t'i lunte ment e kresë. I bëhej sikur i sulej dhe e merrte nē krahët e vet, ndërsa druhej se mos e shkërmoque, ngaqë s'dinte se si ta kapte e se ku ta mbante. Si atëherë kur qenë kthyer nga varrezat dhe ai e mbante nē shpinë tē mushkës. Nēpēr pëllëmbë dhe nēpēr trinat e duarve i çiknin brinjët e saj tē holla si dhe gjintë e vegjël. Zot, si e kishe bëre ashtu atë grua! Ajo nuk kishte mish, por mëndafsh tē shkrifët që tē rrëshqiste nēpēr gishta.

Rrahu një krah ere nēpēr zverkun e tij dhe Vranës iu mbush gjoksi me serë tē shkrirë. Që nga zgripsi ku

kishte dalē, pa ca pellgje tē vegjēl uji nē shtratin e pērroit dhe afshi i nxehħē qē e digite e pērcelloi edhe mē shumē.

## KAPITULLI I GJASHTË

Si qe ngjitur nē Shndu, Vrana qe qetēsuar e pat rēnē nē paq kur u kish hyrē punēve. Deri nē mesditē i kish palosur me kosē njomēshtinat e oborrit dhe ato pērreth mureve me gurē tē vjetēr e tē thatē. I kishte hyrē shkorretit dhe e kishte nxjerrē nē drittē tē Zotit kishēn e Shndusē, e cila lēshonte njē hije tē bukur mbi oborrin e pastruar. Kryqi mbi kambanaren e vjetēr i qe nxirē nga koha, por ai sikur kishte marrē njē kuptūm tē ri me njē njeri qē punonte nē oborr, duke shtyrē me cfurk togjet e barit. Kish njē ajrī ritēse ajo ditē qē ta gēzonte zemrēn dhe Vrana hidh te herē pas here sytē nē tē katēr pllajat qē zbrisnin nga tē katēr malet e lartē dhe qē krijonin atē krahinē. Pērmes njē dielli tē bardhē gushti, gjithċka qe kredhur si nē njē tis drithērues dhe shtēpitē e largēta ngjanin si tē varura nē qiell, nē re tē opalta qē shtegētonin. Aty nga mbasditja nisēn tē mbērrijnē deri tek veshēt e tij zile tē largēta mushkash, qē lajmēronin se po vinin njerēz. Larg e larg e nēpēr ato dredhore qē zhgarravisnin atē peisazh bardhkaltērem shkēmbinjsh e sukash, ato binin si nē, njē ditē lutjeje dhe shprese.

I pari mbērriti nē Shndu Uka i Vukēs, mbi njē mushkē qē qysh o Zot rrinte nē kēmbē dhe qysh o Zot qe ngjitur nē ato tē pērpjeta. Uka ishte njē zhelan

e fukara i gjori, që kishte një këmbë të mpirë e të rrëguar, e cila i varej si rreckë. Sapo doli në oborr të kishës, Vrana shkoi dhe e ndihmoi që të zbriste. Mbaj andej e shty këndeje ato kockat e tij që i krikëllinin, arriti më në fund ta vërë në këmbë. Uka i Vukës zgurdulloi sytë nëpër fasadë të kishës dhe tha:

- Heu, bre, i qofshim falë të madhit Zot!

Ngëc e ngëc ai ia mbajti për nga kqolli ku ziente kusia e bollgurit dhe ku thërriste era e mirë e bereqetit.

- A po m'i jep t'i ha dy lugë, bre, - i thirri Vranës, i cili kishte marrë kupacët e drunjtë dhe po i shkonte pas. - Ma ka ngulë uja dhe do Zoti të kanë zi koqet e grunit!

Si e kish rregulluar mirë e mirë Ukën e Vukës, Vrana kishte dalë të ndreqte dy plloça mbi portikun e oborrit. Dhe që aty kishte parë tre vetë që vinin nga Shkira e Keqe me një mushkë. Ishte Gjon Përkoka bashkë me të shoqen, Shkurtën e Xhozefinë Ndreut dhe të bijën 11 vjeçë, Julian. Vinin nga një vend fare në skaj, shtatë male larg. E bija, Julia, ishte e verbër që nga lindja dhe ata e çonin nëpër shenjtë që t'i luteshin Zotit për t'ia falur atë sakatlëk. Qe edhe ky i Shkirës së Keqe zhelan e fukara, kishte veshur një sarafan me arna dhe ngjante si i pahitur me pluhur guri. E shoqja kishte një fytyrë si të shpendit dhe sytë i kishte të vegjël e të shndritshëm si xhixha. Veshur me një polkë të verdhë në të jeshiltë, ajo ngjante si një grua tartari. Kurse mushka e tyre ishte tepër e fisme: i shkëlqente qimja dhe palldëmët bashkë me rripat e ziles i kishte të zbukuruara me inxhi.

Vrana ra copē pēr ta, se ishin tē largēt. U ndihmoi tē shkarkonin dhe i çoi nē njē vend tē rregulluar mirē e bukur, me bar e me zhumbriçē mu nē mes tē kishēs.

## KAPITULLI I SHTATË

I kishte rregulluar mirē e bukur kēta tē Shkirës sē Keqe, po ku do ta dinte se çfarē do tē ngjante?! Sikur ia kishte shtënë Zoti nē vesh qē t'i priste me pekule ata njerëz qē kishin ardhë nga shtatë male larg. Atë natë, mu aty nē kishën e Shndusë, ndodhi mrekullia: vajzës sē tyre, Julias, i erdhën sytë!

O Perëndi, si u mbushën zemrat e njerëzve me dritë! Julia njëmbëdhjetë vjet qorre, shihte! Kishte ndritë një bllanë nē murin e thatë tē kishës, kishte feksur përmes mugullimës një njollë e kaltëreme dhe një zë i kishte thënë nē vesh: "Shif!". Julia kishte rrahuq qerpiqët dhe zëri i kishte thirrur përsëri: "Shif se Zoti ta dha dritën e syve!". Dhe Julia kishte parë! I qe hapur pamja dalëngadalë dhe kishte parë nē mur dhe rrëth vetes gjithë sa ishin aty. Në një krah ishte nana, nē krahun tjetër tata, qē i njihët nga fryma që lëshonin dhe nga gërhamat e gjumit qē i kishte zënë. S'i kishte parë kurrë ma parë dhe qe shtangur nē një kqyrje qē s'kishte tē sosur! Ata ishin tata dhe nana e saj?! Po qysh ishin ata kështu?! Po i dridhej dora dhe çoi e preku bërrylin e nanës. E preku me gishtat që iu shtrinë dhe e kapën mbas polkës sē verdhë. Pastaj preku gjunin e tatës. Ajo dritë e kaltëreme nē mur e têrhoqi dhe Julia pa andej. Ishte një si nana aty. "A asht e Lumnuemja?", pyeti veten me drithërimë. Nuk

dinte ç'tē thoshte dhe e nguci nanēn tek brryli. I thirri: "Nanē! Moj nanē! Nanē! Moj nanē!".

Atēherē nana hapi sytē, por qe e përgjumur dhe s'po e mblidhete veteri. Iu lut Zotit ta falte qē e kishte zënë gjumi dhe pastaj zgjoi edhe Gjonin. Pastaj kishte shtangē.

- Zonjë e Lumnueme! - kishte thirrē. Kishte parë nē mur ikonën e Zonjës me Krishtin nē krahë.- Zonjë e Lumnueme!

O Zot, kush e kishte prurë atë ikonë aty?! O Zot, nga kishte ardhë dhe si qe vënë nē atë mur ku s'kishte pasur asgjë?! Ktheu kokën nga Gjoni, por dhe ky kishte mbetë gojëhapët. Atēherë ajo lëshoi një thirrmë:

- Julia!

Kishte vënë re qē e bija shifte dhe thirri përsëri:

- Julia, moj bijë, a shef?

- Shof, moj nanë!

Asaj sa s'i kishte rënë rrufeja. Puqi duart dhe lotët i shkuani rrëke.

- Zonjë e Lumnueme! - qe shkrehur nē vaj me supet që i dridheshin dhe me zérin që i këputej.- Zonjë e Lumnueme! - Nisi tē falenderojë.

## KAPITULLI I TETË

Në atë kohë që pat ndodhur ajo mrekulli, Vrana po kalonte tallazet e çmendurisë së tij. E kishte rrëmbyer Domenikën, e kishte ngritur nē krahë dhe e kishte çuar nē pyll si ujku prenë e vet. E kishte bërë me mend që më parë këtë gjë. Si çdo vit, edhe atë

herē, Domenika e kishte prurē Frederikun nē kishē. E kishte hypur mbi njē pelē larane, mbi njē samar tē shtruar me qilim. Frederiku i qe dukur kêtē radhē shumē i kēputur, kurse Domenika kishte vesh ca tesha qē i rrēshqitnin nēpēr trup.

Kur kisha dhe oborri qenē mbushur plot, kur qenē ndezur qirinj e zjarre me flakē qē luhateshin nēpēr mure tē thatē, Vrana kishte zēnē tē ecē poshtē e lart me njē hap tē pērthyer si tē kalit tē qyqes dhe i hutuar e i humbur krejt. Midis grumbuje tē njerēzve, qē nxinin pērimes dritēs sē zjarreve, dallonte Domenikēn dhe Frederikun qē as lēviznin e as flisnin, po rrinin si tē pērhumbur nē rrēshanēn qē ua kish ujdisur ai. Frederikun, si tē kalonte njē copē herē, do ta zinte gjumi, kêtē Vrana e dinte mirē. Flinte si njē kalama, mbēshtjellē me duart nē mes tē gjunjēve dhe me njē mbulesē tē hollē qē Domenika ia hidhte krahēve. Si vitin e kaluar, si atēherē nē atē gjumē tē rēndē qē e kishte zēnē. Vranēs i kujtohej ajo qē ndodhi vitin qē shkoi. Kishte plasur njē potere se morēn zjarr ca barēra nē rrēshanat e oborrit, njerēzit kishin thirrē e kishin brritē, por Frederiku flinte. Vranēs i kishte mbetē peng qē s'ia kishte marrē Domenikēn atē natē. S'e zinte rehati qē s'e kishte nxjerrē gjer te kqolli dhe aty ta ngrinte nē krahē e ta çonte nē zabel tē ilqeve. Kurrkush nuk do ta kishte parē e as Frederiku s'do ta kishte ndjerē.

Vrana s'po dinte si ta ndrydhte padurimin e vet nē atē ngarendje lart e poshtē. S'kishte tē sosur ajo kohē sa njerēzit tē shtroheshin e tē qetēsoheshin mbasi tē ishin lodhur me llafe e me pyetje me njēri tjetrin.

Ata nxorrēn torbat e thekēn bukē e ngrohēn gjellē mbas zjarreve, hēngrēn duke u pērtypur me ato nofulla qē u ndrinin nēpēr flakē dhe pinē ujē me mashtrapa e me kacekē, por qenē xanxarē e s'po binin nē qeti. Vrana shihte shejzat e qiellit dhe vērtitej si i trembur. E kērruste kurrizin, ani se afēr zjarreve me njerēz e nēpēr sakatē qē e thirrnin t'u jepte ndonjē ndihmē. Por dikur gjithçka nisi tē fashitej. Ranē njē nga njē tē gjithē me rradhē, kush nē velenxat qē i kishin prurē me vete, kush nē rrēshqanat me bar e zhumricē qē kishte ujdisur ai dhe kush i mbēshtjellē mbas zjarrit nē rroba tē veta. Shejēzat tregonin se kishte kaluar mesnata dhe kishte zēnē tē frynte veriu i agut.

Vrana vuri re se goja i qe tharē dhe i qe bērē shkrumb, kurse zemra i rrihte kraharorin si me tokmak. Kqyrte rrēth e rrēth gjindjen e zēnē nē gjumē tashmē dhe nisēn t'i buçasin veshēt e t'i rrahin vrushkujt e gjakut. I iku njēherēsh si nē trembjē plogēشتia qē e kishte zēnē dhe ktheu kokēn me vrull nga Frederiku me Domenikēn. Ata po flinin: Frederiku i mbuluar me velenxēn e hollē, kurse Domenika me njē rrobē si me qēndisma. Ç'grua e paqme, i oshētiu sē brendshmi dēshira qē ta merrte nē krahē dhe tē ngopej me erēn e saj. Ta shtrydhite mbas vetes, tē ndjente nēpēr zjarrminē qē po e digje kērkēllimēn e kockave dhe tē brinjēve tē saj kur ta shtrēngonte.

U hodh pērpara me njē çap ujku, tanimē me sy tē jeshilosur dhe i papērmbajtshēm as nga plumbi. Mbērriti me muskuj tē ngrehur pranē shtromēs sē

tyre dhe u pērgjoi frysmaarrjet dhe gjumin qē bēnin. Frederiku ishte mbledhur kutullaç, kurse Domenika sikur pērgjonte sypulitur diku lart, si nēpēr lartësitē e qiellit. Duart dhe fytyra e saj sikur qenē bērē nga brumi i qirinjve, kaq tē zbehtē dhe si nē dritē tē yjeve dukeshin nē atē gysmēterr. Vrana u ul nē gjunjē dhe ndjeu se po dridhej. Ai çoi dorën dhe kapi dorën e saj. O Zot, ç'ishte ajo lēkurē ashtu dhe ajo ngorhtësi?! Çoi gishtat pak mē lart dhe nisi t'i férkojë kyçin.

Domenika hapi sytē. Buzëqeshi se kushedi ç'po shihte nē ëndërr, pastaj nisi ta hetojë me diçka qē i zgjohej e i përmendej nēpēr retinat e syve. Pastaj ajo u tremb. U ngrit njëherësh me qerpikët qē i rrïhnin dhe i tha:

- Vrana?!

- Le tē mē vrasë Zoti, por unë s'duroj ma,- qe shkrehur zëri i tij.

Ajo kishte kërcyer me vrull nē gjunjē dhe po dridhej me alarm.

- Ik, mor i marrë, lëshomë, hej ty ta shoftë Zoti hisen e diellit!

- Pash besën Domenikë, pash sytë e ballit, unë po çmendem!

Ajo ia shkëputi dorën nga kthetrat e tij, por Vrana u bë si shtazë dhe u hodh dhe e kapi përsëri. E mbërtheu nga supet dhe nisi ta têrheqë nga vetja.

- Ku-ku, ku-ku, unë e shkreta,- nisi tē qajë pa zë Domenika.- Lëshomë, pash besën e Zotit, lëshomë o Vrana, lëshomë!

Ai e kish ngjitur mbas vetes dhe e përvëlonte me frysma e nxehjtë qē nxirrite. Dikur Domenika nisi tē

lëshohej dhe atëherë Vrana mori hov tē ri. E ngriti nē krahë e u turr drejt shtegut tē oborrit. As qē pyeti nga degët e ilqeve qē i gricën fytyrën. Ia mbajti matanë dhe rendi drejt pyllit, qē nxinte nē atë buzag. Çapi i tij rrihte gurët nëpër heshtje dhe fryma i vërvhëllente si gjyryk.

Por dikur vuri re se Domenika qe lëshuar krejt dhe i qenë varur krahët si pa jetë. Ai e çoi nën hijen e një ahu dhe e vuri mbi barin e luadhit. Domenika ishte si e vdekur, as jepte e as merrte. Ai e thirri disa herë, ia luajti kokën andej këndeja, por ajo nuk përmendej. Veç qe ende e ngrohtë, në gjoks i rrihte zemra dhe një dorë i kishte mbetur tek gryka e lehorkës me temina si tē ruante se mos dikush fuste dorën dhe e trazonte.

Vranës iu dhimb. I erdhi keq qē ajo qe pështjellë si e trembur e si e tutur. Ia kapi dorën dhe ia hoqi mënjanë. Pastaj ia vuri gjithë pekule nē kupën e gjurit tē vet dhe ia mbajti mbështjellë me pëllëmbën e trashë e tē ashpër. Gjoksi i saj ulej e ngrihej dhe ngjante sikur Domenika kishte humbur nē një gjumë tē lehtë, me fytyrën qē i zbardhite nëpër pahun e dritës së hënës. Mandej i erdhi ligjst qē ajo e kish zënë kokën ters: ngulur nē barin e luadhit dhe me qafën e përdredhur. E ngriti dhe e ujdisi, ia hoqi ca cullufe floku nga balli dhe iu duk sikur ajo po e shihte dhe po e hetonte përmes qerpikëve tē pulitur.

- Domenikë,- i bëzajti me zérin qē i qe tharë.

Në qiell, nëpër hënë, kapérceu një re e hollë dhe Vranës iu bë sikur ajo lëvizi. Sikur hepoi pak fytyrën nga ana e tij dhe po e kqyrte nē tē fshehtë.

- Domenikë! - e tundi Vrana përsëri.

Dora e saj shkoi të kapte grykën e lehorkës, por Vrana nuk e la. Ia mbajti në të vetën dhe ia hodhi sytë nëpër kurm. Një e dridhur i kaloi nëpër shtat që e kishte aty pranë dhe ia rrëshqiti dorën nëpër lehorkë. Pastaj ia zbërttheu, ia afroi fytyrën dhe ia puqi buzët mbas mishit të saj të ngrohtë. Pastaj nuk diti më se çfarë bëri! U shkallua! E kapi një ulërimë e një tërmët! U mbush pylli me akshin e tij të rëndë prej burri. Ajo i lutej përmes brerimës së lotëve, por Vrana, i dalur mendsh, ia theu kockat dhe ia shtrydhi kurmin erabarbarozë. U grric nëpër thonjtë e saj dhe u dërrmua nga grushtat që i binin, por kjo ishte edhe më e bukur. Ta dinte se e vrissnin dhe ai s'térhiqej.

## KAPITULLI I NËNTË

Tek po ktheheshin, ajo i rrëshqiti nëpër duar dhe i tha se po shkonte përpëra, por Vrana çoi dorën dhe e mbajti. Ishin në të ngjitur të të përpjetës së kishës, hija e së cilës u rrinte atje lart mbi krye. Agu po zbardhët dhe Vrana dallonte tanë fytyrën e Domenikës që qe bërë edhe më e zbehtë, ndërsa sytë e saj rrëfenin për lodhjen dhe rraskapitjen që kishin kaluar. Ishte si e mpirë. Nuk i mbante tanë ndonjë inat Vranës. Ishte plotësisht në dorën e tij dhe sikur koha s'kishte kahje. Sikur ajo s'dinte se kush ishte dhe s'dinte nga kishte ardhë. Nuk dinte se ku do të shkonte. Sikur që shlyer në mendjen e saj gjithçka që kishte pasur të bëjë me të. Kishte mbetur vetëm ky çast, kur ai e shtërgonte mbas vetes dhe ajo, për herë të parë në

jetēn e saj, po kuptonte se diç kishte mbajtur ndrydhur e diç i kish fshehur vetes kaq e kaq kohē. Ia shkrifi trupin mendimi se ishte me plot dëshira dhe u ngjesh mbas tij. E kapi një zjarrmi dhe iu shua syri. Iu err gjithçka. E tērroqi Vranën drejt ca gjineshtrave, lulet e tē cilave tani nēpēr ag dukeshin tē pērhitura.

## KAPITULLI I DHJETË

Kur u kthyen, ajo qē panē ishte e habitshme. Nē oborr tē kishës nuk ishte kurkush! S'tē zinte syri kerkend nga gjithë ata qē kishin lënë tē fjetur e tē kotur nga gjumi! Dukeshin vetëm grumbuj zjarresh dhe grumbuj shtresash pa njerëz. Flakët digjeshin nē vetmi dhe pērskuqinin velenxat dhe gunat e hedhura si nē alarm.

Domenika nuk merrte frymë. Ktheu sytë nga Vrana, por edhe ai kishte mbetë i shtangët. Fytyra e tij e ngurosur, qē spérkatej me feksjet e bruzta tē zjarrit dhe me argjendin e dritës sē agut, e bënte edhe më rrënqethëse pamjen e shurdhët pérreth.

Atéherë Domenika, me mishra tē dridhura, u hodh pérpara. Çau përmes zjarreve pa njerëz si e vetrnja qenie qē e mbushte me jetë atë natë. Nē sytë e Vranës atë sikur e dogjën flakët. Ajo hyri nē hajatin e kishës dhe aty desh u rrëzua: njerëzit rrinin nē gjunjë, nē duar mbanin qirinj dhe shikonin tē ngurosur pérpara! Brenda njerëzit ishin edhe më tē dendur. Nuk lëvizte kush, qenë kthyer tē gjithë si gurë tē pérhimitë, me sytë tē mbérthyer nē murin pérballë.

Domenika s'e përmblidhte dot veten dhe kishte frikë. Ajo kishte parë në mur ikonën e Shën Mërisë me Krishtin, por nuk arrinte në ndërgjegjen e saj të pyeste se çfarë kishte ngjarë. Bëri kryqin dhe kërkoi me sy Frederikun: pamja e tij nuk i thoshte asgjë. Qe zgjuar dhe rrinte ulur brenda në shtresa.

I ranë lotë nëpër faqe. Supet iu drodhën dhe puqi duart me sytë nga Shën Mëria. Për herë të parë e kuptoi se aty kishte ndodhur një mrekulli dhe shtangu.

- Zonjë, ndriçoma rrugën se nuk di çfarë bëj! - mërmëriti dhe qe penduar në çast për çka kishte bëre me Vranën.

Madje e zuri tmerri kur vuri re se turmën e njerëzve e pëershkonte herë pas here një mërmërimë e mbytur dhe e gjatë. Ato ftyra të murrme nuk kishin dalë dot nga hutimi që i kishte zënë, por ishin bëre edhe më të humbura në vetyte dhe diç thonin si nëpër mjergull. Çfarë po thonin ashtu me ca fjalë që u dilnin së thelli, por që mbyteshin në një jehamë si shugullima e tokës kur merr dhe e tund tërmeti? Një shugullimë e gjatë, e njëllojtë, e vjetër si në krijim të botës.

## KAPITULLI I NJËMBËDHJETË

Kur ra drita dhe jashtë doli dielli, Gjon Përkokën dhe të shoqen, Shkurtën e Xhozefinë Ndreut, i kapi një ngut dhe një nxitim. Qenë ata të parët që e thyen atë shtangie që s'kishte të sosur. Ata e ngritën të bijën, Julian, dhe i thanë të shkonte e ta falenderonte të

Lumnueshmen dhe Julia me një fytyrë tē mbushur me adhurim, çau përmes njerëzve dhe shkoi përballë ikonës. Puqi duart me sytë nga Shën Mëria dritëlëshuese dhe tha një lutje. Pastaj Gjon Përkoka me tē shoqen e morën Julian dhe e çuan drejt oborrit, pa ditur ç't'u thonë njerëzve. Aty e hipën nē mushkë dhe ia mbajtën pér nē Shkirë tē Keqe. Me natë a me ditë, thirri Gjoni, s'na mban vendi, o qofshi tē bekuem! Ikém.

Kishin dalë mjaft nga kisha dhe po shikonin që nga muret e oborrit se si Julia me mushkën përpara dhe Gjoni me Shkurtën prapa morën pér nga gjineshtrat. Ata zbritën nē shtratin e përroit dhe pastaj nisën tē ngijiten nëpër lakore.

Si u humbi nga sytë karvani i Gjonit, u ndje që kërcitën kockat e dikujt, tek ktheu trupin nga gjëndja.

- Heu bre! - Thirri ai.- I qofshim falë Zotit!

Ishte Uka i Vukës, zhelani që i varej njëra këmbë si rrëckë. Ishte i pari që po thoshte diçka pér mrekullinë e asaj nate.

Prenda e Vatës, shamatarja që kishte ardhë pér t'u zënë me ndonjërin, ngriti krahët nē ajër dhe nisi tē thërrasë:

- T'i biem nē gjunjë tē Lumnuemes, dritës së Zonjës sonë!

Prenda mend i bëri copë kurrizet e njerëzve që ishin ulë e po gatitnin plaçkat nëpër bohçe. Ajo rendi drejt portikut dhe aty, para se tē merrte rrugën, e mbytën lotët dhe nisi tē mërmërojë ca marrina e ca broçkulla sa tē nxente kryet.

- Mos thuaj kërçolla,- i tha një që po ngarkonte

mushkēn.- Qysh po i thua Zonjēs me ta gjetē dhinē qē t'ka humb?

- Ka me ma gjet, ka me ma gjet! - thoshte pērmes lotēve dhe me shpirt tē lehtēsuar Prenda e Vatēs.

Kjo bēri qē edhe disa tē tjerē qē po niseshin, tē lenē plaçkat nē tokē dhe tē kthehen me fytyrē nga kisha dhe tē numērojnē ca fjalē tē kota e tē pakuptimta, duke u ngucur me njēri tjetrin si ato gratē te kutia e çertexhiut qē ngucen e shtyhen tek zgjedhin vargje me rruaza. Tek dera e kishēs doli Frederiku dhe pa nga kjo tollovi. Kishte ndodhē diçka qē nuk mund ta rrokte dot mendja e tyre. Ata nuk dinin ç'tē bēnin, nuk dinin si ta shprehnin atē qē ndodhete me ta. Nēpēr njē terr tē tillē tē padijes sē tyre i kishte kapur njē ngarendje pēr tē shkuan diku, pēr ta çuar kētē lajm ku mund dhe sa mē parē.

- Mos tē ikē kush,- tha Frederiku.- Do tē bēhet njē proçesion.

Nga brenda po nxirrnin ikonēn e tē Lumnuemes. Vēnē nē njē furkē tē gjatē dhe zrukuruar me kurora lulesh, atē e mbanin nē krye tre vetē, njēri ndēr tē cilēt Bepini i Shkanetit. Ai kishte njē zē tē bukur. Bepini, si mori turma tē nisej, zuri tē kēndoje "Drita e tē Lumnuemes", qē e pasuan pastaj shumē zēra, por tē paujdisur mirē dhe larg pēr t'i thēnē njē kēngē proçessioni si ky.

# LIBRI I TRETË

## KAPITULLI I PARË

Një javë mbasi asht shfaqë Shën Mrija, ka ardh vetë ipeshkvi. Lajmi ka mbërritë gjer në ipeshkvi dhe ai asht çue e ia ka beh në kishën e Shenanoit. Gjysëm dite kanë tringëlli zilet e kuajve të karvanit që sillte atë. Në faqe të pllajave kanë rrahë patkonjtë e kafshëve dhe kanë ndritë rrobat e reja të kalorësve. Janë mbushun me ngjyrat e veshjeve të tyne dredhoret e hirta nga shkelte shpura e tij. Toga e kuqë dhe mitra e artë e hirësisë kanë shdritë nëpër diell qysh se asht duk e gjer sa ka mbrritë.

Kisha e Shndusë ishte shndrrue. Vrana i kishte çue nëpër duert e veta gjithë trenët e gjithë qeprat e saj. U kishte dhanë shërbet të ri mureve të hajatit e të kambanores dhe i kishte meremetue e i kishte fshi të gjithë meremetet e orenditë që ishin aty.

Nuk kishe se ku hyje e se ku rrripe atë ditë në Shndu. Brenda qenë ngjeshun nguc e nguc aq sa s'kishin

hymē kurrē dhe rrinin me fytyra tē pērkorura pērpara ikonēs sē Zonjēs. Poshtē saj (O Zonjē e Lumnueme sa bukur qē dukeshe!), digjeshin qirinj dhe zotēronte njē heshtje e thellē. Nē oborr njerēzit qenē po ashtu mizéri dhe tē ngjeshur me njeni- tjetrin; kishin lanē vetēm njē udhēz nē mes nga do tē kalonte hirēsia. Muret, drurēt dhe deri tek zabeli i ilqeve atje poshtē, qenē mbushun tē gjitha me mizérinē e kalamajve dhe tē çunave e tē gocave tē reja.

## KAPITULLI I DYTË

O Zot, si ishte ashtu ky shpirti i njeriut, po thoshte me vete Vrana. I kaloi diçka e errēt nēpēr zemēr, por nuk ditit tē thotē se çfarē qe. Ishte duke parē andej nga vinte karvani, me njē vēshtrim si tē humbur tej largēsive. Nēpēr njē pērndritje, tē kaltēreme qielli mbas njē shiu qē kishte rēnē, shihte si buisnin ngado çkallonj tē verdhē e tē njomē tē njē bari tē ri dhe nga pllaja vinte njē erē shkëmbinjsh e gurēsh tē lagur. Veç edhe njē gjē e hidhur, edhe njē gjē qē s'bēn, sillej nēpēr ajrin e asaj dite, po thoshte Vrana pa e ditur se çfarē. Ai kishte qenē i pushtuar nga ndjenja e atij qē mendon se ka njēfarē vlere, por qē tani po ndjente qē ishte njē kurrgjē. Po vinte ipeshkvi dhe, bashkē me tē, famullitari i ri, munshinjur Injaci. Do t'i dorēzonte çelēsat e kishēs atij dhe vetē do tē mbetej pa gjē. S'do tē ishte mē kurrkushi, sepse tani nē kishē do tē shērbente munshinjur Injaci.

Nēpēr lugun e maleve kaloi njē re dhe Vrana ktheu sytē andej. Po thoshte se vērtet kērkonte t'i gēzohej

shpirti nga angushtia e shiut, nga gjithë ajo hapsirë e shpëlarë dhe e shndritishme, nga gjithë ato shtëpi të largëta e tē afërt që ishin mbjellë në ato katër pllaja që zbrisnin nga katër faqe malesh të lartë, por kishte ajo ditë edhe një mister, që s'ë lente t'i çelte zemra. Një tē ligsht e një vrashpirt si ajo që tē ndjellin drurët e vetmuar dhe gomradat nëpër kufijtë e arave, dhitë që ngjiten nëpër gurë e nëpër gëmusha, një fyell bariu që bie matanë një kurrizi kodre me dhé bojëkafe. Një si lénie e braktisje që tē bien gjërat që janë matanë teje, një vetmi dëshpëruese. Do t'i jepte çelësat munshinjur Injacit dhe pas kësaj nuk do tē kujtohej më kush për tē.

## KAPITULLI I TRETË

Por Vrana nuk dorëzohej lehtë. Një shkak dhe muskujt e tij zgjoheshin e lëvrinin plot gjallëri. Kështu edhe tani, kështu edhe në atë çast që mbërriti ipeshkvi. Me t'u dukur kreu i karvanit tek dera e oborrit, ai brofi dhe i doli përpara. I kapi frerin kalit tē hirësisë dhe iu hodh në ije që ta ndihmonte tē zbriste. Nuk po ia hiqte sytë ipeshkvit për asnjë çast, ndërsa merrej me rripat e shalës, tē frerit dhe tē mamuzeve shndritëse. Ipeshkvi qe aq i përshpirtshëm dhe aq i bukur sa Vranës nisi t'i kullojë një dritë adhurimi nga sytë. Kali i tij i bardhë ishte si kalë mbreti me ata rripa tē rinj tē zbukuruara me gjithfarë sumbullash tē bornxta. Shpura që e shoqëronte shpérndante erë shenjtërie me togat e reja dhe me fytyrat e verdha si buka e dyllit.

Hirësia nisi të zgresë, por ishte shumë plak dhe mezi e gjente mamuzen me këmbën që i dridhej. Atëherë Vrana e mori në krahë dhe e uli në tokë. I ra në gjunjë dhe i puthi dorën dhe hirësia, tek e pa këtë njeri me kaq fuqi dhe të shkathët, e preku në kokë dhe e bekoi:

- Qofsh i bekuar, i ke shërbyer kishës dhe Zoti ta shpërbleftë!

Vrana deshi t'ia puthë edhe një herë dorën ipeshkvit. I dinte të gjitha ky plak i fisëm dhe i mençëm dhe kjo e ngazëlloi. Po e shifte Zoti që po i binte në gjunjë këtij njeriu të shenjtë. Zgjati krahët që t'i kapte gjunjët, por hirësia i bëri edhe një herë kryqin mbi kokë dhe iu mënjanua. Ai çapiti për nga dera e kishës dhe Vrana u topit. Nuk i bënин më gjunjët që të ngrihej e t'i dilte në krah dhe t'i hiqte udhën gjer brenda. Këtë punë e bëri Frederiku. Ky i doli ballazi dhe ipeshkvi e mbajti për krahu. Pastaj nisën të flasin me njëri tjetrit.

## KAPITULLI I KATËRT

Kur zuri të këndojë kori që kishte ardhë bashkë me ipeshkvin dhe kur nisi ceremonia e meshës dhe kisha e Shndusë llamburiste si kurrë ndonjëherë, Vranës i erdhi për të qarë. Qirinjtë e ndezur tufa-tufa i jepnin fytyrës së t'Lumnuemes një dritë që të zbriste në shpirt. Një mirësi që të mbushte me përgjërim prekës. Nuk kishte parë Vrana ikonë më të bukur se ajo! Korniza e saj e drunjtë qe gdhendur nga një dorë e trashë, por fytyra e Zonjës dhe e Krishtit ishin si të

gjalla. Sikur do tē zbrisnin qē andej dhe kisha do tē mbushej me fëshfërimën e rröbeve tē Zonjës.

Ipeshkvi ngjiti dy shkallare dhe doli një kokë mbi tē tjerët. Tani figura e hirësisë zotëronte mbi gjithçka dhe Vranën e kapi mallëngjimi.

## KAPITULLI I PESTË

Rrotulloi kryet nëpër gjindjen që ishte në kishë dhe i ndali sytë tek Domenika. Ajo rrinte përballë, mes tufës së grave të veshura për të kremte, e humbur dhe e ikur tashmë prej tij. Sikur s'ishte më në këtë botë qysh prej asaj nate tē lumtur që kishin kaluar bashkë. Domenika i kishte thënë në atë natë se kishte mot që digjej për tē. Tani që qenë lidhur, i kishte thënë ajo, s'do tē vinte më kurrë një ditë që do tē ndaheshin. Por tek ishin kthyer në kishë dhe kishin parë shfaqjen e Shën Mërisë, në shpirtin e saj kishte ndodhur një përblysje e madhe. Para Zonjës së Lumnueme Domenika e kish ndjerë veten fajtore dhe i pat ikur sye tē Vranës me tmerr dhe me frikë. Të nesërmen e asaj nate që kishin kaluar bashkë, Vrana kishte shkuar në shtëpinë e saj i ndezur dhe me çap ujku. Qe ngjitur me drithërimë padurimi nëpër faqet e mureve, pat kaluar nëpër hatullat e nëpër vrimat e çatisë dhe kishte dalë në dhomën e saj. E kishte marrë në krahë dhe e kishte ngritur. Por ajo e kishte grricur dhe e kishte çjerrur. Ishte bërë tjetër Domenikë ajo: e egër, një shtazë. Një copë e thatë dërrase që ishte e kotë ta shtrëngojë pas vetes. Hej, kryemushkë, i kishte bërtitur ai, çka tē ka gjet që po hedh shkelma, i kishte

thēnē. Por s'bēhej qē s'bēhej gjē. Ajo nuk donte. Atēherē Vrana kishte ikur i dalē menç dhe i tērbuar.

## KAPITULLI I GJASHTË

Vrana i solli kryet nga ana tjetër dhe pa munshinjur Injacin, qē e kishte sjellë ipeshkvi me vete. E kqyri ngeshēm. Ky ishte një burrē pesëdhjetë vjeç, i pastër dhe me sy bojëhiri. S'ishte e kollajshme me folë me te, tha Vrana, tek i shihte rrobet e shtrenjta. Kushedi nga ç'kishë tē madhe e kishte marrë ipeshkvi. Ipeshkvi kishte thēnē se Shnduja do tē bēhej kryekishë. Dhe kishte prurë munshinjur Injacin. Ky ishte rritë me qumësht dallandysheje se e kishte lëkurën tē hollë e tē bardhë. Veçse s'ka me i durue ernat e shqotat kur tē ngjitej nē Shndu, i erdhi nē tē bestë ky mendim Vranës. Kishte me mbetë rrugës dhe, s'i t'i mërzitez shpirti, kishte me ikë prapë.

Vrana nisi tē ndjejë një gëzim. Në Shndu s'ishte e kollajtë me ndejtë. S'ishte e kollajshme me ndejtë edhe nēpër katundet e asaj krahine Munshinjurët qē kishin qenë më parë, kishin qenë gjithë me zhguna tē vjetra dhe me lëkurë tē sholltë si katundarët! Ku kishte me shku ky me atë lëkurë tē bardhë?!, pyeti me ngazëllim. Vrana ndjeu kreni qē vetë ishte si kërçop. Ja, s'kishte kurrfarë zori m'u ngjité nē Shndu edhe përmes rrufeve e bubullimave tē shiut. Aty kishin me e gjetë pérherë njerëzit, kurse munshinjur Injacin kushedi se ku e hidhët era.

Fshiu buzën me shpinën e dorës se i erdhi aty një gaz dhe desh zbardhi dhëmbët. E trembi mendimi

se kishte me qeshē kot sē koti nē njē çast aq solemn si ai kur po bēhej ceremonia e meshēs. U vuri veshin fjalēve tē ipeshkvit dhe nisi t'i ndjekē e t'i thotē me mendjen e vet mu ashtu siç i thoshte ai. Nisi nēpēr vedи ta bējē zērin si hirēsia dhe e dehu aq shumē kjo gjē sa ment i fluturoi zemra nga gēzimi. Pastaj, o Zot, sa bukur, atij iu bē se ishte veshur si ipeshkvi! Ai qē po fliste pērpara atyre njerēzve nē ceremoni tē meshēs s'ishte kush tjetēr, vecse vetē ai, Vrana. Po, po, Vrana, ai keqoti qē munshinjur Injaci nuk po ia hidhite sytē! Ani, o i shkretē, ka me tē marrē era nēpēr shkamb tē Shndusē dhe mue s'ke me ma xan dot vendin. Ku ke me i qitē pastaj ato dijet dhe atē qibrēn tandem? Çelēsat s'ke me i marrē! S'ke me i marrē!

## KAPITULLI I SHTATE

Vrana iku tinēz. Po ziente me vete tashti. E Lumnuemja qe shfaqur nē Shndu dhe nē Shndu kishte qenē ai qē kishte korrē barin dhe shkorretin e oborrit, kishte qenē ai qē kishte vu nē zjarr kusinē e bollgurit pēr tē unshmit dhe kishte qenē ai qē kishte bērē gjithcka qē njerēzit tē mblidheshin aty. Atēherē si dilte ky munshinjur Injaci qē vinte kēshtu me duart drejt e nē gēshtenja?! I tha Rrokut, tē vēllait, qē ta mbyllte ai kishēn. T'i vinte drynin kur tē iknin tē gjithē dhe çelēsat tē mos ia jepte kujt. Munshinjur Injacin ta merrte e ta zbriste nē shtēpinē e atēnisē, por çelēsat tē mos ia jepte. "Po ti ke dalē mendsh?! - i kishte thēnē Rroku.- Si s'po ia jep? Po nesēr si ke me ia ba?". "Gjer nesēr dro mērzitet e ik,- ia kishte pritur Vrana.- Po e

vernē nē dhomē tē pleshtave dhe s'ka me e xanē gjumi. Nesēr ngrihet e ikēn. Ikēn ma mirē se me durue pleshtat tanē".

Pra kēshtu ndodhi qē, ndērsa nē oborr vazhdonte tallahama, Vrana ia mbajti pēr nga lakoret e gjineshtrave. Tha tē dilte nga anēt e Hydrēs sē Hyllit dhe tē rrinte andej nja njē javē ditē. Mbas njē jave kushedi se ç'bēhej. Do Zoti dhe munshinjur Injaci e kuptonte qē aty nuk e donin. Do Zoti dhe i bēhej shpirti derr.

## KAPITULLI I TETË

Po dikur ndjeu t'i kthjellohej mendja. U ul mbi njē gur dhe tha se ku kishte ba mend me shkue qē qe vērtitur nē njē copē vend? Nga muri i kishēs e rrrotull e gjer tek pylli i ilqeve e pērséri, pērmes gjineshtrave, nga pylli i ilqeve, tek muri i kishēs. Kishte ardhē qark, magjari. Kam ardh qark, tha, kur kam kujtue se po shkoj nē Hydēr tē Hyllit. Pastaj, si po ikte ashtu pa ditē se ç'do tē ndodhте? Çfarē do tē bēhej kur munshinjur Injaci tē kērkonte çelēsat e tē mos ia jepte kush? Por sikur mē nē fund, kur tē lodheshin e tē mērziteshin, tē merrnin sqeparin dhe tē prisnin shtyllakun e drunjtē dhe tē vinin njē dry tjetē! O i marrē, i tha vetes, po si po ikēn pa mend nē krye? S'ke si ia ban, ke me ia dhanē çelēsat munshinjur Injacit. Dhe ti vetē mandej vrap e nē mulli. Nē mulli te troshkat e koshit e te mokrat e blojēs.

I ishin pērbysur tē gjitha sa kishte menduar dhe tani duhej tē dorēzohej pa njē pa dy. T'i dorēzonte

të gjitha me dorën e vet dhe të bëhej prapë ai mullixhiu për të cilin s'pyeste kush. Domenika kishte shndritë vetëm një natë në jetën e tij dhe mbas asaj ishte fikë përsëri. E mbërtheu gurin ku ishte ulë dhe e rrrokullisi poshtë. E shtyu me aq forcë sa ai mori turre me uturimë drejt shtratit të përroit. Pastaj shtyu gurë mbas guri dhe e mbushi shpatin me një gjëmim që me u frigë. Pastaj, si u lodh, u kthye e shkoi drejt kishës. S'ishte shumë që aty, fare ngjatë. Të dilte kush në majë të murit e shihte e ia bënte me dorë.

## KAPITULLI I NËNTË

Hirësia ishte duke ndenjur në hijen e një tende, mbuluar me lule gjineshtrash. Kishte mbetur shumë i kënaqur kur e kishin prurë aty mbas meshës dhe kishte pyetur se cili kishte qenë ai që e kishte ujdisur atë belvedere si në kopshtet e Romës? I kishin thënë për Vranën. "Kemi një që kujdeset për kishën,- i kishin thënë.- një që mushinjur Agushtini e ka lënë mëkëmbës". "Qoftë i bekuar,- kishte thënë hirësia.- Një që më priti tek porta dhe më zbriti nga kali?". "Po, po, hirësi, ai.- i kishin thënë.- Një që Zoti i ka dhënë aq fuqi dhe na e ka mbajtur kishën hapur". Hirësia po thoshte se ai njeri e kishte ujdisur me shumë shije atë vend, ndjehej se gjithçka aty kishte kaluar nëpër një dorë sqimatari. Sheshi vetëtinte nga pastërtia dhe gërmushat e shkoretit dhe të njomështive qenë qethur për merak.

Hirësia nuk e fshihte dot emocionin e tij. I qenë zbehur faqet dhe nëpër buzë i kishte mbetur një

nënqeshje e përherershme. Ajo meshë që kishte bërë atë ditë nuk mund t'i hiqej nga mendja. Qenë zbrazur shtëpitë e të gjashtë copë katundeve dhe të gjithë kishin ardhë aty. Sikur kishin rendë me një mahnitje nëpër sy dhe kishin mbërritur në atë kishë të bardhë që lëshonte feksje nëpër ditën me diell. Qe mbushur gjithçka me njerëz dhe me bisedat e tyre, me lutjen ndaj Zotit dhe me shenjtërim. Hirësisë i rrëshqiti një pezm nëpër zemër.

- Të na falë Zoti, po i kemi braktisur këta njerëz, - tha hirësia.- Dy famullitarët po bëjnë vite që kanë ikur dhe ne nuk prumë të tjerë.

Ai mendoi me hidhërim per të dy ata, për Bdekun dhe për Agushtinin. Më idhshëm për Bdekun. Nuk do t'i falej që ai e kishte hequr zhgunin e klerikut dhe që kushedi me se merrej andej nga ai i pafeu, Bojrogu. I kishte vënë një njollë të madhe vetes dhe kishës, Zoti e shpëtoftë! Por edhe Agushtini. Në letrën që i kishte dërguar, ai tregonte për shkaqet që po e linte kishën. I shkruante: "Ndokujt, s'asht m'u çudit, ia ka marrë mend djalli e ndokush s'po mujt me durue që s'asht i përkryem". Agushtini që njeri me zemër të shenjtë, por diçka kishte ndodhur me të që e kishte lënë edhe ai famullinë.

Hirësia e ndjeu zemrën te rënduar që i kishte harruar ata shumë shpejt. Qe bërë gati prej kohësh të merrte një rrugë për aty, por, sa herë shihte malet dhe ato grykat e tyre që thoshte se s'kapërceheshin dot, e shtynte udhëtimin për më tej. Dhe kështu kishte ardhur ajo ditë që i kishte harruar ata njerëz. Këto anë sikur qenë hequr nga hartat dhe raportet

qē kishte ipeshkvia tregonin tē gjitha se "...kjo gja asht m'u frigue, kēto gjashtē copē katunde ka rrezik me i ikē kishēs. Tē vendosuna nē vende tē hupta shumē larg ipeshkvisē dhe ngjité me dominionin e Bojrogut, aty ka rrezik m'u largue njerëzit nga feja".

## KAPITULLI I DHJETË

Por qe shfaqur drita e Zonjës sē Lumnueme s'i shenjē qē Zoti s'i kishte harruar. Kjo e ishte bérë hirësinë aq tē gëzuar. Kjo ia bënte edhe më tē ashpër kastigimin ndaj vetes dhe ndaj dy famullitarëve qē e kishin lënë vendin shkretë.

- I harruam këta njerëz, por nuk i harroi Zoti, - tha me zë tē lartë hirësia.

Tē tjerët qē ishin nē belvedere me tē, i bishtënuan këtyre fjalëve qē ranë si një kritikë e ashpër. Veç Frederikut. Këtij iu zgjuan sytë e blertë dhe i rrahën qerpikët. Dikur e përmbjajti veten. Torri për një copë herë diçka nëpër mendt e tija dhe tha:

- Gjaja, hirësi, ma parë luadhin e ha ndër anë.

Domethënë nē pjesët më tē pambrojtura, nē skajet qē janë më afër rrezikut. Domethënë nahi si këto shumë larg kishës dhe ngjitur me Bojrogun. Zona e hijedritës, i shkoi ndërmend kjo figurë hirësisë. Aty gjërat përziheshin e bëheshin një gjë laragane, herë e njërs anë e herë e tjetrës. Vetë ikja e Bdekut dhe Agushtinit po për këtë gjë tregonte: Njëri e linte zhgunin e famullitarit dhe shkonte nē vendin e armiqve tē tyre, kurse tjetri ikte nē tē kundërtën e tij drejt zemrës sē fesë për tē gjetur përdëllim. Piste

hollē ky burrē i imēt, tha me vete hirēsia, duke vēshtruar Frederikun. Mu si livadhi vērtetē, ku gjaja ma parē ha kufijtē e skajet.

- Jemi nē skaj,- ia mori kētē fjalē nga mendja Frederiku.- dhe skajet janē tē shkelme dhe barin s'e kanē fort tē rritē.

Domethēnē, tha hirēsia me vete, ku besimi nē fē nuk ēshtē shumē i fortē dhe morali i krishterē jo shumē i qēndrueshēm. Por pse kishte ky njeri njē si idhnik qē e zymtonte? Fliste me njēfarē mllefi. Ishte si njē kritikē edhe mē e ashpēr zemērimi i tij i pērbajtur.

## KAPITULLI I NJËMBËDHJETË

Nē kētē kohē erdhi Vrana. Tinēz kishte ikē dhe tinēz po kthehej. Ai kapērceu gēmushat e dëllenjave dhe zuri vend prapa shpinēs sē tyre. Toga e hirēsisē dhe togat e bardha tē tē gjithē atyreve qē kishin ardhē, lëshonin reflekse tē mëndafshta. Burrat e parisē sē vendit, qē nga Kryezoti deri tek pleqēsia, ishin veshē me rroba tē mira.

Por sa pa zēnē Vrana vend mirē, plasi njē potere. Nga dera e kishēs doli duke brritur Gabrieli i Mushkamadhes, siç i thonin pēr shkak tē mushkēs sē tij (dimēr, verē, me mushkēn mbas shpine, me kandarin tek kaptelli dhe me arkat e kripēs ngarkuar nē samar). Nuk kuptohej se çfarē thoshte Gabrieli me ato bērtima, por ndjehej se qenē si njē lutje e njē njeriu tē trembur nga frika e tē fshehtave tē veta. Nga prapa e ndiqnin ca burra dhe e mbērritēn para se ai

tē arrinte tek muri i oborrit, qē binte nga ana shkembore.

Kushedi se çfarē ka bërë, tha Vrana me vete. Edhe atij i kishte ndodhur njëherë kështu. Tek rrinte para Shën Mërisë, i kishte ardhë tē rrëfehej. I ngjiteshin vetvetiu së brendëshmi ca fjalë qē donte t'ia thoshte dhe ajo ta falte e ta përdëllente. Edhe ky zapazani i Mushkamadhes! Kushedi se ç'kishte bërë qē s'i gjente shpirti prehje. Nuk ishte ndonjë gjë e re për Vranën, kishte ndodhur edhe herë tē tjera gjatë asaj kohe që e përndriste kishën hiri i së Shenjtëruemes. Tek luteshin në gjunjë para saj, gjindje tē ndryshme që vinin nga gjithë krahina, këputeshin përbys e ngashërenin.

Gabrielin e kapën dhe e qetuan, ndërkohë që tek tenda erdhi Domenika në mesin e një tufe me gra. Ato iu afroan ipeshkvit dhe Vrana vuri re se me sa hir ia puthi dorën Domenika hirësisë. Mandej, teksha u hoq mënjanë për t'u lënë rradhë grave tē tjera, ajo diç i pëshpëriti Frederikut. Frederiku rrudhi vetullat, por s'i ktheu ndonjë përgjigje. Sikur u bezdis dhe sikur e pérçmoi dhe Domenika uli sytë me përunjësi dhe nuk u fye. Dreq i mallkuem!, desh ulériu Vrana, por aty për aty u mpi që i erdhi ndërmend ajo fjalë e tmerrshme. Po i ziente gjaku. Qysh ishte bërë aq e huaj ajo grua? Qysh s'ia kthente sytë njëherë e ta shihte që ishte gjallë? Kujt po ia ulte shpinën ashtu, Frederikut?

Vrana e përpjuni Frederikun me sy dhe ky për herë tē parë iu tremb. Iu tut shikimit tē tij dhe i ngrinë fjalët që po i thoshte hirësisë. Vrana po mallkonte që

kish ardhē nē botē ky njeri. I kishte dalē nē udhē dhe ia kishte marrē atē grua. E kishte robēruar dhe tani e pērbuzte dhe e pērçmonte! Dhe cili?! Ai rrēgjaku me ato duar tē holla si purrinj! Pēr besē tē Zötit, t'i kēpus kryet e s'ngopem hiç!

Frederiku u hepuā mbas kurrit tē hirësisē si t'i ruhej dorës sē tij qē a thua vërtet iu zgjat dhe donte ta zinte pēr fytì.

## KAPITULLI I DYMBËDHJETË

Kur ipeshkvi dhe gjithë sa ishin zbritën poshtë, Vrana ndjeu se e kishte pushtuar një dëshpërim që e brente pērbrenda. E bluante një keqardhje pēr veten e tij që ishte një kurkush. Po mbushte dyzet vjeç dhe s'kishte as grua. Martesa që kishte bërë nē tē ri i kishte dalë e pafat: nusen s'e kishte gjetur vajzë. Kishte dalë nga gjerdeku ku qe mbyllur sē pari me tē dhe i kishte shkuar axhës: "S'e kam gjet ashtu!", i kishte thënë. Axha qe menduar gjatë. Zakoni e donte që, mbasi tē binte dhëndri sē pari me nusen dhe ta gjente vajzë, tē nxirrte pushkën nē dritare dhe tē shtinte tri herë. Pērndryshe nusen e hipnin nē kalë dhe e çonin përsëri nē shtëpi tē vet. Por axha kishte rënë ngushtë: mezi ë kishin bërë atë dasëm dhe tashti do t'u duhej t'u futeshin telasheve pa fund. Duhej tē gjenin një nuse tjetër, duhet tē bënin një dasëm tjetër, por s'i do t'i bënin gjithë ato harxhe tē reja kur s'kishin kurrgjë? "Qit pushkë!", i kishte thënë axha. Vrana kishte mbetë shtangë. "Edhe kamba e lopës kur thyhet, ngjitet,- i kishte thënë.- Prandaj qit pushkë e

mos e baj tē madhe!".

Por Vrana nuk kishte dēgjuar. E kishte hypur nusen nē kalē dhe ia kishte çuar tē jatit. Dhe kēshtu qe mbyllur kjo punē dhe dasēm tjetēr nuk u bē. Nuk u bē dasēm tjetēr, jo vetēm pēr harxhet, por edhe pēr shkak tē Vranēs. Vrana kishte marrē frikē. S'duronte qē nē gruan e tij tē kishin vēnē dorē tē tjerēt.

## KAPITULLI I TREMBËDHJETË

Vranēn e nxorri nga kēto mendime thirrma e njē gjoni qē po kēndonte. Ishte nē tē fikur tē muzgut e tēerrmennata. Nēpēr heshtjen qē zotērontē nē kishē, zēri i tij tē ftonte si matanē njē pērroi a si tek njē tufē shelgjesh qē i lagte vesa. Zotēronin nē Shndu mērmērimat e besimtarēve dhe kērcisin flakēt e qirinje qē digjeshin tufa-tufa. Munshinjur Injaci qe bērē aty menjēherē zot. Rrinte nē kēmbē me mesharin nē dorē dhe mērmēriste lutje mbi kokat e pērkulura tē njerēzve. Vrana e ndjeu veten edhe mē tē braktisur. Kish njē javē rresht qē rrinte nē kishē, ditē natē, qē kur qe shfaqur e Lumnuemja dhe aty ishte munduar t'u shērbente njerēzve mesa kish mundur e mesa kish ditur. Por tani duhej tē ikte. Kurrikush nuk kishte nevojē pēr tē. Ky famullitari i ri, qē kishte prurē ipeshkvi me vete, sikur e pat parē hēnajashtē. Nuk u puqeji ylli mesa dukej, ai sikur bezdisej kur e shihte Vranēn.

Thirrja e atij gjoni diku matanē hapsirave tē Shdusē dhe nēpēr natēn qē terratitej, i kujtoi Vranēs mullirin. Trokashkat dhe mokrēn e tij, pjalmin e miellit dhe

erēn e thekrēs. I bēhej sikur dēgjonte zilet e mushkave tek vinin pērngjatē vijēs sē sfratit dhe zhurmēn e ujit qē shkumēzonte tek grykat e cifundeve.

Doli jashtē. E rrahu nēpēr gjoks dhe nēpēr fytyrē veriu qē vinte nga grykat e tejme tē maleve. Era e barit tē korrur kishte mbushur oborrin dhe ilqet gjethedendura atje nē skaj dukeshin si barinj me herrka tē gjata qē ruanin yjet e qiellit.

Nē mulli mbērriti vonē. Rroku kish kohē qē e kish mbyllur dhe i kishte lēnē vijat e ujit tē derdheshin nē pērrua.

Por kish plot pēr tē blojtur. Rrokun s'e hante shumē meraku nēse vinin e i ankoheshin. "Hani grunē tē zimē" ua priste shkurt e, kur kishin thekēr, edhe tallej e u thosh: "Hani torbal!". E kishin rrahē njēherē ca qē vinin nga Rräklla e Epērme, ca nga ata flokēçilēt e mjekērshkorretēt e rritur nē pyll. E kishin bērē pēr lemēz dhe ia kishin prerē njē fill tē mustaques me gērshērē. Pastaj s'kishin ardhē mē, bluanin andej nga mullinjtē e Apripēs, kēshtu qē edhe betē qē iu kish bērē Rroku shkuan mē kot.

Vrana u vuri sfrat vijave tē ujit dhe lēshoi mokrat. Trokashkat nisēn tē rrahin si zogjtē qē çukisnin nē njē tepsi me hime dhe flakēt e pishtarēve sajonin lloj-lloj hijesh nēpēr mure. Nuk mbahej mend qē kur qe bērē ai mulli, muret e tij tē hirtē e tē thatē ishin si faqe murranash, bērē me gurē tē shkulur drejt e nga gomradat.

Iu pērplas koka mbas koshit tē drithit se e kish zēnē gjumi nē kēmbē. Kish njē javē qē nuk flinte dhe tanī nuk po mundej ta shtynte mē tutje. Sidomos nēpēr

trokëllimën e troshkave dhe nëpër erën e ngrohtë të miellit. Iu qepën sytë dhe e gjakosi ballin tek maya e mprehtë e mëndallës. Vrana çoi dorën dhe e fshiu. I kishte ndodhur edhe herë të tjera t'i përplasej koka, por këtë rradhë e kapi një zemërim dhe nisi të shfryjë. S'i bëhej mirë më në atë mulli; i qe rrënuar durimi prej mushku. I qe rrënuar sepse s'ishte jetë ajo që bënte aty si një shejtan në buzë të përroit natë për natë e ditë pér ditë. E dogji ky zemërim në të beftë edhe nga diçka tjetër: i qe kujtuar Frederiku. Ai gjapagjaja flinte me Domenikën tan! Skuthej nëpër shtat të saj, kurse atë e dergje dëshira. Pale, ajo s'e shihte tani as me sy, pra le ta mbante mend atë natë që e kishte marrë si një shelege dhe e kishte çuar në pyll... apo kishte qenë ëndërr? Mbase nuk kishte qenë e vërtetë që ai e kishte ferkuar shtatin e saj me mish të butë si mëndafshi? Zot, u drodh ai dhe përplasi kokën përsëri. Si e ke bërë aq të bukur atë grua dhe si ma ke ndezur këtë zjarr pér të?

I ra dërrasave me kokë edhe një herë dhe u ul mbi thasët e miellit. Ta vrisje nuk i nxirrje një pikë gjaku. Qe i malluar të rrinte me Domenikën, nuk mund ta duronte më dëshirën që e digje. I zihej fryma kur mendonte se kapte llëren e saj dhe e fshikte në shpirt ajo diçka e fshehtë që përvëlohej tek ajo. Të thyente trarët dhe qeprat e mullirit, të shkulte sheljet dhe të gërricej nëpër gjithë ferrat e gjerdheve dhe nuk i dilte ajo drithërimë që e shungullonte si një tërmët. "Ç'ban kështu si i marrë, ç'ban kështu si i shkalluem!", i thoshte Domenika atje në pyll atë natë që ai e shtrydhë pas vetes. E kishte shkalafitur dhe nuk dihej

nga i qenē pērzier rrrobat nēpēr atē trupin e saj tē bardhē e tē butē. Ajo vetēm digjej e pērvēlonte dhe syri i pulitur i xixēllinte nēpēr dritē tē qiellit. Sikur i rrēshqiste serm i shkrirē, njē zjarr i zi qē tē fuste kthetrat nē fyt dhe tē mbyste. Ç'ishte ajo grua? Si mund tē mblidhej aq zjarr nē njē shtat aq tē brishtē dhe nē njē kurm aq tē hollē?

I ra me shkelm shulit tē cifundit dhe rrota e mokrrēs ndali. Hodhi setrēn krahve dhe fryu pērashta. Me thonj do t'i sulej atje nē shtresa ku ishte. Do ta hidhte nē zverk si njē ujk, ja ashtu tē zhveshur e tē ngrohtē siç qe dhe do tē fluturonte sa t'i hanin kēmbēt. Do ta çonte nēpēr gjerdhe tē cermedellit dhe le ta gērricnin e le ta shponin bodecēt e tij, por ai s'do tē ndalej. Do tē dilte lartē mbi Gurin e Shugjanit, do ta shtronte nē luadhin me luledele qē zbardhnin si hije yjesh dhe atje do tē thērriste si njē ujk nē dritē tē hēnēs dhe do ta ngjiste mbas vetes sē tij.

## KAPITULLI I KATËRMBËDHJETË

Katundi qe i zi. Mezi i dallonte shtēpitē pērmes drurēve dhe nē qymyrin e malit qē nxinte nga nata. Kishte mbërritur njē re dhe e pat puqr qielin me tokēn. Vranēs i qenē lagur pulpat e kēmbēve nga vesa dhe kur u ndērmend vuri re se po ecte mes lakrave nē kopshtin prapa shtēpisē sē atēnisē. Iu kujtua se po kēshtu si edhe ai, me njē çap prej cubi, kthehej para shumē vjetēsh edhe munshinjur Bdeku nē shtēpi. Nēpēr lakra dhe tinēz. Sapo qe ndarē nga

**Luçija.** Vrana i kishte parē mes shelgjeve, mbi koritat e mullirit. Munshinjur Bdeku kish hequr zhgunin dhe e kishte shtruar nē tokē. Pastaj aty kishte marrē Luçien. Qenē hopakatur njē copē herē dhe pastaj qenē ndarē: ajo grykēs sē pērroit, kurse munshinjuri nēpēr gardhiqet. Vrana i qe vēnē prapa. Kerkonte ta ngucte kêtē prift qē sa herē qē vinte nē mulli njē e dy e tallej me tē: "Ruaju, tē faltē Zoti, se kētu tē vjen lloj-lloj gruaje!".

Kur munshinjur Bdeku qe ngijitur nē çardakun e shtēpisē dhe qe rehatuar nē postiqe, ky i qe shfaqur dhe i kishte qēndruar pērballē. Aty zonja Hura po krihte lesh me kērhanēz dhe ai i kishte thēnē t'i linte vetēm se kishte pēr t'i thēnē diçka munshinjur Bdeku. Pastaj, si kishte ikur zonja Hura, i ishte kthyer dhe e kishte pyetur: "Munshinjur,- i kishte thēnē.- a ēshtē i shenjtē njē prift?". "Jo fort", i qe pērgjigjur Bdeku, me njē sy qē ia kotte gjumi. "E i pērdalē?", e kishte pyetur sērish. "Jo fort" i qe pērgjigjur nē tē njējtēn mēnyrē Bdeku, por kêtē rradhē me syrin qē kishte nisē t'ia bredhē nēpēr fytyrē. Kishte marrē inat munshinjur Bdeku dhe po mendohej si t'ia bēnte paq e t'ia kthente me tē tallura e me tē pērbuzura meqē atij i kishte hipur ta ngucte nē kēto gjera. Ishte krojtur nē bark njē copē herē dhe pastaj i kishte lëshuar njē tē potershme me aq forcē sa tē thoje se luajtēn trenēt e çardakut. "Deshe ndonjē send tjetēr?", e kishte ngarē Vranēn mē tej munshinjur Bdeku, duke krojtur barkun pērséri.

Vrana kishte ikur, por nē vend qē tē ndihej i fyer, kishte ndjerē njē liri tē madhe atēherē. S'ishte ndonjē

send ajo qē thoshte Bdeku nē kishē pēr mos me i ngucē gratē e botēs. As njē mēkat nuk bēhej pse po i prishje mendjen njē gruaje tē huaj.

Vranēs i rrahu me vrull njē shkulm gjaku nēpēr zemēr. I iku mendja e kresē kur mendoi se si do ta nxirrte Domenikēn nga shtresat ku flinte dhe si do ta ngrinte nē krahē e tē sulej drejt derēs pēr ta çuar nē pyll.

Nata tē ngucte mē shumē drejt kēsaj gjëje me qiellin aq tē ulēt dhe me njē veri shiu qē tundte majat e drurēve. Sidomos me heshtjen dhe me gjumin e qenve qē nuk ndiheshin askund.

Oh, ajo natē e ai terr! Ashtu si u nis, ashtu edhe mbaroi ajo punē. Mbase s'e kanē ditur kurrē dhe mbase kurrē s'e kanē dashur, por ashtu e pruri hera e tyre dhe ata atē natē, Vrana dhe Domenika, e dogjēn Frederikun e shkretē!

# LIBRI I KATËRT

## KAPITULLI I PARË

E frugulluen me gjithë shtëpi e me gjithçka. Zot, ç'kob e ç'gjamë që ndodhi!

## KAPITULLI I DYTË

Zonjën Hura kjo gjë e ka tronditur shumë. Ajo s'është tronditur kurrë në jetën e vet ashtu dhe nuk e ze gjumi. Rri ulur në shtresa gjersa thyhet nata, pastaj shuket e i ngjan se s'është as e vdekur e as e gjallë. Shkon në Urbs, ku nuk ka qenë kurrë, për të takuar Bdekun. Shumë vetë kanë thanë se plaka kishte lafitur se qysh po shkonte kaq larg e për çka po e donte Bdekun mbas kaq kohe ikun e harrue? Por ajo nuk pyeti për kërkënd dhe thirri Gjovalinin e Terezës që ta çonte atje. I hypi mushkës dhe bani me Gjovalinin tri ditë rrugë gjersa mbërrini një ndajnatë mbi një grykë nga ku dukej Urbsi. Zonja Hura u

shtang kur e pa atē qytet dhe, teksa sillte kryet majtas e djathtas, nuk po e kuptione nē ishte nē ēndērr a nē zhgjēndērr. Urbësi i madh e i bardhë ishte si nēpēr tokë e si nēpēr qiell. Se si u qe qepur ca faqeve tē pjerrēta qē binin thikë mbi ujërat e një lumi, por ishte edhe i shtrirë nēpēr ca kodra tē ulëta e tē rrumbullakëta si koka tē qethura, edhe nē shesh nē një fushë gjatine, ku ngriheshin sherehanet e tija tē larta. Nuk e merrije vesh nē ishte nēpēr ajér nē faqe tē thikta, nēpēr tokë nē kodra tē vocërra, a nēpēr fushë nē toka tē dysta me një varg kavakësh atje tej. Edhe më i çuditshëm ishte një ngushtinë nën shkëmb qē tē fuste nē lagjet e para, ku tē merrte mendjen një ngrehnajë buzë ujrave plot me rrota druri dëstilësh e mullinjsh dhe plot me strehë tē gjera çatish e çardakësh. Dyqane diku sérë-sérë e diku tē rrallë; qepenë karagjakë me vargje qeleshesh dhe litharete me shallvare tē mëndafshta. Dhe një brritëm nē një çajhane diku, një njeri i dehur me hashash qē këndonte nē gjuhën e zurpazurit.

## KAPITULLI I TRETË

Në gjuhën e çavellit, tha me vete zonja Hura. Ndjehej e dërrmuar nē majë tē mushkës, por ia pat hapur syrin pamja e atij qyteti tē çuditshëm me ato shtëpi si tē përqiellta e si tē përtokta. Si tē përeta e si tē përujta me muret e bardhë deri nē majë tē malit dhe me hijet qē lëshonte nē sipërfaqen e lumit.

- A erdhëm? - pyeti zonja Hura për t'u siguruar më mirë.

- Erdhëm, - ia preu Gjovalini, i biri i gjitone Terezës.

Ky ishte një djalë as tetëmbëdhjetë vjeç që zbardhët e kuqte nga shëndeti. Ekte përpara dhe zonja Hura e pat bekuar njëmijë herë përfuqinë e tij. Po bënин tri ditë që po udhëtonin dhe ajo e kishte ndjerë veten të sigurtë me atë djalë. Gjovalini njihej në të gjithë krahinën si shtegëtar. Ai dinte të kapërcente nëpër gryka dhe nëpër lugje, i njihte vendet dhe qytetet rrëth e rrëth deri në shtatë ditë larg. Dinte kur nisej e kur ndalej, ku hahej e ku flihej, ku e shlodhët mushkën e ku e ngucte. Dhe vetë i palodhur, përherë me hap të shkathët dhe me një bllanë djerse në mes të kurrit, si shenjë e riniçë dhe e fuqisë së tij.

- A dum edhe shumë me shkue te Bdeku? - pyeti rishtaz zonja Hura.

- Jo edhe shumë.

Ata tani po ngjiteshin në një kalldrëm të rrëpirtë përmes qytetit.

- Qe, tek ato shtëpi, - tregoi përsë dyti me dorë Gjovalini.

Zonja Hura pa andej. Nuk e dallonte dot mirë se si qenë bërë ashtu ato shtëpi në rrëzën e një shkëmbi dhe përmes një tufe drurësh të dendur. S'dallohej nga e kishin të mbarën dhe portat e hyrjes dhe nga të praptën. S'i ndaje dot çatitë e tyre që qenë përzier kulm më kulm e strehë më strehë me lloj-lloj oxhakësh si burra të bardhë që rrinin në këmbë me koka të lidhura me peshqirë.

## KAPITULLI I KATËRT

Tek një portë e gjelbër i ndalën rojet. Gjovalini foli me ta; njërit prej tyre diç i sqaroi për një kohë të gjatë, duke treguar me dorë nga zonja Hura dhe dikur e bindi.

Duhet të bëje gjysëm dite rrugë nëpër hajatet e atyre shtëpive gjersa të arrije tek Bdeku. Nëpër ulluke e nëpër ylyqe shfaqeshin hera herë burra me pamje të ashpra. Ata qenë veshur me ca si sarafanë të gjatë deri tek nyjet e këmbëve dhe të përgjonin me ca sy të errët si thëngjilli.

Bdekun e gjeti në një hijane mu si në një bodrum me dy dritare të vogla. Si të mësoheshin sytë në atë gjysëmerrësirë, nisje e dalloje ca feksje orendish që ishin aty. Një divani në qosh i ndritnin sumbullat e bronxit dhe gurët e çmuar, kurse tek dy si shatore me perde mëndafshi jepnin reflekse të bardha kupat e një takëmi prej argjendi. Bdeku ishte mbështetur në një shilte me jastëkë attiasi dhe pinte duhan me një cingarishte të gjatë.

Zonja Hura nuk e njohu menjëherë. Gjatë atyre viteve që nuk ishin parë, ai qe ngjallur shumë dhe qe plakur. Pastaj me atë veshje, me një si sarafan gurthkali dhe me një si mëngore me mëngët të gjera! Zonja Hura e mbante mend të veshur përherë me zhgunin e meshtarit dhe me një shkop me nyje që e vërviste në dorë.

- Bdek, a më njeh? - e pyeti dikur dhe, si nuk mori ndonjë përgjigje, ktheu sytë të kërkonte ndihmën e Gjovalinit. Por këtë e kishin mbajtur rojet, kështuqë ajo ishte vetëm.

- Tē njoha,- foli Bdeku.- Ulu!

Nē atē çast hyri njē grua dhe pēr çudinē e Hurēs ajo zbuloi tri dritare tē mēdha qē nuk dukeshin. Ato kishin qenē tē zēna me kanata druri dhe me perde tē trasha. Si u mbush konaku me dritē, zonja Hura vuri re se gruaja qe njē billionjē me leshra tē gjata. Siç hyri doli me njē çap qē sikur s'i shkelte nē tokē.

- Si je, moj Hurē? - e pyeti Bdeku, duke e çarē kryq e tērthorē me sytē e tij qē s'e kishin humbur gjallérinē.- Erdhe tē mē rréfehesh? Shumē gjéra janē marrē vesh.

Ajo i mbante buzēt tē shtrënguara dhe kraharori i ngrihej dhe i ulej nga njē tallazitje qē i ziente pērbrenda. Nē atē çast u futēn dy plaka tē rreshkura e tē kērrusura, qē qēndruan pranē tyre. Zonja Hura ktheu sytē nga ato me kokēn qē i dridhej.

- Ngrehu e shko! - i tha Bdeku.- Rregullohu e qetësohu njéherē se je e lodhur e s'je pēr biseda.

Zonja Hura solli kokēn e pērgjoi rrēth e rrēth konakut nga u ndjenē zhurma. Aty se ç'bēhej. Nē njē hajat, nē tē kundért nga kishte hyrē, dēgjoheshin zēra tē mbytur dhe hapa qē shkonin e vinin. Njē zgjua me mērmērima dhe kēmbē qē shkonin e vinin si nē njē trok tē mbytur.

Plakat i hoqēn udhē tē heshtura. E çuan nē njē kthinē dhe atje ajo u la dhe u pastrua. Pastaj i sollēn pēr tē ngrēnē nē njē tepsi me sahanē tē kallaisur.

Trokellimēn e atyre hapave qē kish ndjerē nē hijanen e Bdekut, ajo e dēgjoi përsëri, por këtē rradhë nē sheshin poshtë dritares sē konakut ku rrinte. U zgjat dhe dalloi qē ecnin si nja njēzet a tridhjetē burra.

Ata kishin nē kokē kēsula tē murrme dhe ishin veshur me ca si dolloma tē gjata qē u ngatērroheshin nēpēr kēmbē. Ecnin nē rresht, tre e nga tre, me njē qē i ndiqte nē fund, njē ngjallan e hapashalē si patok. Ky ishte Bdeku. Ajo s'ua ndau sytē deri sa ata nisēn tē zbresin nē ca shkallē dhe po i humbnin nga sytē, duke u firaksur pak e nga pak poshtē kalldrēmit tē rrugēs. Edhe Bdeku. Zonja Hura nuk ia ndau sytē deri sa kēsula e tij humbi prapa njē guri tē bardhē. Ndjeu t'i pérqetehj trupi. Nuk i besohej qē e kishte gjetur atē njeri dhe qē e kishte gjetur ashtu.

## KAPITULLI I PESTË

Nuk u kujtua mē kush pēr tē deri nē darkē, kur erdhēn pērséri ato plaka dhe i prunē pēr tē ngrēnē. Deshi t'i pyesē se ku ishte Gjovalini, por ato ishin tē pagoja. Si i lanē tepsinē nē njē sofer tē vogēl, u kthyen e dolēn njēra pas tjetrēs si dy fshesa melakuqi.

## KAPITULLI I GJASHTË

Kishte nisur ta brejē dyshimi se a mos kishte ardhë dikush tjetër para saj dhe ia kishte rrēfyer Bdekut gjithë atē gjemë? E kishte zënë nata nē dritare, duke pritur Bdekun me këto mendime. Ankthi i saj qe bëre edhe më i rëndë kur, mbasi qe shuar drita e qiellit nē dy hapsirat e mëdha mbi dy grykat e lumi, një terr e një zi, si nē vendet që janë nē hije, e kishte pushtuar atë qytet. Gjithë ai pus i madh nate nē atë Urbs tē panjohur qe mbushur me feksjet e panumërtat tē

fenerëve që vinin vargje-vargje nëpër rrugët e tij dhe në dy ura të mëdha të drunjta që lidhnin dy brigjet e lumit. Pastaj një prushërimë e pafund dritaresh që ndriçoheshin nga llampa dhe nga idare.

Zonjës Hura i qe kujtuar një ëndërr që kishte parë. Pati po atë drithërimë si në atë natë kur qe zgjuar nga gjumi ngaqë i qe bërë sikur i foli një zë. "Ku e ke Bdekun?" e kishte pyetur. Ç'lidhje kishte Bdeku me Frederikun? - drithëronte ajo me kumbimin e zërit të Zonjës në vesh. Se ashtu i kishte ngjarë sikur i tha: "Ku e ke Bdekun, atë fjalëpathënин e Frederikut?". Të nesërmen në drekëherë tha të shkonte e ta bisedonte atë gjë me Domenikën. Qe nisur sakaq dhe në rrugë e sipër qe kujtuar se po bënte ditë që s'e kishte parë atë grua. Që në meshën e madhe tha, që kur erdhë ipeshkvi. Që atëherë, përsëriti, dhe e ndjeu zemrën të rënduar që nuk qe kujtuar për një grua me burrë të sëmurë. Por pat menduar se mos kishte shkuar me Frederikun në llixhë dhe kjo e justifikonte në njëfarë mënyre ndaj vetes. Po mbaronte vera dhe ata ende nuk kishin zbritur në ujërat e nxehtha, ku njerëzit ngrinin tenda dhe bënin banjë. Ndoshita ishin atje që s'qenë dukur e s'qenë parë. Frederikut i bënin mirë ujërat e llixhës, ia zbusnin dhimbjen e kockave me squfurin e tyre.

Por Domenika nuk kishte shkuar gjëkundi. Ishte në shtëpi bashkë me Frederikun. Të trembte, aq shumë qe ligur e qe zbërthyer. I kishin dalë kockat e mollzave dhe ishte bërë dyllë e verdhë. Edhe Frederiku. Edhe ai iu pa më i ligur e më i pafuqi se kurrë. Si zakonisht, rrinte në shtresa me një leckë të

lagur nē ballē, kurse Domenika tek koka e tij. Zonja Hura mezi e kapérceu hutimin qē zotéroi. Ata diçka kishin. Ata po prisnin tē dēgjonin se ç'do t'u thoshte ajo me atē ardhje me nxit, por zonjës Hura i qe kyçur goja dhe s'po dintे nga t'ia niste. Si kishin shkëmbyer pêrshëndetjet e zakonshme ajo kishte marrē tē ikte, por, sa pa mbërritur tek hajati, Domenika i kishte thirrur nga prapa:

- Zonja Hura!

I kishte thirrur dhe ia kishte mbërritur me një çap tē shpejtë e tē dridhur.

- Zonja Hura! Rri tē pijmë një kafe bashkë! - i kishte thënë.

Dhe ajo kishte ndenjur. Ishte futur nē konakun e miqve ku e kishte ftuar Domenika dhe ishte ulur pranë oxhakut. Domenika kishte thënë ta priste pak, ja, një çikë, sa tē bënte kafen dhe do tē vinte pêrsëri. Kiske ikur gati me rend, qenë pêrplasur teneqe e enë nē kqollin e zjarrit, ishin goditura kusi teneqeje qē u hapën e u mbyllën, filxhanë qē u muarrën nga sergjeni dhe sakaq Domenika kishte ardhur pêrsëri me tabakanë e kafeve nē njérën dorë dhe me një qese me para nē dorën tjetër. Ndërsa pinin kafetë, zonja Hura e kishte ndjerë se ajo diç donte t'i thoshte. I dridhej filxhani dhe nuk gjente qetësi.

- Çfarë ke kështu? Tē ka gjetur ndonjë send? - e kishte pyetur zonja Hura.

Domenika kaq kishte dashur. Kiske lënë filxhanin nē tokë, qē kruspollo sur pas murit dhe ia kishte plasur tē qarit. Dhe aty i kishte treguar pêr Vranën qē i qe qepur dhe po e çmendte...

## KAPITULLI I TETË

Zonjës Hura ia ndërpreu këto mendime zhurma e hapave të atyre njëzet a tridhjetë vetëve që ikën dhe që po ktheheshin përsëri. Ata u dukën përsëri poshtë dritares së saj me po ato kësulat e dollomatë e tyre të gjata dhe po ashtu në rresht për tre e me Bdekun që i ndiqte në fund. Kishin përshkuar oborrin me idare nëpër duar, të cilat hidhnin bllana drite nëpër gurët e murrmë dhe ishin zhdukur prapa një faqeje të rrumbullakët muri. Pa mbërritur mirë, Bdeku ia kishte dërguar përsëri ato dy plakat e heshtura që erdhën dhe e morën për ta çuar tek ai.

Bdeku ishte po në atë konak ku e kishte gjetur në fillim, por tanë ajo harakania e tij ndriçohej dobët nga dy kandilë që mezi feksnin. Rrinte në terr, i dukej vetëm surrat i mbufatur.

Zonja Hura i tha se e kishte marrë atë rrugë ngaqë s'gjente rehat, por e fshehu atë që i ndillte zemra dhe t'i thoshte se kishte qënë ai shkaktari i asaj që i ndodhi Frederikut. Bdeku e dëgjonte i mbështetur në bërryl, me kokën varur dhe me sytë që sikur i koteshin nga gjumi, por që edhe i ndrinin herë pas here nëpër qerpikë, sepse i lëvizte dhe i conte lart e poshtë. Kur zonja Hura nisi t'i tregojë se si i qe shfaqur në ëndërr një zë që i kishte thënë se ai ishte fjalëpathëni i Frederikut, Bdekut i qe hapur bebja dhe, o çudi, zonjës Hura ajo i qe dukur e gjelbër. Një ngjyrë që ajo s'ia kishte parë kurrë, një sy i madh i blertë, i kërcyer befasisht si jashtë zgavrës së tij, i murretyer dhe si i nervozuar papritur.

- Kujt ia thua këto?! - i kishte thirrur ai zonjës Hura.-

Kujt ia thua kēto grroqe, moj shtrigē?

Zonja Hura qe mpirē dhe i qenē errur sytē nga tērbimi. Mori njē mashē qē ishte pranē mangallit tē çajit dhe ia ngjeshi mbas zverkut. Sikur iu lehtēsua shpirti qē ia ngjeshi ashtu.

- Lutju dhe kērkoi mēshirē Ztotit, mor pusht,- e kērcēnoi ajo.

Bdeku vetēm sa iu mēnjanua goditjes tjetēr qē ia nisi ajo pēr sē dyti dhe nuk e quajti pēr gjē qē po bēnte ashtu. Ia kapi dorēn dhe zonja Hura ndjeu se ai qe i huaj.

Atēherē ajo tha se nuk e kishte gēnjer zemra. Iu ndez njē afsh dhe nisi tē mallkojē tē gjithē çthurrēsit e fesē. Tē gjithē ata qē e largonin njeriu nga rruga e Ztotit dhe ashtu i mjeri, i vetēm e pa ditur ç'tē bēnte, merrte rrugēn e mēkatit. Ja se ç'kishte ndodhur, ja se ç'kishte ndodhur, o i biri i Satanait. Ku i kishte besimtarēt e kishēs ai, si e kishte mbyllur Shndrenē dhe si nuk i trembej ndēshkimit pēr njē bukēshkalēsi tē tillē? Dhe ai kob, dhe ai kob ashtu pat ngjarē... Ashtu pat ngjarē ai kob, kishte vazhduar zonja Hura nēpēr jerm dhe tha se s'donte ta ngarkonte shpirtin me mēkat, mbasi ishin disa gjēra qē s'mund tē mbaheshin brenda. Por dhe ai a nuk i pat treguar se dinte gjithçka, kur, sapo pa shkelur mirē ajo nē konakun e tij e kishte pyetur se a mos e kishte marrē atē rrugē qē t'i rrēfehej? Ia kishte bērē tē qartē se aty shumē gjēra ishin marrē vesh. Zonja Hura nisi tē shugullonte. Tē gjitha lidheshin me ēndrrēn qē kishte parē dhe s'kishte qenē njē natē e vetme qē ai zē i qe shfaqur ashtu. Shumē herē tē tjeta qe zgjuar nga njē

zē qē i pēshpēriste e i thoshte se ajo vdekje qē kishte ngjarē lidhej me Bdekun. I qe shfaqur njē si hije e Zonjēs nēpēr ēndērr dhe e kishte pyetur pēr Bdekun. Nuk e kishte pyetur mē kot dhe qē nga ajo kohē zonjēn Hura nuk e kishte zēnē mē vendi. Nuk kishte qenē mē kot qē asaj tē nesērme nē mēngjes, si pat ikur munshinjur Injaci pēr nē kishē, i pari njeri qē i qe kujtuar t'i hapte zemrēn kishte qenē Domenika. Nuk kishte qenē kot qē ajo i kishte gjetur Domenikēn dhe Frederikun shumē tē shqetēsuar dhe tē pērhumbur ngaqē nuk dinin se çfarē tē bēnin. Pastaj ajo lutja e Domenikēs qē tē pinin njē kafe bashkē. Zonja Hura nuk dinte tē thoshte tani se pērse i qe bērē nyje nē grykē dhe s'e kishte pyetur pēr atē qesen e parave qē Domenika kishte prurē bashkē me tabakanē e kafeve? E kishte lēnē prapa kurrizit dhe ishte harruar me hallin e madh qē e kishte gjetur.

Ishte halli i Vranēs. Vrana nuk i ndahej. Vrana i qe qepur dhe ajo nuk dinte ç'tē bēnte. Domenika nuk kishte mundur t'ia fshihte zonjēs Hura qē kishte shkuar njē natē me tē si burrē e grua. Kishte qenē si e lajthitur atē natē, nuk pat ditur se ç'bēnte. Ai e kishte rrēmbyer si njē ujk, por pēr kētē rrēmbim kishte pasur edhe ajo faj, mbasi çprej kohēsh nuk ishte e qetē karshi atij burri. I dridhej zemra kur kalonte ai rrugēs dhe nuk i rrihej pa i rēnē nē sy. Kishte shkuar me tē nē Natēn e Pelegrinazhit, kur nē Shndu qe shfaqur Zonja e Lumnueme. Qe shfaqur edhe pēr mēkatin tim, kishte thēnē Domenika, qe shfaqur edhe pēr mēkatin qē bēra nē kurriz tē njē njeriu si Frederiku! Prandaj qe penduar dhe s'do ta bēnte mē kurrē. Sepse

me Frederikun qe afruar nē njē çast mëshire, por pastaj i qe përkushtuar me gjithë forcën e shpirtit. I qe nënshtuar sepse ai kishte një shpirt prej ēngjelli.

Ah, Vrana, ai nuk i ndahej! Domenika kishte harruar se kishte një pasion, por i qe ngjallur kur qe shfaqur Vrana. Qe zgjuar një si dragua i fjetur tek ajo atë ditë kur ai e kishte mbartur nē kurri zë mushkës dhe ajo ndjente nē mishin e saj djegien e pëllëmbëve tē duarve tē tij tē fuqishme...

Ky Vrana i shkonte natën nē shtëpi dhe nuk ishte e mundur ta përbante asnjë dryn e asnje derë. Që kur ajo qe mbyllur e ruhej tē mos e takonte, ai se nga i gjente vrimat nëpër trarë e nëpër hatlla dhe zbriste nē dhomën ku flinte me Frederikun. E tërhoiqte nga shtresat, ajo e gjakoste me thonj, e kërcënonte e i lutej, ngashërente e i qante edhe ai, si nuk arrinte dot gjë, ikte duke iu betuar se nuk do tē hiqte dorë prej saj. Të nesërmen i vinte prapë, mundohej tē fshihej e t'i afrohej tinëz nëpër terr, por nuk ishte e mundur tē mos kërcisin dërrasa e dyer, tē mos thyheshin shtëmba e tē mos rrrokulliseshin buliera nga ardhja e tij.

Kurse Frederiku flinte. Frederiku nuk zgjohet kurrë. Në ato çaste Domenika e urrente. Sapo ndjente afrimin e Vranës, asaj i vinte tē ngrihej e t'i fuste thonjtë nē fyt Frederikut. Ta shkundte e ta zgjonte e t'i thoshte se shiko se çfarë e kishte gjetur! Por ai flinte dhe Domenika hiqte dorë shpejt nga ky mendim. Madje niste e ndjente njëfarë lehtësie që ai qe si i vdekur nē atë gjumë tē thellë. Jo se ashtu mund tē bërriste e mund tē cirrej, jo se e kishte kollaj që

ashtu t'i kthehej e ta shtynte Vranën me tē ashpēr, por sepse nuk i pēlqente qē Frederiku ta shihte tē kapur pēr duarsh me njē tjeter, qoftē edhe duke e gērricur e duke u pērpjekur t'i shpētonte.

Kēshtu kishte vazhduar natē pēr natē pēr njē javē a pēr dy, deri sa kishte mbrritē ai çast i kobshēm. Vrana kishte mbrritē me sokellimē si nēpēr tjugulla e si nēpēr kulm tē çatisē, si nēpēr hatlla e si nēpēr trerē derisa qe mbēshtetur tek ajo. Frederiku, qē s'bēhej kurrē i gjallē, qe hedhur nē kēmbē me tē keq. Kishte ndezur llampēn dhe kishte zēnē t'i shikonte me njē si tallje e me njē si shpoti qē tē priste si shpata. Vrana, qē ishte nē bisht pranē shtratit tē saj dhe po i griste rrobat, qe hedhur nē kēmbē. Domenika, nē atē gjendje tē mjeruar, e grisur dhe e çafalitur, gjithē vazhda tē gērricurash dhe me flokē tē bēra lēmsh, pēr herē tē parē kishte ndjerē njē urrejtje tē vērtetē pēr Frederikun. Pērse e shikonte ashtu me atē buzagaz tallēs? Pērse ia kish ngritur aq shumē fitilin asaj llampe dhe pērse bēnte aq dritē? Apo qē ta shihte mē mirē se si po e poshteronin? Kishte shkuar me vrull tek ai dhe ia kishte marrē atē llampē nga dora. E kishte pērplasur mbas murit dhe nē atē çast kishte plasur flaka...

## KAPITULLI I NËNTË

Nē kētē pikē, kur zonja Hura po i tregon te kētē gjē, Bdeku, me njē tallje qē lexohej faqeza, e pyeti:

- Ti thua se Vrana nuk qe i zoti t'i shuan te ato flakē?  
Zonja Hura u ndje keq.

- Zonja Hura,- kishte vazhduar ai.- ti je e shenjtē dhe gēnjeshtra ēshtē njē mēkat. Unē s'jam gjyqtar qē kam dalē tē gjykoj njerēzit. Gēnjeshtrat shkoni e i thoni atje ku duhet dhe atje ruhuni qē tē mos ju dēnojnē.

- Satana! - kishte klithur ajo papritur.

- Mē thuaj pra, moj zonja Hurē,- kishte vazhduar Bdeku me tē keq.- pērse erdhe tē rrēfehesh kētu tek unē? Ti e di qē unē e kam hequr zhgunin e meshtarit dhe kisha mē ka mallkuar. Mos do qē tē gjesh si fshihet faji dhe jo si shkon nē vesh tē Zotit?

Hurēs i qenē errur sytē. E goditi nē ballē me njē kopaçe qē trazonin prushin nē mangallin e çajit. Bdekut i shpērtheu njē pizgē gjaku, por s'e pati pēr gjē para njē tē verdhū qē i kishte rēnē gjatē gjithē asaj kohe qē tregonte ajo. As e vuri re gjakun qē ia skuqi gishtat kur çoi dorēn dhe fshiu plagēn. Zonja Hura po dridhej dhe i kishte mbērthyernofullat si e zēnē nga gērçi. Sytē e zinj i xixellonin dhe mezi mbushej me frysē.

## KAPITULLI I DHJETË

Mbas kēsaj, zonjēn Hura e kishin çuar nē konakun ku do tē bujtte, duke e shtyrē kēmbēsh e duarsh si njē tē lajthitur. Njē trashan me shallvare tērē pluhur ia kishte pērdredhur qafēn dhe e kishte vēnē pērpara me hungērima. Dhe e kishte mbyllur nē atē konak si brenda nē njē qivur. Aty zonja Hura qe shakulluar. Qe qepur mbas hekurave me sytē mbi kalldrēmin e oborrit, ku s'ndihej asnjē frysē gjallime. Zonja Hura

sikur po çmendej nē heshtjen e asaj dhome. I vinte njē si frikē nga dy kurrize malesh qē nxinin matanē dritares nēn kupēn e qiellit. Njē vdekje e tmerrshme, njē vdekje e tmerrshme, i kumbonte njē zē qē sikur i vinte nga qielli i zi. Po i sulej njē lebeti qē tē mbyste; njē frikē e njē tmerr si atē natē kur qe sulur drejt shtēpisē sē Frederikut. Si nē atē çast qē kishte parē flakēt qē kishin shpērthyer atje. Zonjēs Hura nuk i hiqej nga mendja ajo natē e tmerrshme qē thērrisnin e bērtisnin dhe me gra qē lēshonin ca kuje tē lemerishme. Me tē mbērritur, kishte dēgjuar se Frederiku kishte mbetur brenda dhe qe bērē shkrumb! (O Perēndi, ç'i kishin dēgjuar veshēt!). Nuk kishte qenē e mundur ta shpētonte kurrikush pērmes flakēve dhe trarēve tē ndezur qē binin. Domenika bērtiste si e çmendur dhe pērpiquej t'u shpētonte duarve tē atyre qē e mbanin. Zonja Hura kish rendur tek ajo dhe e kish mbledhur nē gjoks, ia kish lēmuar flokēt dhe ish pērpjekur ta qetēsonte. Pastaj e kish marrē me vete dhe e kish çuar nē shtēpinē e atēnisē. E dorēzuar para gjēmēs qē e kishte gjetur, Domenika i kishte treguar gjithçka. I kishte rrēfyer pēr atē zgjim fyes tē Frederikut qē e shihte tek e turpēronte Vrana. I kish thēnē se ia kish hequr atē dritē nga dora dhe ia kish thyer atē llampē ngaqē donte tē shpētonte nga turpi. Zonja Hura e kishte pyetur: "Po Vrana, a s'qe i zoti t'i shuante flakēt sa patēn rēnē?". "Jo" i kishte thēnē Domenika. Ajo grua ishte bērē kufomē dhe s'ishte fare nē kētē jetē. "Jo" kishte pērsēritur dhe kishte shtuar pēr lebeti tē zonjēs Hura: "Atē zjarr e vura unē!". E mēshiroftē Zoti kētē grua qē flet pērçart,

kishte thēnē! Kēshtu kishte thēnē dhe ishte tmerruar. Çfarē, e kishte djegur vetē tē shoqin?! (Ah Bdeku, i mallkuari! Gjēja e parē qē i kishte shkuan ndērmend kjo kishte qenē, kurse ajo qē thoshte Domenika ishte njē marrēzi, njē trillim i mendjes sē saj tē çartur. Sepse Domenika ishte aq e butē dhe kishte njē zemēr aq tē mirē!). “Zjarrin e vura unē” i kishte thēnē Domenika me sytē pa lot, pa shprehje e pa dhimbje. Tē gjitha i kishin rrjedhur nēpēr faqe dhe vendin e tyre e kishte zēnē njē perde e hollē e qelqtē. Zonja Hura mbante mend se mbas kēsaj, çdo gjē ishte bērē e tmerrshme. Tē ngjallte frikē mendimi se mund tē rihapej ajo bisedē. “Ngjitemi nē Shndu,- i kishte thēnē zonja Hura me sy tē shqyer nga tmerrri.- Ti flet pērçart, ti ke nevojē tē rrēfehesh! Dēgjon? Ngrehu e ngjitemi bashkē, ti nuk mund tē durosh dot mē!”. Por Domenika nuk hiqte dorē nga e vetja. Pērsēriste e pērsēriste se zjarrin e kishte vēnē ajo dhe se ishte ajo qē e kishte djegur Frederikun. Siç tē kam thēnē, i shpjegonte rishtaz e rishtaz, ai mē shihte tē grisur e tē bērē pēr turp dhe unē e dogja. Kaq e kaq net qē as qe bērē i gjallē, ndonēse unē e tērhiqja dhe e ndukja qē tē zgjohej. E kishte ngritur fitilin e llampēs dhe kēsisoj mē tallte e mē shpotiste.

Domenika i kishte treguar se, kur kishin shpērthyer flakēt, ajo kishte parē bllana vajguri nē kēmishēn e Frederikut. Ajo llampē kishte qenē e mbushur plot dhe Domenika e dintre se i lagur nē atē mēnyrē ai do tē digjej. Do tē merrte flakē dhe ajo as qē kishte bērē ndonjē pērpjekje qē ta shpētonte. Ajo kishte pritur sa tē ndizej dhe mbas kēsaj kishte ndjerē se prapa

shpinës kishte pasur Vranën. Edhe ai kishte pritur porsi ajo që Frederikun ta përpinte zjarri dhe pastaj, kur e kishte parë të ndezur hor, Vrana e kishte mbërthyer për shpatullash dhe e kishte nxjerrë pérjashta. E kish lënë në oborr dhe qe zhdukur. Mbante mend që mbas kësaj ajo kishte brritur. Kishte lëshuar një klithmë dhe qe sulur drejt flakëve, por kishte qenë tepër vonë për gjithçka. "Se ti s'e hodhe me dashje atë llampë" kishte dashur ta sillte në yete zonja Hura. "S'e hodha me dashje? kishte shpotitur Domenika.- Sa gabohesh! Unë doja që ai tē vdiste. Tē vdisja edhe unë, këtë doja. Tē merrija flakë, por nuk munda".

Dhe mbas kësaj Domenika nuk pat folur më. I kishte ikur mendja dhe ishte e kotë t'i flisje a t'i kërkoje tē tē thoshte ndonjë gjë. U têrhoq në një kënd tē dhomës e u mblodh e u bë kruspull. Nuk mori e nuk dha me njeri për dy javë tē tëra, gjersa erdhi një ditë që ajo ishte zhdukur. As mund tē thoshte dot njeri se ku shkoi e ku humbi në një mënyrë tē çuditishme. Kishte rënë tē flinte në darkë, në konakun që i kishte hapur zonja Hura në shtëpinë e aténisë, por në mëngjes nuk qe gjendur aty. Dera e konakut dhe dera e madhe e shtëpisë, ishin po ashtu tē mybyllura siç kishin qenë, mëndallat e shulet e portës së oborrit nuk kishin luajtur nga vendi! Si i kishte kapërcyer muret ajo grua dhe nuk kishte lënë asnje shenjë?! Zonja Hura kishte thënë me vete se këtu kishte gisht Vrana. Vetëm ai tē rrëmbente si fajkoi i quillit. Dhe ishte lëshuar drejt mullirit tē Vranës, por nuk e kishte gjetur atje.

Atēherē zonjēn Hura e kishte kapur njē logori. Njē qarje e çuditshme si nē tē mpitē. Ç'i ndillte zemra ashtu, ç'kob i kēndonte pērbrenda? As dinte se çfarē thoshte nē atē gjamē, ndërsa kthehej pērimes shtegjeve pēr nē shtëpinē e atēnisē.

## KAPITULLI I NJËMBËDHJETË

Bdeku me tē keqtē e vetē i kishte thēnē se pa asnijē mëdyshje kuptohej qē Frederikun e kishte djegur Domenika. Zonja Hura, kur kêtē gjë ia kishte thēnē vetē Domenika, më kot e kishte gënjeri veten kur kishte thēnē se ato ishin fjalë prej tē çmendure. Ishin tē vërteta! Një panik e një alarm i tmerrshém tē pushtonte nga ky pohim. Erdh e ia errësoi syrin e ia shugulloi shtatin vajì që i ngjitej së brendshmi. I kish rënë me mashë Bdekut dhe pēr kêtē e kishin hequr zhganë pēr këmbësh e pēr duarsh dhe e kishin çuar nē konakun ku kishte qenë. Ishte diçka e pangushëllueshme ajo e qarë që i dilte nga shpirti. Qe qepur pas hekurave tē dritares me sytë pa lotë dhe pa shprehje. Një e qarë që sa vente e i bëhej logorimë nē natën e pafrymëtë, një pikëllim ogurzi që s'kishte zemër ta duronte.

## KAPITULLI I DYMBËDHJETË

Rojet ia mbërritën sakaq. Ishin tre vurukanë tē hardallosur me kama nē brez dhe me ca feste me xhufka që u vareshin mënjanë.

- Ssst, ssst.- Nisi tē zgjatej e tē kanosej njëri nga ata

qē nga poshtē, duke vēnē gishtin para buzēs.- Ssst, ssst!

- Ssst, ssst,- ia nisēn edhe dy tē tjerēt, tē xhindosur si i pari, por edhe tē trembur qē ajo e lajthitur qante nēpēr natē.- Ssst, ssst!

Brenda rrāhēn me ngut nallanet e atyre dy plakave qē sikur dolēn nga guvat dhe po ngjisin shkallēt e gurta. Mezi prisnin tē arrinin dhe dihatnin tē lebetitura dhe syshqyera. Ishte njē mēkat i madh tē qaje natēn, ishte njē ndjellakob. Kishte ndodhur tē binin qerre me tē vrarē, por kurrkush nuk kishte lēshuar zē natēn. Patēn ndodhur lloj-lloj vdekjesh, por askush s'e kishte nxjerrē piskamēn. Ç'hata kishte ngjarē ashtu qē qante ajo e mallkuar?!

Plakat e tērhoqēn nga hekurat e dritares, njēra i thirri dhe e shkundi qē tē pērmendej, por zonja Hura nuk ishte nē tē. Syri i saj ishte i xhamtē. Dhanē e muarrēn qē ta sillnin nē vete, pastaj, si s'arritēn tē bēnin gjē, nisēn tē luten. Ranē nē gjunjē dhe zunē tē llazoronin, duke fryrē e duke yshtur me xhestē diçka tē padukshme nēpēr ajēr. Ndērkohē vinin e vinin njerēz me drita nē duar dhe me zēra tē zymtē dhe tē vrazhdē.

## KAPITULLI I TREMBËDHJETË

Qenē zgjuar tē gjithē dhe ata tē rojēs, me Xhermelekun nē krye, rendēn pēr nga Adi Khani me kullat si kēshjtellē ku ishte Bojrogu.

Bojrogu kishte tri ditē me njē dhembje tē keqe koke dhe shumē u trembēn se mos i kishte ndodhur

gjë. Në pallatin e tij qenë ndezur të gjithë fenerët e të gjithë qirinjtë dhe shkonin e vinin njerëz me nxit.

Kishte qenë ulërima e vetë Bojrogut që kishte dhënë atë alarm. Po i çuhej koka ç'prej tri netësh nga dhimbjet dhe s'po gjente rehat, kur ja ku ngrihej nëpër natë një e qarë që të çmendte! Kishte hapur me vrull dritaren lart mbi murin ballor të Adi Khanit dhe kishte brritur! Kishte lëshuar me gjithë fytin një thirrmë që të fuste datën. Xhemeleku ishte hedhur nga vendi ku rrinte dhe kishte rrëmbyer kamën, kurse doktor Abi Birunit mend i kish rënë të fikët. Atij i kishte shkuar mendja për keq. Por, mos o Zot, tha, mos o Zot t'i ndodhë gjë e keqe Bojrogut se pastaj kishin për t'ia rrjepur lëkurën. Ata të gardës i kishin thënë se do ta therrnin si kec po ta gjente gjë zotërinë.

Por si kaloi frika dhe hutimi për shëndetin e Bojrogut, si rreshtën së rrahuri hapat e njerëzve që shkonin andej këndeje, erdhe e ra një heshtje e një stepje dhe mbas kësaj u ngrit përsëri e qara e saj ogurzezë nëpër natë. Nga odat e Bojrogut, përkundër Xhemelekut me rojet dhe përkundër Abi Birunit me xherahët, dolën rojet e gardës me brezat prej purpuri dhe i thanë Xhemelekut që t'i mbyllej goja dhe t'i pritej gjuha asaj shtrige. Xhemeleku theri për nga konakët dhe sakaq ishte gjendur bashkë me rojet tek dritarja e zonjës Hura.

- Qepe! - i kishte thirrur ai, por zonja Hura ishte në atë botë. I qe rrëzuar shamia dhe i patën rënë flokët nëpër hekurat e kafazit. Njëra nga plakat erdhë dhe i tha Xhemelekut se ajo dosë ishte me ilet dhe kot i fliste. Ajo ishte përpjekur që ta zinte kolla; i kishte

afruar pēr kētē gjē tym nē fytyrē, por kishte qenē e pamundur.

Atēherē Xhemeleku kishte brritur:

- Sikterriseni!

- Sikterriseni! - kishin brritur edhe ca zēra tē tjerē.

Rojet qenē sulur lart dhe e kishin marrē zonjēn Hura pēr kēmbēsh dhe pēr duarsh. Kur e patēn zbritur nē oborr, qe dukur Gjovalini, djali i gjitone Terezēs qē e kishte sjellē zonjēn Hura aty. E kishin prurē ata tē gardēs dhe ia vērvitēn Xhemelekut:

- Ti i ke lēnē kēta tē futen nē Adi Khan?

Xhemeleku nuk e deshi veten. Nuk ktheu ndonjē pērgjigje, por zjeu pērbrenda. Hapi krahun dhe ia ngjeshi me njē dackē Gjovalinit, pastaj, bashkē me zonjēn Hura, i shtyu drejt portēs. Aty prunē mushkēn dhe e hodhēn zonjēn Hura si njē thes mbi samarin e saj. Pastaj ia ngjeshēn me kamzhik vitheve dhe e hodhēn edhe Gjovalinin mbas saj qē ta ndiqte e tē zhdukeshin.

## KAPITULLI I KATËRMBËDHJETË

Kishte rēnē njē heshtje qē tē ngjethte. Bojrogu donte shpjegime pēr atē qē kishte ngjarē dhe vigjēlonte me njē sy tē ireptē.

- C'qe ajo qē ndodhi? - pyeti duke i parē tē gjithē.

Ishin nē sallēn e madhe, i kishte mbledhur tē gjithē sa mbanin pērgjegjësi pēr atē ngjarje.

Xhemelekut i kishte ikur gjaku. Kishte qenē ai qē e kishte lēnē atē magjistricē tē kapērcente portēn. Qe gēnbyter nga njē kērpakan qē ia pruri dhe ja tani

ku rrezikonte ta paguante rëndë. Mori t'i shpjegojë diçka nga gjithë kjo, me gojën që i merrej, por vuri re se Bojrogu u ngrys edhe më tepër. Xhemeleku e kuptoi se nuk i kishin pëlqyer fjalët e tij.

Atëherë nisi të flasë Komandanti i Gardës dhe ky tha se kishte qenë një gabim që atë grua e kishin shtruar tek konakët e mirë, kur njerëzit e panjohur, siç e donin rregullat, çoheshin në skajin matanë kazermave. Kuptohej që faji i mbetej kështu Sirianit, një burri të prurë nga Bitini, që shquhej për besnikërinë e tij dhe që pikërisht për këtë Komandanti e urrente për vdekje. Siriani tha se zbatonte urdhërat. Ky urrente Bdekun dhe fjalën e kish për të, sepse kishin qenë njerëzit e tij që ia kishin çuar atë plakë për mysafirllëk.

Bojrogut po i plaste koka nga ky lumi fjalësh bosh. I bëri një shenjë doktor Abi Birunit që t'i jipë ndonjë ilaq dhe ky u ngrit vrulltazi dhe i shkoi pranë me çantën e tij plot me shishe. Bojrogu futi në gojë ca pika nga një tub dhe pastaj e pyeti doktorin nëse i kishte dhënë ndonjë gjë asaj ezhdërhaje që kishte heshtur? Abi Biruni zgurdulloi sytë! Nuk i kishte dhënë asgjë! Shikoi nga ana e Xhemelekut dhe ky mori zemër dhe tha:

- E përzumë!

Bojrogu u trishtua. S'kishte qenë në vete në kohën e kësaj hedhjepritje fjalësh, prandaj dhe po i ndiqte ata si një matuf. Kurse ai donte tjetër gjë. Kjo shenjë ogurzie ishte mëse e hidhur dhe mëse kërcënuese. Çoi sytë nga Bdeku. Kuptohej, shpjegimet i priste nga ai, mbasi për këtë punë e mbante dhe ai duhej

t'i dinte tē gjitha.

- Një llazore, një vajtojcë,- i qe përgjigjur Bdeku shikimit tē tij.- Një që qan pér një rrënim..

- Të kujt?! - iu zgjeruan sytë Bojrogut, ndërsa i rrahu një tik nervor nëpër faqe.

- Të një feje,- pati guximin tē thoshte Bdeku.

Ai foli si pér diçka që s'i takonte atij dhe u kërrus. E kapi një si frikë, por nuk deshi ta dorëzojë veten.

- Ju e dini se atje është shfaqur një shenjë që ngjall habi që s'ka tē sosur,- tha.

- Dhe?!

- Dhe po zgjohen,- i mëshoi zërit Bdeku.

Tamam, po zgjoheshin, tha Bojrogu me mendjen e tij, ndërsa i tallazitej zemërimi. Të gjitha raportet që merrte këtë gjë thonin. Me atë ikonë, njerëzit sikur po kujtoheshin pér diçka që e kishin harruar. Sikur po dilnin në një dritë dhe atje po shihnin se sa shumë gjëra qenë shkatërruar në shpirrat e tyre. Këtij syllashi i priste mendja brisk. Pér herë tē parë pati frikë. U krijua udha e shenjës, tha me vete, tani do tē më tregojnë me gisht. Kurse kishte qenë aq rehat, kishte rrojtur si një njeri që tē gjitha punët i shkojnë mbroth. Ata me shpirtin tē trazuar nga mëkatet e tyre, tani sikur e kishin gjetur shkakun. E kishin vendosur udhëzën e shenjës si një pe tē zi që tē sillte tek ai. E kishte sjellë ajo e mallkuar. Prit kur tē vinin tē tjerë e tē tjerë, prit kur t'i qaseshin pranë e më pranë dhe ta kallëzonin me gisht.

- Ne duhet ta kishim ditur se do tē vinte kjo ditë,- tha Bdeku me tē keq. Edhe ai ishte tepër i shqetësuar, madje i qe kërleshur nga frika një si karshillëk, sepse

kështu mendonte se mund ta bënte Bojrogun të têrhiqej e tê përmabahej. Me këtë i thoshte atij zoti se nuk ishte më pak i kërcënuar edhe ai vetë, që kishte lënë zhgunin e famullitarit dhe kishte veshur jarasekun e atyre punëve të fshehta. Edhe për të që hequr shenjëza e kallzimit, dyfish më e keqe, dyfish më kanosëse. A nuk i kishte thënë Bojrogut që në krye të herës se kush mund të sundonte tanë mbi ta kur të ktheheshin sërisht pranë kishave të tyre?

- Duhej ta kishim ditur, tha Bdeku, me karshillëkun e tij që ishte mëse i çuditshëm në atë sallë dhe përparrë atyre njerëzve.

Bojrogu u tulat. S'e kishte ditur se ishte fjalëkthyes ky njeri. E dinte që ishte dinak, e dinte që ishte i zgjuar, por për trim nuk e kishte ditur! Pastaj ishte një trimëri e çuditshme: shumë e hapur, brezleshuar dhe gati për të nxjerrë kamat. Mbase edhe ky njeri që zgjuar? Tha t'ia ngjeshte me një shpullë sa t'ia përplaste kokën mbas murit, por i vetoi nëpër mend se s'ishte koha për gjëra të tillë. S'ishte koha t'i fuste një këllëç këtij derri.

- Ke hak,- i tha.- Ata tanë kanë kishat e tyre.

Sirianit iu zgurdullua syri! Qysh i qe tutur Bojrogu këtij qatani që qe trashur e qe bërë si një kade gjizë?! Qysh po e pranonte fajin dhe s'po ia shkuronte kokën me thikë?! Kapi dorezën e këllëçit, por Bojrogu e mpiu me një vështrim të rreptë. Komandanti i Gardës hovi përpjetë, kurse Xhemeleku dhe doktor Abi Biruni u zverdhën dhe u bënë si dylli.

- Ka ardh kohë e madhërishme.- tha Bojrogu.- Duhet të ndezim një qiri në faltoren e tyre.

# LIBRI I PESTË

## KAPITULLI I PARË

Kështu kishte thënë Bojrogu, por Bdeku nuk i kishte rënë në sy dhe nuk i kish dhënë të kuptojë se e kishte marrë vesh se çfarë i kërkonte me ato fjalë. E kishte lënë me ngërçin në gojë dhe ia kish ndërlikur bisedën, sepse as njërit dhe as tjetrit nuk i pëlqenin punët që bëheshin me zhurmë. Qe ngritur e pat shkuar tek kazermat dhe atje i kishte porositur nallbanët t'i bënin hazër një mushkë. Një karrane më takëme të reja dhe të ujdisur si për dasëm, u kishte thënë, dhe, kur ata ia kishin prurë ashtu siç e kishte kërkuar, ia kishte shaluar dhe qe nisur me nxit që të dilte një orë e më parë nga Urbsi. Donte që drita ta zinte në mal dhe që të mos binte në syn e kurkujt.

## KAPITULLI I DYTË

Po shkonte tek Vrana. Zilet e stërkanaçes i kishte

zënë me shtupa dhe ngiste gjithmonë e më larg rrugës së madhe, duke ecur e duke u tinëzuar. Ekte nëpër thelluka e nëpër pyje të shurdhët që të mos e dëgjonte kush trokun e mushkës me patkoj prej kallfani. Moti kish marrë nga dimri dhe gjithçkaja që veshur me mjegulla të bardha.

## KAPITULLI I TRETË

Kishte bërë rrugë tri net nëpër male i vetëm dhe kishte pritur mesnatën e natës së katërt që t'i afrohej Vranës nga një anë që s'shelte njeri. Ruante se mos hynte e mos dilte kush në nulli dhe priste që gjithçka të binte në gjumë. Kishte dalë mbi krye të udhës dhe, si që bindur se Vrana që në nulli, ia kishte nisur shenjën për të cilën s'di të thotë njeri se nga e kishte ditur e nga e kishte mësuar. Ia kishte shtyrë të shkonte tek ai atë mushkë me shtupat e zileve të stërkanaçes së hequra dhe të ujdisura që ato të binin dhe të dëgjoheshin mirë nëpër natë, pastaj vëtë që tërhequr nëpër shtigjet e Shugjanit dhe ishte zhdukur si të mos kishte qenë.

## KAPITULLI I KATËRT

Vrana kishte kërcyer si i trëmbur nga velenxat kur kishte dëgjuar zilet dhe trokun e patkonjve prej kallfani. I kishte thirurr zemra se s'binte misër e s'binte grurë, por ishte jelekakja që priste prej kohësh. Ishte shenjëza e fatit të tij dhe ai kishte ngrirë dhe nuk guxonë të lëvizte nga vendi. Mbase sillte

Domenikën, por mbase edhe jo! I është lutur Zotit me shpirt të dridhur që të mos e mundonte dhe t'ia sillte Domenikën. Bjerma, o Zot, i kishte thënë, ma baj ta shof para se të më ikë mendja! Me frikë dhe me tmerr qe ngritur e pat afruar fytyrën tek baxha e dritës dhe kishte hedhur sytë matanë tufalakëve të shelgjeve. Lëkundeshin degët e tyre nën një tallazim ere dhe mbushej nata herë më hije të errëta dhe herë me vezullime argjendore. Vranës i është bërë sikur kishte ndjerë frushullimën e rrobave të Domenikës që vinte mbi atë mushkë dhe i ishte çelur nëpër shpirt një dritë hareje. Sikur ishte në një natë-ëndërr me yjëzit e qiellit që shndrisnin mbi mallin e Karmaljesë dhe mbi fushën e Saronit. Me gëzuo të bardhëtë, kishte thënë me vete dhe kishte parë se si po mbusheshin grykat me një dritë agullimi. Shqyente sytë e priste të shfaqej ajo mushkë nga çasti në çast. Ishte duke u shuar drita e hënës dhe Vrana i është kthyer e i është lutur hënës që t'ia lëshonte irrezon n'ato biga e t'ia dërgonte dritën n'ato pyje! Bamë, o Zot, ta shof Domenikën!

## KAPITULLI I PESTË

Sepse Vrana e priste prej kohësh t'i vinte mbi një mushkë me stërkanaçë dhe me patkonj prej kallfani. Që atëherë në atë natë që kishin qenë për herë të fundit bashkë. I dyndeshin të gjitha tanë Vranës me një shpejtësi të çuditshme sa kishin qenë e sa kishin ngjarë. Gjithë sa qe çartur e gjithë sa qe prishur që mbas djegies së Frederikut. Domenika pat shkalluar

dhe s'dukej mē tē dilte jashtē. E kishte marrē zonja Hura nē shtēpinē e atēnisē dhe e mbante atje nē njē dhomē tē vogēl. Por kjo pēr Vranēn kishte qenē mē e keqe se vdekja. Ai ishte mēsuar ta shihte pērditē dhe si do tē bēnte tani me Domenikēn e shkalluar e tē mbyllur nē njē kthinē! Ia shkallmonte shpirtin keqardhja qē ajo e pat pēsuar ashtu dhe sillej lart e poshtē me shpresēn se mos e shihte e se mos e ndeshtte gjēkundi. Kur nuk duroi dot mē, ishte sulur dhe kishte bērē zakonin e vet. Pat mēsymur njē natē nē shtēpinē e atēnisē dhe qe kacavjerrur nēpēr mure dhe kishte hipur nēpēr hatlla, lishte rrēshqitur nēpēr trarē e kishte kapērcyer nēpēr vrīma derisa kishte mbērritur nē dhomēn e saj. Kishte hyrē nē dhomēn e Domenikēs dhe kishte parē tani atje me sytē e tij se ajo ishte vērtet e shkalluar. Nēpēr dritēn e njē idareje ajo rrēgjonte me sytē e pērhumbur nē njē botē qē s'ishte e kētushme. Nuk fliste, rrinte me kurriz mbēshtetur mbas muri dhe nuk kujtohej e nuk pērmendej pēr asgjē. Mē kot i foli e i thirri ai, mē kot ia kapi duart e ia tērhoqi; Domenika s'jepte shenjē se do tē vinte nē vete. Atēherē Vranēs i shkrepētiu tufani i tij me thirrmē, me brengē dhe me çmenduri. Tha me vete ta merrte edhe ta çonte nē mal. Do tē martohej me tē. Do tē gjente njē shtēpi qē tē ishin bashkē dhe me siguri qē ajo do tē pērmendej. Do ta çonte nē ndonjē kishē, do tē gjente ndonjē qē t'i ayshtte tē keqen, do t'i lutej Zotit dhe do t'i thoshte qē t'i mēshironte, do t'i thērriste Domenikēs dhe ishte i bindur se do ta sillte nē vete... Dička do tē bēhej, me siguri qē dička do tē bēhej dhe Domenika do tē

shërohej. Nisi ta djegë ky zjarr dhe po i trallisej mendja kur mendonte se do tē ishte vetēm me Domenikēn nē mal, diku nē stanet e braktisura e pa njerēz tani nē vjeshtē. Dhe s'ishte përbajtur dot. E kishte ngritur nē krahë dhe e kishte mbështjellë mbas vetes. I qe shtrydhur zemra kur asaj i kishin kërcitur kockat sikur do t'i thyheshin dhe kur kishte vënë re sa qe ligur e sa qe dobësuar. E kishte marrë nē sqetull si një dujëz liri a si një barrë tē njomë trëndeline dhe kishte dalë bashkë me tē jashtë. E kishte nxjerrë nē oborr dhe aty e kishte hipur nē mushkë. Pastaj, duke i rënë shtëpisë së atënisë nga prapa, ia kishte mbajtur pér nga grykat e malit. E mbante prej llérës së krahut se mos binte, ose herë herë e mbështillte nē sqetullén e tij. Ah, si tē ikte mendja nga era e asaj gruaje!

E çoi tek nometë verore. Atje, nē një skaj që dilte si një thep nē qiell, ishte një kasolle e mbetur bosh, sepse dhentë i kishin zbritur poshtë. Një kasolle që mbante ende erën e qumështit dhe erën e deleve; vedrat dhe lugjet ishin ende me ujë, nē strehën e një gardhami varej një degë kungulli që kishte çelur lulet e fundit. Domenika as që jepte shenjë se po ndërmendej, syri i saj dukej i shuar dhe i humbur diku. Nuk i kishte dhënë tē njojur gjatë gjithë asaj kohe që ngjiteshin pér nē mal dhe nga kjo Vranës iu çart mendja edhe më keq. Iu vra shpirti dhe e quajti jetën e saj tē humbur. Edhe jetën e vet. Edhe atë. E uli Domenikēn pranë vatrës ku zihej qumështi dhe aty iu bë se ndjehej ende afshi i zjarrit dhe aroma e ajkës që trashej nē kusi. Kishte qenë një grua aty, një nga ato tē Gjikodit, Terezina me duart e bardha dhe

tē pastra si top dēbore. Tē shenjtē tē gjithē: burri, gruaja dhe fēmijtē. Vranēs iu vra zemra dhe qau pēr fatin e tij. Kēshtu e kishte menduar jetēn ai, nē njē skaj si ky me njē nome dhensh, me gruan qē punonte bulmetin dhe me fēmijēt qē rendnin mbas deleve dhe mbas qenve.

Mezi i bēnin duart tē ndizte zjarrin se nuk i shkrepte mirē urori mbi eshkē dhe se nxitohej. Domenika rrinte nē terr, nēn njē baxhē ku hynin feksjet e yeve tē largēt. Bēnte fresk, Domenika ishte pothuaj lakuriq. E kishte marrē ashtu siç kishte qenē nē shtrat dhe ajo dridhej tanī dhe s'dinte tē thoshte tē keqtē qē hiqte. Sapo kishin dalē nga katundi, Vrana e kishte mbēshtjellē me setrēn e tij, por kjo s'e kishte ruajtur dot nga akullimi i erēs sē pasmesnatēs.

Zjarri u ndez me flakē tē madhe, sepse Vrana e kish mbathur mirē me shkarpa dhe me bar tē thatē. Feksi gjithē kasollja me muret dhe me trarēt e nxirē tē saj dhe me vedrat e kupacēt e drurit, lēnē aty pēr verēn e ardhshme. Kasollja qe shtruar me bar, errur e lagēshtuar vende vende nga uji i derdhur. Por vatra qē shumē e mirē me shkamijtē e drurit pērqark dhe me kamastrēn qē varej nē mes.

Sapo qe ngritur ajo flakē qē e mbushi me dritē kasollen, Domenika qe çuar nē kēmbē vrikthi si e trembur. Setra i kishte rrēshqitur poshtē, kēshtu qē Domenika ishte lakuriq. I kishte pērjashtē kofshēt, llērēt dhe gjinjtē qē s'arrinte t'ia mblidhте njē kēmishē pēlhure, zburkuruar me qēndisma. As njē si mēngore qē kishte veshur pēr tē mbuluar kurrizin. Flokēt e gjatē, tē errēt e tē shndritshēm, i binin gjer

ku niste e harkohej qafa e saj mbi kurmin e gjoksit. Ajo i kishte ngrysur vetullat dhe sytē i xixéllinin. I kishte kryqézuar krahēt para kraharorit dhe ngjishej pas murit si tē donte t'i ikte sa mē larg asaj drite dhe atij zjarri. Vrana pa njē flakēritje nē sytē e saj. Si nē atē natē kur e shihte Frederiku me llampē nē dorē.

- Frederik! - i thirri ajo duke iu kanosur.

Vranēs i kishte ikur mendja. Si i kishte ardhē ajo fjalē nē gojē?! Si kish folur mbas aq kohe īmemecllēku?!

- Jam Vrana,- ia kishte pritur ky dhe s'e mblidhte dot veten.- S'jam Frederiku.

Ajo uli krahun me gjithē grushtin ngritur pēr tē qēlluar, e mbēshtolli mē fort kēmishēn nē kraharor dhe e vari kokēn nē pērhumbjen e saj tē thellē.

- Eja,- tha Vrana duke bērē kujdes qē tē mos e tutte.

E kapi te kyçi dorēs, por, o Zot, ajo sikur u zgjua dhe nisi t'i vērtisē krahēt si fugē. Donte tē mbrohej, tē qēllonte dhe thērriste e bērtiste, duke tentuar ta grricte ku mundte. Dikur u lodh dhe nuk pati fuqi mē tē kundērshtonte; u tulat dhe nisi tē kqyrē si tē pērpiquej tē vinte ndērmend. Sikur po pyeste se cili ishte ai dhe ku ndodheshin ashtu?

- Jam Vrana,- i tha ai pērséri.- Domenikē, o yll i qiellit!

Ai e mori pranē vetes.

- Domenikē, dēgjon! Jam Vrana!

Ajo uli duart, i afroi fytyrēn me sytē e zgjeruar mē pranē dhe e kqyri njē copē herē.

- Vrana?! - pyeti si t'i çahej njē terr nēpēr mend.- E çfarē do ti nga unē?

- Kemi ardhē nē nomé, tē kam marrē nga shtēpia e atēnisē. S'e kam pasē mendjen nē vend kur tē kam marrē lakuriq, por kam me t'i ble rrobat ma tē bukura ku janē.

Ajo e kqyrte me ata sytē e mēdhenj e tē zes dhe lēkundej sa para mbrapa. Sikur e kishte pushtuar njē prehje, rrudhте ballin si tē donte tē kuptonte diçka, po s'mundte. Flakēt e zjarrit hidhnin bllana drite mbi trupin e saj dhe Vrana e ruante se mos digjej. Qēndismat nē kēmishēn e saj prej pēlhure tē sillnin ndērmend se sa sqimatare dhe e pastēr kishte qenē ajo grua. Nuk kishte parē tjetēr Vrana tē vishej dhe tē mbahej aq bukur sa ajo. I kujtohej kur e shihte tek çardaku herē si luleverdhē, herē si lulēkuqe dhe herē tē veshur me mēndafshe dhe me temina qē shndrisnin.

Domenika qe tulatur e qe qetuar tani. Ajo qe grisur dhe bērē mē keq sesa atē natē qē e kishte parē Frederiku. Por atēherē syri i saj digjej nga njē zemērim i parrēfyer qē Frederiku qe zgjuar dhe e shihte nēn dritēn e llampēs qē mbante nē dorē, kurse sonte, i dukej Vranēs, ajo nuk ruhej e nuk druante.

- A po tē vjen zor nga unē? - e pyeti ai.- Po s'ka pse me t'ardh zor nga unē.- e kundērshtoi po vetē aty pēr aty.

Domenika, e harruar nē t'errtin e vet, pērcolli njē lemēz dhe Vrana pati frikē se mos niste dhe qante pērsēri. Ia hodhi setrēn supeve dhe e uli nē njē poste buzē vatrēs. Flakēt e mēdha tē zjarrit qenē tulatur dhe kasollja kishte rēnē nē gjysēmterr.

- Unē jam i çmendur mbas teje,- i tha ai dhe e

mbështolli mbas vetes. Këmbët e saj përskuqeshin nga dritërimat e prushit.- Nuk e quaj veten fajtor para askujt që jam çmendur mbas teje. A më dëgjon?

Ai e tërhoqi drejt vetes dhe ajo ktheu sytë dhe e pa. Iu duk se diçka po kthjellohej në retinat e syve të Domenikës dhe Vrana mendoi se ajo po ndërmendej. A mos vallë po vinte në vete tanë tek kjo vatër e tek ky zjarr? - tha ai.

- A më dëgjon? - e tërhoqi sërish drejt vetes.

- Po,- lëshoi një zë Domenika që sa mezi dëgjohej e që Vranën e la pa mend. Ajo po fliste, ajo po kuptonte se çfarë i thoshte ai!

- Unë do të marr grua, unë s'të le më të ikësh sikur të vdes,- shpejtoi të thoë Vrana.- Ne do ta ngremë shtëpinë tonë diku dhe s'do ndahemi më. Jam Vrana, Vrana!

Ajo pa rrëth e qark kasolles si e zgjuar atë çast.

- Vrana?! Çfarë na ka ndodhë? Çfarë na ka ndodhë?

- tha dhe pa me tmerr diku.- Ku është Frederiku? Ku është Frederiku? - thirri dhe iu këput zëri nga një ngashërim i rëndë dhe i thellë si në një gremisje të gjithçkaje.- E kemi vrarë Frederikun. E vramë Frederikun.

Vrana ia zuri gojën me pëllëmbë. E përcëllooi një tmerr dhe e njjeshi aq shumë mbas vetes sa të thoje se ia zuri frymën. E mbajti ashtu deri sa iu davaritën të përqethurat që e kapën nga fjalët e saj. Po i përhumbjej e përhumbjej diçka, duke mbajtur në gjë shtatin e saj aq të brishtë dhe nisi t'i rrahë zemra me vrull. Ndjeu një si afsh që i ngjitej nëpër trup. Ah, i klithi në shpirt, më mirë të vdes, më mirë të plas sesa

tē jem larg kēsaj gruaje! Si mund tē bēnte pa e mbajtur kēshtu nē krahēt e tij dhe, qē tē mos e lēshonte kurrē, ishte gati tē bēnte gjithçka. Ia çoi dorēn tek flokēt dhe ia pērkēdheli. Iu mpi koka dhe nisēn t'i ziejnē veshēt. Ia lēmoi flokēt qē i qenē derdhur nēpēr kurmin lakuriq' dhe nisi tē flasē vetmevete si tē bisedonte me Domenikēn: "Dēgjon? Nuk ēshtē koha tē qash pēr Frederikun.- po i thoshte asaj.- Jemi nē kētē nomē, unē i çartur krejt nga mendt qē tē kam kaq afēr e ti me njē avull qē tē ngrihet nga shtati. Nuk ka pasur çast qysh se tē njoh qē nuk kam menduar tē tē kem kēshtu pranē vetes. Domenikē! Nuk do tē ndahemi mē. Frederiku vdiq, nuk ishte pēr ty Frederiku, ishte mēkat pēr njē grua si ti! Nuk do tē ndahemi mē,nuk do tē ndahemi kurrē!"

Vrana e mblodhi nē gjoks. As e ndjeu fare peshēn e saj, vetēm gishtat iu drodhēn kur i prekēn mishin. Por Domenika u hodh me vrull mēnjanē qē tē ikte.

- Ik! Ik! Ik!

- Tē vdes.- foli Vrana dhe s'e lēshoi nga duart.- Qe, kam me u hedhē nga shkambi po m'pērzune. Ti ke lind pēr tē qenē imja. Do digija gjithē botēn pēr mos me t'lanē me m'ik, gjithē botēn!

Domenikēs iu zgjeruan sytē nga tmerri, por Vrana e shtrēngoi fort dhe s'e la tē nxirrte zē. E pērcēlloj zjarri qē i digjej sē brendshmi dhe nisi ta çojē drejt njē qosheje tē kasolles. Por s'po e vinte re se aty gjithçka qe e ndotur dhe e pistē. Bari ishte tērē bllana balte e kalbēsirash. E shtriu nē mes tē batakut dhe ia hoqi ato dy plaçka qē kishte nē trup. Domenika kundērshtonte dhe e bēri gjak me thonjtē e mprehtē.

E grricte ku tē mundte: nē zverk, nē fytyrē, nē duar. Çirrej me një brritmë që s'i dilte dot nga gryka, ulérinte dhe lotët i venin çurg, por ai as që përmendej nga tèrbimi që e kishte zënë. Ia bëri mishin gjithë njolla dhe e ndoti tē tèrën. Ajo u lodh e u këput dhe dikur ndjeu se po i mpiheshin krahët e po i lodheshin gjunjët. Po e pushtonte një kapitje nën peshën e rëndë tē Vranës që frynte e shfrynte. E dogji edhe atë së brendshmi një zjarrmi, nën atë burrë që e shtypte dhe e ngjeshte. Iu mek fryma kur iu fut dora nëpër gjoksin e tij. Iu harkua trupi vvetetiu dhe u ngjit pas tij. Vrana hovi bashkë me tē. Ai e nxorri në fillim tek pragu i derës, pastaj në livadh dhe e rrrokullisi nëpër barin e lagur nga vesa, duke kërkuar një vend më tē mirë. E çoi tek një gardh me murrriza. Aty u përgjakën. Aty mes degëve me gjemba nuk diti më se ç'bënte tek i sulej me gjithë epshin e tij. E pushtonte me krahët e fuqishëm, kurse ajo i kulprohej dhe i vinte qark nëpër kraharor.

- Vrana! Vrana?!
- Domenikë!
- Ah, Vrana!

U drodhën tek dëgjuan zërat e njëri tjetrit, u shtrënguan fort e më fort, sikur donin tē bëheshin një, pastaj u ngurosën. Mbetën tē kapérthyer me njëri tjetrin për një kohë tē gjatë, tē lodhur e tē rraskapitur. Pastaj Vrana kishte ndjerë se po ia ftohte djersët puhija e pasmesnatës dhe po i digjin nëpër kurm tē gërvishurat e tē grricurat e saj. I përpëlitez në shpirt një gjë aq e bukur mbas asaj furie. Po i shfaqej çdo gjë tani nëpër kthjellësi mbas asaj gjëndjeje si nëpër

tym e si nēpēr zjarr ku kishte qenē gjer atēherē. Po dilnin rishtaz yjēzit e qiellit dhe kurrizet e errur tē maleve po dukeshin pērsēri tē qartē e tē afērt, nē njē hapsirē tē qiellit qē po mbushej me dritēn e agut. Vranēn nisi ta pērshkojē njē si çudi qē ndodhej nē atē kēnd tē maleve me Domenikēn. Nuk i besohej se ishte ai qē mbante trupin e saj tē lakuriqtē tē pushtuar pranē vetes, nēn degēt e njē murrizi dhe nē barin e vesitur tē njē luadhi. A vērtet Domenika ishte ajo, apo qe nē ēndērr? Sa herē e kish menduar njē natē tē tillē, sa herē kish thēnē qē tē ishin ja kēshtu si tanī vetēm, larg njerēzve dhe tē dy tē futur ne gjirin e njēri tjetrit.

- Domenikē,- thirri me njē zē tē mekur.

- Vrana!

Zēri i saj qe i kthjellēt, i dhembshur dhe me njē regētimē drithēruese. Vrana u mek qē ajo thirri emrin e tij. Qe rikthyer nē mendtē e veta mbas atij çartimi qē kishte pasur?!

- Domenikē,- i tha pērsēri.- A po mērdhīh?

- S'mē gjen gjē,- pēshpēriti ajo dhe Vranēs iu bē se kapērdiu lotē.- Çfarē ka me mē gjetē ma shumē?

Atij i rrahu zemra nga çudia. Domenika ishte nē mendtē e veta. Ajo dintte gjithçka se çfarē kishte bērē. Njē valē e nxehħtē gjaku iu ngħit Vranēs dhe iu pērhap nēpēr fytyrē. I erdhi ligsht qē ishin ashtu tē zhveshur, tē ndotur e tē grisur. Edhe ai s'kishte dashur tē ishte ashtu nē sytē e njē gruaje. Kurrē! Kishte qenē edhe ai i lajthitur e i dalē mendsh. Dhe iu dhimbs qē Domenika qe ndotur e dērrmuar aq keq.

- S'kam dasht tē bjerē edhe sikur njē fije bari mbi

ty,- i tha.- Asgja e keqe s'kam dashtē me tē gjetē.

Lotēt qē kishin qenē nē grykēn e saj, shkuan poshtē, pastaj iu ngjtēn pērsēri dhe ia drodhēn supet me njē ngashērimē pa zē.

- Po çmendesha, Domenikē, s'ke pse mē qorton pēr asgja. Sa keq qē s'ka qenē fati ynē tē ishim me njeni tjetrin si njerēz, nē njē konak si gjithē tē tjerēt. Tash qē punēt erdhēn kështu, ikim. Do ta gjejmē diku edhe ne njē kasolle.

Domenika ngashēreu pērsēri pa zē. Vrana tērhoqi dy rroba dhe ia mbështolli shpinēn.

- E shoftē Zoti fatin tonē! - tha me hidhērim.- Kam mendu sa herē tē vinte njē ditē qē tē mē vije nuse me mëndafshe. Por, ani, kam me t'i ble rrobat ma t'mirat ku janē, Domenikē. Kam njē mik matanē Karmelisē, atje do tē shkojmē.

- Jam e mallkueme, dua tē rrëfehem ma parē.- i tha Domenika.- Do t'i lutem Zotit me m'falē. A, ku ku!

Ai e ndjeu se ajo donte t'i thoshte diçka pēr Frederikun. Ndoshta i qe kujuar ai çast i tmerrshëm kur Frederiku, ndërsa merrte flakē, i pat parē ata tē dy me sy plot lemeri e lutje qē ta shpëtonin. Por ata qenē si tē ngurosur, si njéri tjetri dhe as ai e as ajo s'bënë çap qē ta tērhiqnin nga flakët. E panë gjersa Frederikun e pērpiu zjarri dhe atë kohë Vrana tērhoqi Domenikën qē tē iknin. E çoi drejt derës, duke e hequr rrëshqanthi. Domenika ulërinte e çirrej, lutej e qante. "S'ka me na e falē Zoti qē i sheh tē gjitha,- i thoshte.- S'ka me na e falē. Kuku kuku. Ku po e lemë Frederikun!". Vrana e kishte ngritur nē krahë, kishte

shpérthyer derën e hajatit qē qe mbushur me tym tē dendur dhe e kishte nxjerrē nē oborr. Atje kishte parē se si qenē zgjuar ata qē kishin shtēpitē afēr dhe po vinin me rend nēpēr kopshite e nēpēr rrugē. Vrana e kishte lēnē Domenikēn nē oborr dhe ia kishte mbajtur lart pēr nga Guri i Shugjanit.

- S'ke si me e ngrysē jetēn e vetme.- foli Vrana me pak zē, por i mugur e i vrarē.- Edhe unē s'kam se si. S'kemi se si me i kthye ato qē kanē ndodhē.

- Kuku! - rēnkonte Domenika, duke nxjerrē nga gryka njē ngashērim tē rēndē: - S'ka shpētim pēr mue, Vrana! Unē kam ba mēkat, kam ba kob. Ja, mē shohin pērherē sytē e Zonjēs e asaj i vjen keq pēr mue.

- Por kam me iu lut unē e kam me i kērkue tē na bajē tē lumtun e tē rrojmē me njéri tjetrin si dy tē kērshtenē,- i tha Vrana.

- Praj! - i brriti Domenika.- S'jemi tē kērshtenē. Si po e ban njē i kērshtenē atē kob e atē gjamē?! Unē kam me u mbyll nē njē manastir, lemē pash Zotin, mos hy nē mēkat ma me mue! Do t'i shērbej Zotit dhe Zoti ka me mē falē!

Ajo nisi tē dridhej dhe e pushtoi njē panik dhe njē alarm. U hoq zvarrē prapa gēmushēs sē murrizit, pastaj pērgjatē gardhit qē tē conte te kasollja. Vranēn e zuri njē si shugullimē dhe e ndoqi me sy trupin e saj tek gjarpēronte lakuriq dhe s'dinte ku tē fshihej e tē mbulohej. Pastaj tek dera e kasolles ajo ndali. U ngrit nē kēmbē e kthyer nga ajo anē e qielilit ku kishte zbardhur drita dhe nisi tē hetojē krahēt, kēmbēt barkun dhe gjoksin e saj. Qe e gjitha e mbushur me bllana tē zeza balte, e ndotur dhe e bērē pis pēr tmerr.

**Hyri** nē kasolle dhe doli sē andejmi me kēmishēn e saj tē shqyer e tē ndotur dhe me **krahnoshēn** prej pēlhure qē qe mbushur edhe ajo plot me bllana tē zeza. I ndehu nē dritē dhe i pa mbarē e prapē njē copē herē. Pastaj, e kapur si nga njē nxitim i beftē dhe duke parē si e trembur majtas e djathtas, nisi t'i veshē ato rroba dhe t'i mbēshtjellē rrēth trupit. Tani dukej edhe mē e lakuriqtē, edhe mē e ndotur nēpēr atē dritē qumēsht e purpur qē vinte nga qielli. Domenika hyri pērsēri nē kasolle dhe doli mbas pak qē andej po lakuriq dhe me njē kanistēr nē kokē. Kishte vēnē atje dy leckat e saj dhe mori rrugēn e njē pērroi malor qē rridhte plot ujēra atje poshtē. Ecte me njē çap tē bukur e me naze sikur tē kishte veshur rroba tē shdritshme. Herē herē i jepte kokēs qē tē hidhte prapa njē tufē flokēsh tē dendur qē i zinin fytyrēn dhe buzēqeshte. Sikur i kishte harruar tē gjitha sa ngjanē. Kaloi pranē tij dhe mbajti kēmbēt.

- Po shkoj tē lahem njē çikē,- i tha me njē zē prej njeriu shumē tē afērt.- Shiko si jam bērē! Gjeta njē çikē bótē nē kasolle e do tē lahem.

I buzēqeshi gjithē ledhati dhe çapiti mē tej. Vranēs nuk iu duk aspak se asaj i kishte ikur mendja pērsēri. Atij iu bē se ajo donte ta hiqte njē çast e mē parē atē pisllēk nga shtati. Ai pa se si ajo hyri tek njē shteg me murrica dhe zbriti drejt njē pellgu ku binte uji nēpēr shkemb. Zot, nuk mund tē bēhej mē bukur se tē shihje njē grua si ajo qē zbriste nēpēr prralle dhe nēpēr dritēn qē hapej e hapej andej nga qielli i lindjes. Flokēt e gjatē e tē zes i zbrisnin deri tek beli, kurse kēmbēt, krahēt, qafēn dhe gjithçka i kishte tē

rrumbullkta, tē brishta dhe delikate si tē njē vajze tē parritur.

Kaloj shumē qēkurse Domenika zbriti nē pērrua. Edhe pak dhe mbi njē kurriz tē dhēmbēzuar malesh do tē dilte dielli. Vrana kishte qenē gjer nē atē çast si i mpirē dhe kishte ndenjur mbi njē gur me fytyrē nga pērroi, duke pritur qē ajo tē ngjitej pērsēri. Por kur shkrepi rrezja e parē e diellit dhe gjithçka shndriti nga vesa qē kishte rēnē, Vranēs iu duk rruga shumē e shkretē dhe shumē e shurdhēt pēr tē dēgjuar hapa qē viniñ andej. Iu duk ajo gurgullimē ujrash nē shtratin e pērroit sikur rridhte nēpēr njē botē tjeter dhe, nēn rrezet e diellit, shkēmbinjtē iu bēn tē kuq, tē smeraldtē dhe tē verdhē si pirgje squfuri. Pse s'po ngjitej Domenika, tha Vrana dhe nē çast e kuptoi se kishte qenē i marrē qē e kishte lēnē atē tē shkontakte vetēm nē buzēn e ujit. E hodhi setrēn dhe u sul nēpēr shtegun e shkēmbinjve qē binin nē njē gremisje dhe nē njē theqafē tē keqe. Pērroi ishte plot me ujēra dhe me gurē qē dilnin nē sipērfaqen e tij si dele qē kullosnin. Vrana vērviti shikimin qosh mē qosh e u hodh sa nē njē cep nē tjetrin, por kurrkund nuk ishte Domenika. I ēshtē sterrosur uji Vranēs atēherē dhe i ēshtē bērē se aty shkiste zift i shkrirē. Pastaj uji i ēshtē zbardhur dhe i ēshtē bērē si qumēsht. Pastaj e kanē ndjellur gurgullimat e thellukave dhe tē ujrave tē tij tē thella qē rendnin e pērplaseshin nēpēr brryla. Vrana e kishte ndjerē menjēherē se e keqja ishte bērē! Nē njē kēmbē shkēmbi dukej kanistra e rrobave tē saj, lēnē aty si tē vetmen shenjē tē qēnies sē saj. Nēpēr shkurre zbardhnin rrobat e lara sikur i kishin nderē

zanat. Vrana ēshtē sulur poshtē rrjedhēs, duke u vērvitur nga guri nē gur. Ka rendur gjithē atē ditē gjersa ka zbritur poshtē nē fushē dhe ka ndjekur rrjedhēn e pērroit derisa ai derdhej nē lumē dhe ka rendur pērgjatē bregut tē lomit derisa mbērriti nē shkēmbinjtē ku ujērat thyenin qafēn njēqind pashē poshtē. Nuk ka ndeshur kurrkund nē njē shenjē tē Domenikēs. Nuk e ka dalluar kund kurmin e saj tē bardhē tē mbuluar me dy rrecka tē qēndisura, me bllana tē errēta qē i kish shkaktuar ai nēn lēkurēn e shndritshme. Vrana nuk ka besuar se e ka humbur Domenikēn pērgjithmonē dhe ēshtē kthyer e i ēshtē ngjitur pērsēri lomit pērpjetē, ka mbērritur tek shtegu i maleve nga zbriste pērroi dhe atje i ēshtē qepur pērsēri shkēmbinje deri lart.

Kur ka zēnē tē bjerē nata, Vrana ēshtē pērbysur dhe ka qarē si kurrē ndonjēherē. Rihte kokēn dhe gjoksin me grushta, u thērriste qiellit dhē maleve, u lutej pērroit, hēnēs, pastaj... pastaj i ēshtē shfaqur Zonja Shēn Mēri, diku nē njē gur para tij, e bardhē dhe e heshtur, me fytyrēn dritē dhe me fytyrēn e butē prej nēne. Ajo ka qēndruar njē copē herē aty dhe pastaj ēshtē zhdukur. Vrana ka ndjerē se i ēshtē fikur shikimi dhe ēshtē pērplasur pērtokē.

- M'i fal, o Zonjē, mēkate! - ka mundur tē thotē Vrana para se tē humbē mendjen.

Por nē mesnatē, kur ēshtē zgjuar dhe ka hapur sytē, ka vēnē re se ishte i vetēm nē ato humbētira. Njē copē qielli qē dukej, ngjante si fikja e njē zjarri qē digej diku. Njē zē i ka ardhē Vranēs nē vesh e i ka thēnē se do tē vinte njē natē kur do tē zbriste pēr nē nulli tek

ai një mushkë nga shkëmbi i Shugjanit. Po tē vinte Domenika mbi tē, atëherë do tē bënte dasmën. Nëse mushka do tē vinte vetëm, atëherë ai duhej tē digje kishën e Shndusë dhe mbas kësaj do tē shkonte tek ai Domenika nëpër shkrumb dhe nëpër hi tē saj.

Vrana është habitur kaq shumë nga ky zë sa ka mbetur i shtangur. Ai ka dashur t'i lutej Zotit, por nuk ka mundur se i kanë mbetur fjalët në grykë.

## KAPITULLI I GJASHTË

...Vrana ndjeu nëpër kurriz tē dorës diçka tē ngrohtë që e lagu. Pastaj i theri me një dhembje tē mprehtë. E kishte kafshuar dhe e kishte bërë gjak. Iu kujtua se apo e kishte bërë këtë gjë, s'kishte veç një çast dhe ndjente se si i çuhej gjoksi nga angushtia që s'kishte qenë në vete.

Vrana doli tek lesa e mullirit dhe vështroi kalldrëmin përpjetë. I dhimbte i gjithë trupi. Sikur apo kish qenë me Domenikën, sikur gjithçka kishte ndodhur para pak çasteve. Si mbaronin shelgjet, kalldrëmi ngjitej nga e djathta nëpër një shteg. Nuk dukej edhe aq mirë fundi i tij, sepse po perëndonte hëna dhe mezi regëtinte një dritë e kuqërreme.

Vrana kishte dashur tē kthehej, tē futej në nulli, por në atë çast ishin dëgjuar përsëri çapat e mushkës. Vinin fare qartë tek rrëhnnin nëpër kalldrëm dhe tek kishin rrökullisur dy gurë që kishin shkuar e kishin rënë në përrua. Vrana kishte rendur drejt lesës së oborrit. Kishte kapërcyer vijën e ujit dhe kishte pritur me tmerr se çfarë do t'i shihnnin sytë. Oh! Qe shfaqur

mushka vetëm! E vogël me ca takëme të reja që i kërcisinin sipas ritmit të hapave dhe me ca sumballa të tunxhta, që lëshonin vezullimet të bruzta nëpër hënë. O Zot! - kishte thirrur dhe kishte rënë në gjunjë Vrana me kokën midis krahëve.

## KAPITULLI I SHTATË

Oh, e dogji, or të uruar! Ka qenë një flakë e madhe, e gjelbërt, që është dukur për tri net në kurritz të malit. Pastaj vendin e flakës e ka zënë një kollonë e bardhë tymi që ngjitej deri lart në qiell. Duhet të ketë qenë i ikur mendsh Vrana, sepse atë natë ka thyer e ka shkatërruar gjithçka që i ka zënë dora në mulli. Gurët e blojës janë gjetur të hequr vendit e të rrrokullisur në qoshet e murit. Mushkën që i dërgoi Bdeku e kishte çarë më dysh dhe katundarët e kishin marrë dhe e kishin groposur të nesërmen në zallishtet e përroit. Kurse vetë nuk ishte dukur më. As në mulli dhe as në katund. Kushedi ku humbi e kushedi ku shkoi.

Terr, o të bekuar, më e hidhur gjë s'kishte se si bëhej.

# LIBRI I GJASHTË

## KAPITULLI I PARË

Por nuk ishte djegur ikona. "Nuk është djegur", i tha një natë një zë munshinjur Agushtinit, mbyllur prej vitesh në manastirin e Shëndërtarit. Lajmi i djegies së Shndusë kishte qenë tronditës. E kishin djegur, i kishin thënë, e kishin përfshirë flakët për tri ditë e për tri net dhe tanë kishte mbetur atje vetëm një grumbull gurësh. Kurkush nuk shkonte më në Shndu, munshinjur Injaci, i trëmbur si nga një kob, kishte mbledhur plaçkat dhe kishte ikur.

Por nuk ishte djegur ikona. Kështu i pat pëshpëritur zëri munshinjur Agushtinit, tekxa ishte në kqollin e tij të ngujimit, atje në manastirin e Shëndërtarit. "E keni atje", i ishte bërë sikur i kishte thënë dikush dhe e kishte ndërmendur e ia kishte davaritur dëshpërimin, që dremitja ia bënte edhe më të hidhur.

## KAPITULLI I DYTË

Qe djegur edhe Shndreu. Kjo ishte edhe mē zi. Një muaj larg njëra tjetrës, rradhë mbas rradhe. Të shugullonte shpirti nga tmerri kur dëgjoje ato gjëma! C'po ndodhë ashtu?! Kishin zënë të merrnin edhe gurët atje, po çmbinin gjithçka dhe s'po mbetej asgjë. Veç nuk ishte djegur ikona. Këtë ia përsëdyti përsëri ai zë. "Nuk është djegur,- i tha". Ia tha jo nëpër natë si herën e parë kur qe djegur Shndoi, por ditën nëpër diell. Sikur kishte qenë prapa kurrizit të tij njeriu që i fliste, sikur dikush ishte brenda në kqoll bashkë me të. Kishte kthyer kokën dhe kishte parë andej këndeja. Jo, s'ishte kërkush. Ishte një shpirt dhe jo një njeri ai që i fliste! Munshinjur Agushtini vendosi ta lerë manastirin. Në Urbs! Kështu kishte thënë. Kishte vendosur të shkonte së pari në atë qytet, të shihej me Bdekun njëherë, pastaj të ngjitej në krahinë.

## KAPITULLI I TRETË

Nuk e kishte ditur se si e pat hequr zemra ashtu dhe nuk kishte ndjerë kurrfarë ngurrimi që ta bënte atë rrugë.

Kur kishte dalë nga kqollet e manastirit, i kishte ndjerë gjunjët që nuk e mbanin dhe trupin që i dridhej. Ishte ligur e bërë kockë e lëkurë ai dhe mezi mbahej në këmbë, por do të shkonte në Urbs dhe pastaj në Karmelje. Shpirti s'i rreshte së rënkuari. Oh, si ishin djegur ashtu ato kisha? Në fillim Shndou, pastaj Shndreu!

## KAPITULLI I KATËRT

I ishte dashur ta çante mes për mes gjer në Urbs gjithë Llauzinë që zbardhët nga faltoret e Bojrogut. Ato sa vinin e u afroheshin maleve. Të gëlqerta dhe me një hovje të vrullshme drejt qiellit, ato i shfaqeshin herë në udhëkryqe e herë në rrahe të thata kodrash. Disa kishin qenë kisha dikur, por ishin bërë tjetërsoj tanë dhe nuk njiheshin më. Nëpër sy i ngatérroheshin pamjet e katundeve të vjetër plot rrënoja e ngrehina të hershme. Si nëpër një farefisni të lashtë i bëhej sikur ecte, si përmes njerëzve që kishin qenë të një gjaku dikur, por që qenë ndarë e qenë bërë të panjohur tanë.

Jo vetëm të panjohur, kishte thënë Agushtini me vete, por qenë bërë edhe armiq. E kishin kallzuar tek njerëzit e Bojrogut. Ja, një shkarrakan e halaraq vendas i atyre anëve. Kishte rendur ai tek kastigatorët e Bojrogut dhe u kishte kallzuar për të. Ishte koha kur zonja Hura kishte qenë në Urbs dhe Bojrogu kishte vënë roje që të ruanin në të gjitha rrugët. “Ruani”, kishte thënë, “i ruani ata gjaurë se mos zbresin dhe na bëjnë trazira!”. Agushtin i truari, që bënte jetën e eremitit mal më mal, kishte kaluar një ditë ngjitur me kastigatorët, por ata nuk e kishin parë. I keqoti dhe çomagani vendas u kish shkuar dhe u kish thënë se a e kishin ditur se cili u pat kaluar pranë dhe ata nuk e kishin vënë re? Kastigatorët kishin qëlluar të përgjumur, por kallzimtari s'mund ta linte rastin t'i ikte nga dora. I kishte mprehur fjalët edhe më shumë dhe, pa e rrështur vrullin dhe ngazëllimin, u kishte thënë se po ta dinin mirë se cili qe ai, atëherë

ata do tē rendnin dhe do ta kapnin menjēherē. Por mē parē, u kishte thēnē, duhej t'i jepnin dhjetē pare sermi, dhjetē kapkashē qē tē blinte ca dele si dhe njē leje qē tē lēvizte lirshēm nēpēr roje. Si e kishin ujdisur pazarin, kishte kallzuar e kishte thēnē se njeriu qē lēvrinte nē fshehtēsi ishte munshinjur Agushtini. Prifti, i kishte mēshuar zērit pastaj si pēr t'u thēnē se nga ai vinin tē gjitha rreziqet. Ata patēn hovur pērjetē dhe patēn mbērthyer armēt. U qenē ndezur xanxat tē kapnin njē armik tē Bojrogut dhe kishin kthyer kēmbēt e kuajve duke e ndjekur. E kishin mbrritur nē njē pllajē mes njē gomrade me fije bari tē thatē, e kishin qarkuar nga tē katēr anēt, por u pat rēnē vrulli sakaq kur kishin parē qē ai mezi rrinte nē kēmbē dhe qe kockē e lēkurē. Ishte ndonjē i lajthitur mesa duket, njē eremit qē s'qe i zoti as pēr veten e tij. Zhgunin s'dihej nē sa ferra e nē sa shkurre e kishte grisur, nē kēmbē mbante njē palē sandale tē lidhura me gjalmē, ndērsa mjekrra e rrallē i qe larushuar nga thinjat. "Ç'je?", e kishte pyetur me neveri njēri nga kastigatorēt, por mē kot. Agushtin i truari s'kishte pēr ta hapur gojēn. Ai i shikonte vetullngrysur dhe kushedi nē ç'anē kishte humbur mendja e tij. "Ky ēshtē hutē,- u kishte thēnē shkokēve ai qē e kishte pyetur.- Lemequer". Qenē nxehur e patēn bērtitur kundēr njeriut qē i kish lēshuar mbas atij hafifi, por inatin ia nxorrēn Agushtinit. I ishin futur me shkelma nēpēr bark e nēpēr ije, pastaj e kishin shtyrē dhe e kishin hedhur pērdhé. I qenē futur me kamzhik dhe e patēn rrahuur gjersa ia kishin jeshilosur dhe ia kishin nxirrē shikimin. Bdeku i dērgonte fjalē mbas ca

kohēsh dhe i thoshte se kur ta kapnin sērish kastigatorēt, tē mos e mbante gojēn kyçur, por tē thoshte se ish i vällai i tij. Kēshtu nuk do ta ngisnin mē, i thoshte Bdeku, dhe mund t'i jepnin edhe njē leje qē tē lēvizte lirisht. Hm, Bdeku!

## KAPITULLI I PESTË

Kishte mbērritur nē Urbs dhe e kishte trullosur qē nē krye zhurma qē bēnin çekiçēt e bakrakhinjve dhe kopanēt e destilave. Mbi qiparisēt e Adi Khanit ngriheshin e fluturonin tufa sor rash tē zeza. O Zot, kishte thēnē si me frikē munshinjur Agushtini. S'kishte parē kurrē tufa tē tillā qē krakaritnin e fluturonin si tē llahtarisura! E ç'ishte Bdeku nē gjithē atē lēvizje? Erdh e iu zvogēlua e iu mjerua figura e tij dhe po thoshte se ai ishte vetēm njē horr e njē fundērrinē e asgjē tjetēr. Kēshtu po hiqte njē tē hidhur nēpēr shpirt munshinjur Agushtini, qē njeriu humbet e bēhet njē krimb. Por tek portat e Adi Khanit gjithçka iu sērēndit pēr sē pari. Pērsēri Bdeku iu bē ai qē ishte. Ishte shumē e zorshme tē piqeshe me tē, rojet e kishin mbajtur gysēm dite tek hyrja. Shkonin e vinin dhe asnjeri nuk i khente ndonjē pērgjigje. As se ishte, as se nuk ishte, as se e priste dhe as se nuk e priste. E shikonin vēngēr, por s'kishin se ç'i bēnin mesa dukej, sepse kishin marrē vesh se qe vällai i Bdeku.

Kur qe ngrysur, Bdeku kishte dalē vetē. Kishte pērshkuar kalldrēmet pērmes rojeve dhe kishte ndalur pērpara tij. Njē habi e qortim kanosēs i lexohej

nēpēr sy tek i afrohej. Nuk ia kishte dhēnē dorēn, por e kishte pyetur qē larg e i kishte thēnē se çfarē kishte dashur qē kishte ardhur deri aty? Pastaj, pa marrē ndonjē pērgjigje, kishte bērē pērpara. Zbriste drejt qytetit dhe Agushtini e ndiqte nga pas. Dikur qenē futur nē njē si kafene a nē njē si vrimē tē shērbetosur me gēlqere e tē shtruar me mindere. Aty ishin ulur. I zoti, njē ezmer e korozi, i priti me nderime tē mēdha dhe tund e shkund peshqirin mbi shiltetē ku do tē uleshin. Se si qe bērē Bdeku tani mbas kaq vjetēsh pa u parē, sikur i qe jeshilosur syri e qe bērē tjetēr njeri. Mishrat i kishin gufuar dhe i vareshin lapra, nuk ngjanin mē. Zor se mund t'i dalloje dot tiparet e tyre aq tē ngjashme dikur. Agushtini e pat kqyrur kēshtu hetueshēm pēr disa çaste, ndērsa Bdekut i ishte çelur njē tallje nēpēr buzē. Ia kishte kuptuar ardhjen dhe i kishte dalē nē shteg mē pērpara se ai tē hapte gojē. "Mos do qē tē ma bēsh si zonja Hura?", i kishte thēnē. Mos kishte ardh edhe ai me ndonjē ndjellakeq nē zemēr dhe a mos vallē kishte ndonjē shybe pēr djegien e atyre kishave? "Dukesh qē nē surrat se pēr kētē ke ardh,- i kishte çfryrē, "por ruhu e mos mē bjer nē qafē me ato dyshime nēse nuk ke qejf tē ta rrjep lēkurēn!". Sepse mjaft nē qafē i kishte rēnē ajo zonja Hura, qē qe ngritur nga shtēpia e atēnisē pēr tē çmēndur Adi Khanin. "Ju i keni djegur vetē ato kisha,- i ishte ngjirur me tērbim,- ti!". Ato kisha i kishin djegur vetē, i thoshte Bdeku, ja, vetē ai, Agushtini me njerëzit e tij! Ja, me atē Vranēn, kanakarin e tij qē ia kishte varur çelēsat e Shndusē nē qafē! I kishin djegur nga inati qē kishte ardh

famullitar Injaci dhe u kishte zēnē vendin! Kurse tani, i thoshte, vinte dhe mallkonte atē! "Por mjaft me kēto mallkime, mor satanā,- i qe sulur Bdeku.- Mjaft me atē shpirtin tēnd qē tē shtyn tē vērtitesh nēpēr male se nuk gjen rehat nga mēkatet qē ke bērē!".

O Zot, çfarē po i thoshte! Munshinjur Agushtini nuk po mundej ta mblidhте veten dot. Nē mendjen e tij po dyndej njē mjegull. Ishte vetē ai fajtori dhe Juda, sipas Bdekut! I kishte djegur ai ato kisha! Ah, or Bdek, sa para bēn tē tē them cili je!

## KAPITULLI I GJASHTË

Dy ditē qē po kapērcente grykat dhe kur kish dalē mbi Hydēr tē Hyllit, kur kish parē shtēpitē e para tē atij katundi, gjunjēt e kishin lēshuar nē tokē. Qe ulur nē gurēt e njē murane qē digjej nē diell. Sikur askush nuk e qaste e nuk e priste nē ato anē. As edhe njē shkrrofak. As edhe ai shpend i madh e bojhiri qē kishte qenē aty pranē nē njē shkemb e po mprihite sqepin. Si kishte parē qē munshinjur Agushtini qe ulur tek murana, shkrrofaku kishte lēshuar njē krrakitje tē egēr. I qenē skuqur sytē nga zemērimi dhe puplat i qenē pērqethur valē valē. Pastaj kishte pērplasur krahēt dhe kishte ikur.

## KAPITULLI I SHTATE

Munshinjur Agushtini kishte marrē rrugēn pēr nē Kep. Ishte njē katund ngjitur me Hydrēn e Hyllit, njē shpērdhak matanē ca humnerave tē kaltra malesh.

Nē Hydēr tē Hyllit s'kishte mundur tē hynte dot pēr shkak tē qenve. Ata ishin njē lukuni e tērē qē silleshin qark shtēpive. Sapo ndjenin erē njeriu, lēshoheshin me turmē, duke e mbushur dheun me lehje tē frikshme. Haheshin e shqyheshin me njéri tjetrin, diku mblidheshin tufē e diku ndaheshin anekēnd katundit. Kurse rrugēt ishin tē shkreta dhe s'gjeje kēnd tē tē fuste brenda. Kēshtu qē munshinjur Agushtini e kish çuar natēn nē pyll i mbēshjellē nē zhgunin e tij dhe tē nesērmen, me tē rēnē drita, kishte marrē rrugēn pēr mes njē rrahu qē kaltēronte nga gjēmbaçēt. Poshtē ishte njē zabel me drurē tē lartē e gjethiemēt, i mbledhur e i gdhēndur plot harqe kurorash tē gjelbra qē hidheshin njéra mbi tjetrēn.

Nga ato hije kishte dalē njē grua bashkē me dy mushka, me dy kafshē barre ku kish ngarkuar bulierē dhe vedra qumēshki. Ngjitej pēr nē stane. Ishte e veshur me plaçka mēndafshi, nga ato qē vinin nga Urbsi. Ca si çatjakē tē shndritshēm, ca si polka me gjymrysh si tē grave nē Adi Khan. Do tē qe ndonjē nuse, kishte thēnē me mend munshinjur Agushtini, ndonjē qē i qe ujdisur burrit dhe po i shkontakte me atē çap tē lehtē. Por si kishin mbērritur ato veshje gjer aty? Sikur s'ishe nē Hydēr tē Hyllit, por nē Urbs, nē katudet e Llauzisē, atje nē brigjet e lumit tē fushēs.

"Si je, o bijē- i thirri nuses kur ajo i kaloi pranē.- Si tē quajnē?". Nusja pushtoi fytyrēn me shami tē kokēs, por zērin s'e fashiti. Iu pērgjegj me njē gaz tē bukur prej tē reje, veç munshinjur Agushtini nuk e mori vesh se si ia tha emrin. Si Mari a si Hyri, sikur i tha, tek u foli mushkave dhe tek kaptoi pastaj prapa njē

kthese. Kēmbēt e saj tē reja e kishin çuar larg bashkē me mushkat, kēshu qē munshinjur Agushtini nuk mundi ta pyesē mē.

## KAPITULLI I TETË

Por nuk tregohej dot dëshpërimi i tij, kur mbërriti nē kishën e Shndusë. Tē merrte tē qarët kur shihje trollin e saj tē nxirrē nga zjarri. Muret qenē shëmbur dhe qenē bërë gropa gropa, sikur t'i kishin gjuajtur me gjyle. Kambarja i kishte mbetur përgjysëm, sepse i qenē djegur brezat e drurit dhe ishte lëshuar përdhé. Zot, ç'kishte qenē ai zjarr, ç'kishte qenē ai tym?!

## KAPITULLI I NËNTË

Nē katund e gjeti mē e madhja: nuk kishin dashur ta linin tē hynte. E kishin pritur anës rrugës tre vetë, ca qimeçilë e zhalakanë, që dukej sikur rrinin mē kot mbi një prig gurësh. Kur u kishte kaluar pranë, njëri nga ata ishte ngritur dhe i kishte dalë para. “Ç'do ti këtu?”, i kishte thënë. Munshinjur Agushtini qe habitur dhe pat ruajtur se mos tjetri ia kishte me shaka, por ai e kishte kërcënuar dhe i kishte thënë qē tē kthehej dhe tē thyente qafën. Tē zhdukej, nē mos ia kishte qejfi t'i hynte me një dru dhe ta bënte përvdekje. E kishte kërcënuar si t'i fliste një hasmi, një tē keqoti qē vinte me mendje tē ligë nē katund.

Por e shpëtoi zonja Hura. Ajo e kishte parë qē nga çardaku i shtëpisë së atënisë dhe po vinte si një patë,

duke lëshuar fryshten gulçe gulçe. E kishte lëshuar thirrmën që atje tej, bërtiste që ta dëgjonin dhe nga kopshtijet njerëzia nisi tē lërë punën e tē vijë drejt saj. Ata tē tre s'e deshën veten që duhej tē kapërcenin mezhdën e anërrugës dhe tē iknin. Zonja Hura e mbështolli Agushtinin e lënë nē mes tē pluhurit si një fëmijë nē krahët e veta dhe e çoi nē shtëpi. E uli nē një kënd tē çardakut dhe i vuri para një kupac me qumësht. Pastaj i tha: "Sherri". Munshinjur Agushtini nuk e mori vesh dhe zonja Hura përsëriti e tha: "Na është futur sherri".

Munshinjur Agushtini po e kqyrrte i kërrusur nga keqardhja dhe dëshpërimi. Qe plakur shumë Hura e shkretë dhe fytyra i dukej tjetër. Si e mufatur, e errët dhe pa drithë, e fishkur dhe njolla njolla. Ndoshta nga lotët, tha ai. Kishte kohë që qante, këtë e kishte marrë vesh dhe e kishte ditur që atje nē manastir tē Shëndërtarit. "Qan?", e pyeti, por plaka kishte vazhduar tē sajën: "Sikur duan tē na shkulin", i kishte thënë dhe kishte fryrë hundët nga lotët që po i vinin.

Sa pa mbaruar ato fjalë, vërvshëlljen gurë mbi kulmoren e çardakut dhe mbi çatinë e lartë me pllaka dërrase. Gurët ranë si breshër mbi shtëpi dhe kërcitën aq fort sa ia drodhën zemrën Agushtinit. Oborri u mbush me kakarisjet e pulave dhe me fluturimet e tyre tē trembura. O Zot, ç'ishte ashtu?! Sikur binte tërmet! Munshinjur Agushtini pa se poplat i hidhnin me hobë ata tre tē rrugës që kishin hipur mbi një sop. Zonja Hura çoi duart përpjetë me gishtërinj tē hapur si gaforre dhe nisi t'i thërrasë katundit: "O, a ndini bre, po na vrasin!". Sakaq njerëzit vinin me nxit

me hobé edhe ata e me popla gurēsh nēpēr trasta. Nisén tē gjuajnē me zaje tē bardhē qē fluturonin si zogj e pērplaseshin mbas tokēs me rrapēllimē. Ata tre cilamanēt shanin e thërrisin, ndërsa u ruheshin gurëve qē u hidheshin qē këtej. Puna u mais keq dhe dikush nga tē katundit ia pat njërit prej atyre tē treve me një sermalije qē e kishte blere nē Kotorret e reja. Plagēn e mori nē sup dhe shokēt e ngritēn nē krahë dhe ikēn. Iu ngjitēn shtegut nga ana e Gurit tē Shugjanit; bërritnin e kërcënnonin, çirtnin e ngjirnin zérin. Pastaj gjithçka heshti dhe zonja Hura, bërë limon nga tronditja, lëvizi nga vendi dhe iu kthy Agushtinit. I tha se sherradreqērit ishin nga Vau i Shalës, vinin pērherë dhe dhunonin kryqet. Kishin qenē tē krishterë dikur siç e dinte, por tanu u kishte hyrē djalli dhe vinin e trazonin njerëzit. Shndou vërtet u dogj, i tha zonja Hura, por kamabanaren kishin qenē ata qē e kishin hedhur përtokë. Munshinjur Agushtini bëri kryqin dhe tha: “Zoti i faltē se nuk dinē se ç’bëjnē”.

## KAPITULLI I DHJETË

“S’kemi mundur ta nxjerrim Zonjēn”, tha zonja Hura si qe larguar ai sherr e si kishte mbetur vetēm me Agushtinin. I qe mufatur fytyra edhe mē, gjymtyrët ia kishte zēnē një si drithërimē dhe e mekte zérin sa tē thoje se ato fjalē s’duhet t’i dëgjonte kërkush. “S’kemi mundur”, përsëriti. Munshinjur Agushtini s’po kuptonte se ku e kishte fjalën, por qe befasuar shumē nga mënyra se si po ia thoshte. “Tē

**Lumnuemen**”, kishte shtuar zonja Hura, ndërsa munshinjur Agushtini e kqyrte ngultazi dhe trikte qepallat.

Zonja Hura u bë flakë nga gjaku që i vërshoi në fytyrë. Sytë se si iu mbushën si me dritë të gjelbër dhe tundi kokën e tha me vrull: “Jo!”. Jo, përsëriti me mjekrën që iu drodh dhe shkoi tek dritarja e hapi kanatat. Matanë ndritën kopshtijet nëpër diell dhe më tej akoma kurrizet e maleve nëpër re. “E kemi atje”, i tha zonja Hura munshinjur Agushtinit, që kishte mbetur si i pafrymë. “Cilën?!” , pyeti ky gjithë ankth e çudi. “Të Lumnuemen, ikonën”. Munshinjur Agushtini nuk po e mblidhët dot veten. Çfarë, po i thoshte të njëjtën gjë që i kishte thënë edhe ai zë atje në manastirin e Shëndërtarit?! “Është e vërtetë që nuk është djegur ikona?”, e pyeti Agushtini me gjoksin që po i shkallmohej nga rrahjet e zemrës. “Jo”, mohoi zonja Hura me fytyrë të lumturuar dhe me shkrepëtimë gazi e drite nëpër sy. Tundte kokën sikur të thoshte: “Jo, kurrsesi” përsëriti dhe po gërmuqej e po bëhej një grusht si të donte të hynte në hijen e një të fshehte që donte t’ia thoshte. “Ja,- tha me shugullimë dhe e bërë një dorë njeri.- Është atje, në një shpellë, në një guvë që Zoti e ka bërë si një kishë”. Ajo i tregoi me dorën që i dridhej një varg malesh të zhveshur, ca thelluka luginash me pyje të errët dhe me humnra rresht që binin poshtë si një katarakt ngjyrë opali. Zëri i zonjës Hura se si u zbut e u ëmbëlsua dhe nisi t’ia tregojë të gjitha të fshehtat që dinte. Munshinjur Agushtinit iu ndezën nëpër sy turma besimtarësh që shkonin në atë shpellë dhe

luteshin pērpara Zonjēs. Mbushej dheu me njē mērmērimē qē ngrihej drejt qiellit, me dička qē ta shlodhte dhe ta prehte shpirtin. Ajo s'rreshsstte sē treguari pēr mesha e pēr krezmime, pēr emra e pēr ditē tē shēnuara, pēr shenjtorē e pēr blatime ndaj Zöt. Dinte njē pēr njē ngjyrat e gurēve tek ajo shpellē atje lart, vendin ku mbahej vaji i shenjtē, pllakēn ku ndizeshin qirinjtē, njeriuq qē shērbente mbas ikjes sē munshinjur Injacit, tē gjitha. Ja, kur tē shkonin atē natē, se do tē shkonin patjetēr sa tē errej atje tek kisha e Zöt, i kish thēnē zonja Hura, pra, kur tē shkonin atē natē, ai do tē shihte se sa e bukur dhe plot dritē qē qe. Por do tē shkonin natēn, do ta merrnin rrugēn nēpēr terr qē tē mos i shihnin kastigatorēt e Bojrogut. Ata kishin mbērrtitur deri nē kēto anē dhe nuk duhej ta zbulonin se ku ishte kisha.

Zonja Hura nxorri plaçkat e reja dhe i veshi qē pa rēnē ende dielli. Do tē merrnin njē rrugē tinēz, grykēs sē pērroit. Kur ra nata, e nxorri Agushtinin prapa kopshteve dhe iu futēn njē trage pērgjatē zallishtes. Hiqte udhē pērpara, por mezi i hidhete kēmbēt kērçopane dhe mezi mbushej me frysē. “O Zot, a do tē arrinin ndonjēherē? - tha munshinjur Agushtini.-A do tē mundej tē ngjitej nēpēr ato kurrize tē thepisura ajo e shkretē?”.

## KAPITULLI I NJËMBËDHJETË

Kishin zēnē tē frysniq flladet e pasmesnatēs dhe hēna po perēndonte prapa maleve, kur ata kishin dalē nē njē luginē tē qarkuar me shkēmbej tē bardhē.

Zonja Hura s'rrreshitte sē hequri rrugē, ndonëse e përkultur mē dysh dhe gati tē rrëzohej. Një si fershëllimë frëngjuze i çuhej nëpër fyt dhe frynte e shfrynte si gjyryk me gjithë mushkritë. Veç nuk ndalej, nuk jepte e nuk merrte për asgjë tanë. Edhe munshinjur Agushtini qe këputur krejt. I kërcisnin kyçet e këmbëve dhe koka i buçiste nga gjaku.

Papritmas, zonja Hura ndali. E kërrusur mē dysh dhe duke treguar nga gryka e një shpelle tha: "Ja, këtu!". Munshinjur Agushtini vështroi. Pastaj bëri përpara dhe i doli grykës nga një anë nga ngjitej më kollaj. Po ç'ishte ajo grykë ashtu? As që dukej se pat shkelur këmbë njeriu ndonjëherë. "Zonja Hura,- i thirri munshinjur Agushtini me një si ngashërim nëpër zë.- A kjo është?!". "Ajo" ia ktheu zonja Hura. Por tanë e tkurrur dhe e mugur sikur t'i qe shuar diçka në shpirt. "Ajo", përsëriti. Munshinjur Agushtini zgjati kokën, po aty s'kishte kurrfarë hyrjeje. Hapej vetëm një humnerë e zezë dhe vinin së brendshmi rryma ajri tē lagësht. Nuk kish se ku shkelej më tej, por ai s'donte ta besonte se e gjitha kjo kishte qenë një shkrepëtitje në kokë tē plakës. "A kjo?", i thirri me një zë si nëpër tē qarë. "Ajo,- tha zonja Hura nëpër atë tē fiktit e tē përhumburit e vet.- Hyr!". Ai foli dhe e pyeti edhe për diçka tjetër, as vetë nuk diti se për çfarë, por priti më kot përgjigjen e saj. Zonja Hura qe ulur pranë një dëllënje dhe qe kërrusur mbi prehërin e vet. Agushtini i shkoi ngjatë, pastaj e preku në sup dhe i thirri: "Zonja Hura!". I thirri përsëri, por plaka qe varur e tëra përpara dhe dronte se mos i shihte fytyrën. Kishte bëre një faj, sikur ishte një

gocē e vogēl qē s'di se ç'pērgjigje tē japē. Ishte e qartē, e kishin bērē mē kot atē rrugē, aty as shpellē, as kishē dhe asgjē nuk ishte. Munshinjur Agushtini kērkoi qē t'ia lehtēsonte barrēn; s'mund t'ia bēnte aq tē madhe sē shkretēs qē qe robētuar pēr tē ardhē gjer aty. I tha se a mos kishin ngatērruar rrugē e se a mos duhej tē shkonin nē ndonjē vend tjetēr? Por ajo ishte bērē kryeneće. I kishte varur buzēt, kokēn e mbante tē rrēzuar mbi prehēr dhe as jepte e as merrte mē.

## KAPITULLI I DYMBËDHJETË

Por, o Zot! Kishte qenē e vērtetē ajo qē i kishte thēnē zonja Hura! I kishte thēnē tē vērtetēn ai zē qē i kishte pērshpēritur atje tek kqollet e manastirit tē Shēndērtarit. Ikona nuk ishte djegur, ikonēn duhej ta kērkonin nēpēr ato shpella si nēpēr thellēsítē e shpirtērave tē tyre. Njē ndjanatē me diell tē vakēt malesh, munshinjur Agushtini bashkē me zonjēn Hura rrinin nēn hijen e njē ahu pēr t'u shplodhur. Po merrnin veten nga gjithē ai mundim raskapitēs dhe po heshtin. Tamam-tamam edhe nuk e dinin se si kishin mbērritur gjer aty. Sikur kishin kaluar natēn nēn atē rrāp tē vdekur nē gjumē, sikur kishin zbritur nga ca burime me ujē tē akullt ku kishin shkuar tē shuanin etjen, sikur qenē ngjitur pērmes ca gjembaçēve tē kaltēr si nēpēr rrāhet qē tē çonin nē kishēn e Shndusē. Nuk e dinin edhe shumē mirē kētē gjē nga shkaku se sikur e kishin kokēn tē rēnduar nga gjumi, sikur ajo u qe trallisur nga lodhja e nga vapa. Por po rrinin nēn atē rrāp, ka tē ngjarē nēn

hijen qē lēshon dielli i mēngjesit, por edhe i pasdites..., po, po, i pasdites, sepse ishte vakēt dhe ajri qe mbushur me zhuallimēn e ca insekteve tē çuditshēm. Zonja Hura dukej si nēna e botēs, si krijuesja e asaj qē po kqyrte tani me ca sy tē picēruar dhe po habitej se sa shumē traga rrugēsh ishin anekēnd tē formuara nga lēvizja e njerēzve, e kafshēve, e shpendēve dhe e insekteve. Tamam tamam zonja Hura nuk e dinte mirē se çfarē po mendonte dhe çfarē po thoshte ashtu, sepse i digjinin sytē nga lodhja dhe i shugullonte trupi ngaqē e kishin lēnē fuqitē. Kurse Agushtini, ky Moisi me mjekēr tē bardhē dhe leshra krela krela, ky Shēn Johan me njē zhgun tē kuqērremtē bērē fērtele nēpēr shkurre, kishte kthyer kokēn nga ca gardhiqe trēndafilash tē egēr dhe po shikonte tej njē pylli tē nxirē nga hijet e tē shndritur nga dielli dhe po dēgjonte se si binin zilet e njē mushke. Jo zile mushke, po cēritje zogjsh tē vegjēl nē njē çerdhe, ca si bulkthe e karkalecē tē kuq qē kēndonin nēpēr ferra e nēpēr barēra, ca tik-tike qē sa mezi binin tē thoje, qē sa mezi i lēviznin ato gjuhēzat e vogla nēn guackat e bronxta, por qē dēgjoheshin aq larg, ndoshta nga heshtja, ndoshta nga ajo mugia e maleve nēn dritēn qē mpakej, ose ngaqē pyjet, tani qē rrēzohej dielli, sikur merrmin tē thonin ndonjē gjē me shushurimēn e fletēve, por s'mundeshin. Gjēra tē tilla po dēgjonte munshinjur Agushtini dhe priti gjersa mushka u shfaq me njē burrē qē i vinte prapa atje nē ca shkarrēzima argjili, ku hapnin vrīma peligorgat, ku kēta zogj me tē gjitha ngjyrat qē ka toka dilnin qē andej dhe silleshin nēpēr

qiellin e mbrëmjes një copë herë, silleshin një grimë kohë para se të ktheheshin përsëri dhe të futeshin nëpër vrimat e tyre të errëta. Po vinte një plak me mushkën pérpara, iu bë Agushtinit dhe tha se do të qe shumë i moshuar ai nga sa dukej, do të qe tepër plak, siç shihej nga koka krejt e bardhë, por ngjante edhe si i ri, si një riosh i thinjur para kohe; ecte me çap të shkathët dhe vërtiste kokën majtas e djathtas si të rrakte me sy prej qifti gjithçka që kishte pranë. Ai e ngjiti mushkën drejt ahut ku rrinte Agushtini dhe zonja Hura, e voziti si një lundër përmes një gjëmbaqi të kaltër dhe si i rrahu qafën që të qëndronte, si e hoqi mënjanë dhe i tha që të këpuste ndonjë gojë gjëmbaq, iu drejtua Agushtinit si një të njoħuri tē vjetër dhe i thirri: "Agushtin!". Çudi, përse duhej t'i thërriste ashtu, ç'kuptim kishte? Ç'gjë tē gëzuar do t'i kumtonte që brriste si një cjak me zë tē hollë e tē lartë? Agushtin! Ç'ishte kjo thirrmë që shkoi gjer tek gomradat nē buzë tē pyllit dhe atje rrëshqiti më tej, përmes aheve e përmes vgjeve derisa arriti nē faqet e një shkëmbi dhe u kthyе sakaq përsëri, duke e dyzuar e duke e trizuar emrin e tij. "E dija që ishe këtej bashkë me zonjën Hura,- i thirri burri me atë zë tē lartë.- Prandaj edhe kam ardh që tē marr". Munshinjur Agushtini nuk po mundej tē përqëndrohej, nuk po mundej ta fuste nē beben e syrit këtë njeri që kishte një palë dhëmbë tē fortë e tē bardhë dhe ishte aq nē qejf, dhe ishte aq i gëzuar, sa e quante veten mik e shkuar mikut me tē. "Kam ardh tē marr për tē më kunguar fëmijët,- i thirri ai. - Kam dy nuse këtu lart nē stanet që më pollën!.. Pa

shih, prandaj i ndriste syri ashtu, prandaj pëlliste me atë zë si krriç gomari? "T'i faltë Zoti", ia ktheu Agushtini që sikur u çlodh e u gëzua edhe ai. Nuk i doli ta shpreh gëzimin e vet duke i thënë krriç, prandaj i skërmitti dhëmbët dhe i palosi buzët si të cjaspit. "Të t'i faltë Zoti", i përsëriti përmes atij gazi, që, ngaqë qe shumë i beftë, i dilte i shtrëmbët e si përmes ngërçit.

Kurse zonja Hura, ndërsa burrat po flisnin kështu, qe hutuar mbas zileve që kishte mushka në qafë. Ishin të vogla, të shndritshme, si të bëra në Urbs, thurrur në kollane që ua vinin mushkave kur merrnin nuse. Se si po i bëhej shpirti rricë plakës dhe po i ngjitej të qarët. Kishte qënë ai Vrana që ia kishte prurë një natë një mushkë karrane me zile si kjo, ia kishte futur në oborrin e shtëpisë së atënisë dhe i kishte rënë derës sikur do t'ia shkallmonte. Zonja Hura me një sarafan deri poshtë te këmbët, kishte dalë dhe kishte parë Vranën që sikur nxirrte shkumë dhe që sikur thyente dërrasat e çardakut ngaqë dridhej si purtekë. I kishte kërkuar Domenikën. "Ka ardhë dhe ka zbritur këtu, - i kishte thirrur. Nxirrma se gur s'kam pér t'i lënë kësaj shtëpie! Nxirre se aty do ta kesh, nxirre se të ka ardhur me këtë mushkë moj shtrigë dhe ti e ke fshehur dhe ia ke kthyer mendjen që të mos vijë tek unë". Ai ia kishte kthyer shtëpinë përbys, ia kishte bërë lesh e li, gjer edhe nëpër hatullat e çatisë kish kërkuar, brenda në oxhak e poshtë në bordrum. Pastaj me sy të hardallosur e duke shfryrë si një buall i kish çarë e i kish ndarë më dysh shtrojet e velenxat, i kish grisur e i kish bërë fërtete dhe kërkonte e

kërkonte se mos gjëkundi qe fshehur Domenika. Pastaj i kish thyer dyert e kqolleve dhe i kishte përbysur kadet e grurit dhe të miellit. Kur kishte zbritur shkallët që të thyente qafën e të ikte, zonja Hura kish parë se si lëkundeshin parmakët bashkë me çardakun dhe lëshonin një si bubullimë që të llahtariste. Në oborr e kishte ngritur në krahë dhe e kishte kthyer me kokë nga porta mushkën karrane. I qe futur me shqelma që ta bënte të ecte dhe i pat bérë copë kanatet e portës kur kishte dalë e kishte kaptuar matanë. Zonjës Hura i kishte mbetur në sy ajo tufë zilesh që vezullonin tekxa Vrana shqelmonte mushkën nën një dritë hënë atje në oborr dhe i kishte mbetur në vesh tringëllima e tyre që se ç'binin ashtu me diçka që të këpuste shpirtin. Ato sikur qanin si një tufë zérash të pérzier, frynin e shfrynin. Dëgjohej edhe rënktimi i shpirtit të Vranës, që frynte e shfrynte dhe zhuallima e zileve që ngrihej e ulej tallaz-tallaz. Ku po shkonte ai ashtu nëpër atë dritë hënë dhe nëpër shtegun e Gurit të Shugjanit gjithmonë e më përpjetë malit? Pastaj diku pat ndalë dhe qe kthyer përsëri poshtë. Zilet rendnin me têrsëllimë, ndihej shqelmi i Vranës që sillte nëpër vithe të mushkës dhe kafsha kish marrë dhenë e zilet sikur fluturonin në erë me cërr cërr e tring tring sa të thoje se kishin shpirt e ankoheshin e qanin ashtu. Atje në oborr të mullirit qe bérë batërdia. Dëgjohej që larg rënktimi i Vranës dhe gurët e cifundet që përbyseshin. Pastaj një têrsëllimë me kosë ferre, me të cilën Vrana e kishte çarë më dysh mushkën e shkretë. Zonjës Hura i bëhej sikur shihte syrin e pajetë të kafshës që ja se ç'e kishte

gjetur ashtu, syrin e saj tē çuditur e plot ankesē qē qe pahitur me njē dritē tē kuqērremtē tē hēnēs qē perēndonte.

Zonja Hura psherētiu, por i ardhuri me mushkē, ai burrē qē kishte zbritur nga stanet, iu kthyē dhe i tha qē tē mos psherētinte. Pse psherētin moj fisnike, i kishte thēnē me buzēn nē gaz, por edhe me shenjēn e njē keqardhjeje e njē qortimi qē i dridheshin atje. Unē sot kam gēzim, moj tatē, mē kanē lindur dy ferishte dhe Zoti deshi qē t'u gjeja tē m'i kungoni. Ecni edhe ngrihuni, pejani mbas meje se jemi mes dritēs sē Zotit.

Munshinjur Agushtinit se si i erdhi njē angushti nga ai zē aq i ēmbēl dhe aq i butē qē i fliste ashtu. Ia kishte mbushur zemrēn me dritē dhe ia kishte ngrohur gjakun qē i rridhte nēpēr deje. Pastaj se ku shkoi ai njeri njē copē herē bashkē me mushkēn e tij. Iku nēpēr njē tragē bari dhe zbriti poshtē nēpēr njē pyll tē rrallē **borigash**. **Zonja Hura u ul mes ca luleve tē batrēs** sē bardhē dhe mbēshteti kurrizin mbas trungut tē hollē tē njē mēnjolle. Fytyra e saj nēn rrezet e vakēta tē diellit se si qe bērē ashtu e re dhe e bukur; njē krelē e bardhē thinjash i binin mbi ballē, i shndrisnin si argjendi. Munshinjur Agushtini u ul pak mē larg, edhe ai mes njē bllane lulesh tē batrēs sē bardhē dhe i mbēshtetur edhe ai mbas njē mēnjolle. Zonjēs Hura dhe gjithē lirishtēs pērqark u rrēshqiste sipēr herē pas here njē dritē e kaltēreme; munshinjur Agushtini ngriti sytē dhe pa se si ato hije vinin ashtu pēr shkak tē **ca reve tē bardha** qē shtegētonin nē qiell.

I bēheshin edhe mē me dritē paqja dhe prehja qē kishte nē shpirt, duke parē humnerat e pafundme tē qiellit qē hapeshin njëra pas tjetrës matanë reve qē herë dukeshin si një tufë delesh nē kullotë, herë si barinj tē ulur nën male. Vende vende ato bēheshin tē bruzta, tē kaltra, tē shndritshme si sedefi dhe si një ujvarë diku qē binte si thekë mbi horizontin e largët, rrëthuar nga një gardh majash tē mprehta. O zonja Hura, sikur i thirri munshinjur Agushtini zonjës Hura me një zë gjithë aksh nga diçka qē i digjej dhe e shtynte si dhimbje nē gjoks. O zonja Hura, i tha përsëri dhe zëri iu mek e iu bë komb. A po shikon atje lart, a po vë re se kush na është shfaqur dhe po na shikon? Po, po, Agushtin, po shof Agushtin, po shof, ia ktheu plaka sikur ta kishte zënë tē qarët dhe mezi mbante lotët. Me kokën qē i dridhej, Agushtini shikonte përpjetë dhe sikur e kish mbuluar një pluhur i shndritshëm qē binte përmes diellit dhe fashave tē reve tē bardha. O Zot, atje lart, mes një blane qelli tē rrëthuar me re, dukej fytyra e Shën Mërisë që shikonte në tokë me Jezusin në krahë! Zonja Hura, a e sheh tē Lumnuemen tonë qē po na kqyr e po na përdëllen? A e sheh moj zonja Hura? Po, Agushtin! O, o Zot! O, o Zot që na ndrite kështu! O, oh moj Zonja e Lumnueme, moj nëna jonë e shenjtë! Na i fal mëkatet dhe na i pastro shpirtërat!

U mbush livadhi me zhullimën e atyre zileve, por ata tē dy, munshinjur Agushtini dhe zonja Hura ishin tē shtangur e tē bërë si gurë. Zonjës Hura i qenë lagur faqet nga rrëke lotësh dhe, s'dihej se si, tek i kishte hequr sytë nga qelli mbas asaj shfaqjeje tē së

Lumnuemes, po kqyrte poshtē humnerave tē maleve, diku larg ku dukeshin nē ca rrāhe ca rrugē katundi. Sikur pa Frederikun qē mezi rrinte nē kēmbē. Ai i tha zonjēs Hura: Pērse? Po ankohej pēr vdekjen e tij, kurrkujt nuk i kishte bērē ndonjē tē keqe. Kurrkujt... Oh, o Zot, ruajna nga tundimet shkatērrimtare! Por malēsori me mushkēn e ndērmendēn zonjēn Hura dhe munshinjur Agushtinin. “Ecni, ec o bari i Zotit dhe ti nēna e shtēpisē sē atēnisē. T'i kungojmē ferishtet ton a dhe tē na mbushet shpirti me gaz!”. Ai e drodhi mushkēn dhe ia ktheu kokēn nga ana e bjeshkēs.

Stanet ishin matanē ca borigave, nē ca livadhe tē sheshta me bar tē hollē dhe tē rrēthuar me pyje tē errēt pishash. Nē oborrin mes shtrungave dhe nomeve, njē grumbull njerēzish qe bērē gati pēr njē proçesion. Ishin ca gra e plaka tē thyera, nuse me kopanecēt e fēmijēve nē sqetull, ca goca e çuna tē vegjēl si dhe pesē gjashtē burra me shajake dhe opinga tē reja. “Urdhēro, urdhēro munshinjur,- e mori pēr krahu ai qē e kishte prurē munshinjur Agushtinin dhe e vuri nē krye.- Ditē mē tē bukur s'ka dhēnē Zoti”, i foli me njē zē tē lehtē e plot kumbim. “Urdhēro, urdhēro moj nēna jonē”, iu kthyē edhe zonjēs Hura dhe e çoi nē mes tē grave.

Munshinjur Agushtini hoqi rrugēn drejt njē shtegu shkēmbinjsh nga i kishin thēnē se do tē shkonin. As qē mund ta gjente se ç'po bēhej nē atē ditē! Kapsalliste sytē dhe nuk e kuptonte nē ishte nē ēndērr apo nē jetē tē vērtetē. Aq mē tepēr kur, si kishin bērē njē copē rrugē, plaku qē e kish marrē dhe e kish prurē

aty, ngriti zērin dhe nisi tē kēndoje “Drita e tē Lumnuemes”. Ishin ca fjalē tē çuditishme, njē si kēngē e sajuar aty pēr aty dhe nga pas si njē kor i vogēl me zēra qē nuk puqeshin mirē, nisēn ta ndiqnin plakat e nuset e mē tej burrat dhe gocat e çunat e vegjēl. Njéri nga fēmijēt nē kopanec nisi tē qajē dhe e ngriti piskamēn e tij mbi atē kor zērash tē pērzjerē. O Zot, o Zot, qe shashtisur munshinjur Agushtini. Njē kor me zēra tē çuditshēm, ku gjithsecili kēndonte vetē pēr vete, njē pērzierje e punēve tē tokēs e tē qiellit. Plakave dhe grave u qenē larē faqet nga lotēt dhe zērat u dridheshin si me ngashērim. Munshinjur Agushtinit i doli edhe atij zēri pēr sē thelli dhe shkoi e u bashkua me atē kor qē e kishte mbushur dheun si me mērmērima shpirti.

Iu afroan grykēs sē njē shpelle tē mbyllur me gurē. Aty burrat nisēn tē heqin poplat qē tē çelin hyrjen. Pastaj ndezēn qirinjtē e mandej bēnē pērpara. Ecēn si pērimes ca mureve prej mermari qē shndrisnin e xixéllonin nga drita e qirinjve. Shpella qe e gjatē dhe si kapērceje njē si parmak e njē si deriçkē prej guri futeshe nē njē hapsirē tē madhe. Aty munshinjur Agushtini mbeti shtagur. Digjeshin qirinj nē njē pllakē guri dhe lart, vēnē nē njē faqe tē lēmuar e tē kaltēreme, dukej ikona e Shēn Mērisē. O Shēn Mēri, thirri munshinjur Agushtini. E Lumnuemja me Jezunē qenē tē rrethuara nga aureola e dritēs. O Shēn Mēri, tha pērsēri, ndērsa zērat e korit u ngritēn dhe kumbuan nēn kubetē prej guri. S’ishte djegur ikona! Ah, nuk ishte djegur!

Zonja Hura u thye mē dysh dhe puqi duart. Ra nē

gjunjē dhe nisi t'i lutet tē Lumnuemes pērmes lotēve. Nisēn t'i luten tē gjithē, shpella u mbush me mērmērima dhe nga gjokset e tyre ofshante njē shpirt qē i dridhte flakēt e qirinjve...

Pastaj kishin dalē jashtē, ishin mbushur tē katēr pllajat me njerēz... Kishin dalē nē ato pllaja me ikonēn e sē Shenjtēs nē ballē dhe qe bērē njē rresht i gjatē. Munshinjur Agushtini nuk mbante mend se si kishte ndodhur e gjitha kjo. Nuk dinte tē thoshte se si kishin dalē gjithē ata njerēz dhe mali qe mbushur me njē varg pa fund, ndērsa kēndonin me njē zē qē oshētinte si gjēmim pērroi.

Po çfarē qe ashtu? Çfarē kishte ndodhur? Po vinte drejt tyre njē shpurē e Bojrogut qē kushedi se ç'det kishte kapērcyer e kushedi se si ishte shpalosur ashtu nēpēr rraket e gjëmbaçit tē kaltēr. Njē tufē parētarēsh me rroba qē u vetētinin dhe mbi dorinj tē shēndetshēm. Ata erdhēn dhe ndalēn pranē Agushtinit ku ishte kreu me ikonēn. Kishin prurē njē kornizē pēr Zonjēn Shēn Mēri, njē suazē shndritēse me gurē diamantesh dhe rubinēsh. I thanē Agushtinit se ishte dhurata e Bojrogut. Ishte shenjē qē thoshte se ai e respektonte fenē e tyre, prandaj t'i linin armiqēsítē dhe tē jetonin nē paqe e nē harmoni. Qysh, e kishte lēnē mēnjanē armiqēsinē e tij Bojrogū?! Kish hequr dorē nga gjithçka pati bērē dhe tanī kērkonte paqe e harmoni?!

Ndērsa po mendonte kēshtu, u dēgjua zonja Hura qē nisi tē qajē. Ajo u kruspullos nē njē gēmushē dhe çoi njē thirrmē drithēruese. Çfarē i ndillte zemra? Munshinjur Agushtini e pyeti me ankth: "Çfarē tē

ndjell zemra, moj zonja Hura?". "Një Vranë është nisur mbi një mushkë, një kobatar me sy të errur nga diamantët". Kështu kishte rënkuar shpirti i zonjës Hura. Po vinte një Vranë që s'do tē mund ta përballonte tundimin nga ai shkëlqim diamantësh e rubinësh. Kishte pér ta marrë e kishte pér ta futur në thellësi të pagjetshme ikonën e Zonjës. Dhe, o Zot, si do tē mbetej shkretë ky vend pastaj!

Munshinjur Agushtini hovi i trembur dhe erdhi nē vete. Ç'mendje prej satañai, or Bojrog, tha ai. Atë që s'e djeg dot me zjarr, na shtyn ta zhdukim vetë me xanxën e lakkisë.

Munshinjur Agushtini rrinte nën kupë tē qiellit dhe mbi kokën e tij lundronin re tē bardha si ëndrra. Zonja Hura qe mbështjellë nē gëmushë dhe e kishte mbështetur faqen mbas barit. Mezi mbushej me frymë. Ishin edhe ca tē përpjeta që kishin pér tē bërë dhe pastaj do tē dilnin nē një livadh dhe atje ajo do t'i tregonte Agushtinit... Kurse ky po i thoshte me një zë tē imët që sapo i i shte zgjuar nē shpirt se gjente prehje tani që ishin bashkë. Sikur ajo mizéri e pafund njerëzish nuk ishte më. Ishte bërë shkretë. Bokërrimat kishin mbetur si tē pafryma. Qe fashitur zëri i atij kori që kishte mbushur tē katër pllajat rrëth e rrëth dhe tani kërcisinin nga vapa kokat e gjëmbaçëve tē thatë. Ah, sa tē gëzuar e ndjente veten që ishin bashkë. Që qenë lodhur e qenë rraskapitur së kërkuarti, por që kurrë nuk u qe errësuar shpirti. Do tē dilnin mbi atë livadh që thoshte zonja Hura. Atje ishte një gorgë me një hyrje si një derë kishe dhe ishin dy gurë atje që i rrinin hyrjes sipër si kryq.

Ja, pēr kēta sy Agushtin, pēr atē Zot e pēr Zonjēn Shēn Mēri qē e kam parē vetē. Jam ngjitur atje kaq e kaq herē. Do tē ngjitemi moj Hurē, ah moj Hurē, o ēngjell! Munshinjur Agushtinit i shkrepētītēn sytē nga dashuria qē kishte pēr tē. Ia pat bērē zemrēn aq tē lehtē ajo, si njē e shenjtē qē nuk qe lodhur kurrē sē dashuri e sē adhuruari dhe kjo ia kishte mbushur gjoksin munshinjur Agushtinit me prehje. Do tē ngriheshin, ja, do t'i drejtonin e do t'i shtrinin ato kēmbēt e tyre tē vjetra e tē lodhura e do tē ngjiteshin. Ah, tē janē bērē kērçopane kēmbēt, moj e shkretē, mezi i hedh dhe tē mbyti fryma, por do tē çlodhemi pak, do tē prehemni sa tē mbledhim veten njē çikē dhe pastaj do tē ngjitemi e do tē ngjitemi. Do tē mbērrijmē, moj zonjē, oh, ditē mē tē bukur nuk ka bērē Zot!

Iu çel edhe mē syri munshinjur Agushtinit nēn zabullimēn e asaj vape. Qē nga shtigjet e maleve me pyje, zbriti njē duhmē ere qē mori poshtē duke ngritur shtjella pluhuri. Sikur lahej bari i pjekur i livadheve dhe mbas kēsaj shndrisnin kallzit e tij nē njē valēzim tē pērhershēm qē vente e ikte nēpēr pllajē. Sikur qe mbushur gjithësia me frymëmarrje, o Zot, sikur shfaqej shpirti i saj. Oh, moj zonja Hura, oh, moj shenjte e moj shpirte! Çohemi taní dhe ecim.

*Tiranë 1996.*

Vepra të tjera të autorit:

*romane*

- Dy të shtunat e Suzanës, 1971  
Mars, 1975  
Mali mbi kënetë, 1977  
Rrugë për larg, 1985  
Requiem për një grua, 1995



*novela*

- Ag, 1973  
Haxhiu i Frakullës, 1978  
Dasma e Sakos, 1979  
Mëngjeset e verës, 1979  
Leopardi, 1984  
Balada e Kurbinit, 1986  
Ngujimi i Has Gegnikës, 1986  
Globi prej qelqi, 1986

*vëllime me tregime*

- Kur zunë shirat e vjeshtës, 1964  
Toka nën hijen e shtëpive, 1968  
Ndërrimi i qiejve, 1971  
Vëllim me tregime të zgjedhura, 1972

*drama*

- Hijet ikin nga malet, 1967  
Njerëzit e minierës, 1968  
Mysafiri i natës, 1970

*Vath Koreshi ka shkruar një numër të madh skenarësh për filma artistikë*

ÇMIMI 200 LEKË